



**PIKËPAMJE  
TEORIKE DHE  
PRAKTIKE PËR  
ZBATIMIN E  
INTEGRIMIT  
NDËRETNIK NË  
FAKULTETET  
PËR ARSIMTARË**

Shkup, 2015

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen nga Projekti i USAID-it për Integrimin Ndëretnik në Arsim dhe në bashkëpunim me Qendrën për bashkëpunim ballkanik -LOJA. Projekti i USAID-it për integrim ndëretnik në sferën e arsimit është zbatuar nga ana e Qendrës maqedonase për edukim qytetar (QMEQ). Përmbajtja e publikimit është hartuar nga autorët dhe nuk i shpreh qëndrimet e Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar dhe as të Qeverisë së SHBA-së.

**Botues:** QMEQ në suazat e Projektit të USAID-it për Integrimin Ndëretnik në Arsim

**Autorë:**

Prof. dr. Valentina Gulevska  
Dr. Lulzim Mehmedi  
Prof.dr Rozalina Popova-Koskarova  
Prof.dr.Tatjana Atanasoska  
Docent dr. Trajçe Stojanov  
Nebojsa Mojsoski  
Tulaha Tahir  
Snezhana Jankullovska  
Ana Piskaçeva

**Redaktimi profesional:** Docent Dr. Maja Muhiq

**Bashkëpunëtorë në përgatitjen e publikimit:**

Loreta Georgieva  
Bujar Luma  
Svetllana Gashoska  
Elmedina Shafi  
Aleksandra Apostollska  
Blerim Jashari

**Përktheu:** Bardhyl Zaimi

**Lektor:** Salajdin Salihi

**Dizajnues:** [www.koma.mk](http://www.koma.mk)

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

323.111:37(035)

316:37(035)

PIKËPAMJE teorike dhe praktike për zbatimin e integrimin ndëretnik në fakultetet për arsimit / [autorë Valentina Gulevska ... [и др.]; përktheu Bardhyl Zaimi]. - Shkup : Qendra maqedonase për edukim qytetar (QMEQ), 2015. - 164 стр. : илустр. ; 20 см

ISBN 978-608-4529-33-0

1. Gulevska, Valentina [автор]

а) Мултиетнички општества - Образовни системи - Прирачници б)

Образование - Социолошки аспекти - Прирачници

COBISS.MK-ID 100255498

# PËRMBAJTJA

SHKURTESA .....	5
FJALORTHI I NOCIONEVE.....	6
PARATHËNIE.....	8
HYRJE .....	11
PËR BOTIMIN.....	14
<b>PJESA E PARË.....</b>	<b>17</b>
<b>1. STEREOTIPET DHE PARAGJYKIMET NË LËMIN E ARSIMIT DHE MUNDËSITË PËR KAPËRCIMIN E TYRE</b>	
Prof. dr. Rozalina Popova-Koskarova.....	19
1.1. Çfarë janë stereotipet dhe paragjykimet dhe si sajohen ato? .....	19
1.2. Roli i shkollës në mposhtjen e stereotipeve dhe të paragjykimeve në interes të integritetit ndëretnik.....	21
1.3. Roli i mësimdhënësve në reduktimin e stereotipeve dhe paragjykimeve .....	28
<b>2. NJË PASQYRË E TEORIVE MBI MULTIKULTURALIZMIN, ZHVILLIMIN E AFTËSIVE NDËRKULTURORE DHE PARANDALIMIN E STEREOTIPEVE DHE PARAGJYKIMEVE</b>	
Docent dr. Trajçe Stojanov.....	37
2.1. Kultura dhe identiteti .....	37
2.2. Nga multikulturalizmi gjer tek ndërkulturalizmi dhe nevoja e integritetit ndëretnik në shoqërinë e integruar multikulturore/multietnike .....	40
2.3. Arsimi i integruar multietnik dhe zhvillimi i aftësive ndërkulturore .....	47
<b>PJESA E DYTË.....</b>	<b>55</b>
<b>3. SHKOLLA DHE MISIONI I SAJ SI SHTYTËS I NDRYSHIMEVE NË SHOQËRI</b>	
Prof.dr. Tatjana Atanasoska .....	57
3.1. Shkolla si institucion dhe si mjedis specifik .....	57
3.2. Qëllimet edukativo - arsimore të shkollës në integritetin ndëretnik .....	58
3.3. Dimensione të arsimit multikulturore në shkollë .....	59
3.4. Përkufizimi i mësonjëtores së integruar kulturore .....	62

3.5. Qasje dhe shembuj për futjen e ndryshimeve në shkollën e integritit ndëretnik .....	65
3.6. Aktivitete për realizimin e dallimeve në arsimin e integruar multikulturor .....	67
<b>PJESA E TRETË.....</b>	<b>95</b>
<b>4. KOMPETENCAT NDËRKULTURORE DHE ROLI I TYRE NË SISTEMIN ARSIMOR</b>	
Prof.Dr. Valentina Gulevska .....	97
4.1. Rëndësia e kompetencave ndërkulturore për mësimdhënësit .....	97
4.2. Zhvillimi i kompetencave ndërkulturore te mësimdhënësit .....	98
4.3. Struktura e kompetencave ndërkulturore të mësimdhënësit .....	102
<b>PJESA E KATËRT.....</b>	<b>113</b>
<b>5. AKTIVITETE PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLË MES NXËNËSVE PREJ BASHKËSISH TË NDRYSHME ETNIKE DHE SHEMBUJ NGA PRAKTIKAT E MIRA NË ZBATIMIN E AKTIVITETEVE PËR INTEGRIM NDËRETNIK</b>	
Ekipi i PINA (Nebojsa Mojsoski, Tulaha Tahir, Snezhana Jankullovska, Ana Piskaçeva).....	115
5.1. Disa përvoja nga aktivitetet e përbashkëta me nxënës në PINA.....	115
Dr. Lulzim Mehmedi	
5.2. Shembuj për praktika të suksesshme në zbatimin e aktiviteteve për integrim ndëretnik në shkollën fillore “Sande Shterjovski”-Kërçovë.....	123
<b>LITERATURA E SHFRYTËZUAR .....</b>	<b>146</b>
<b>SHTOJCAT .....</b>	<b>149</b>
SHTOJCA 1 .....	150
SHTOJCA 2 .....	157

# SHKURTESA

- BZHA** ▶ Byroja për Zhvillimin e Arsimit
- QSHP** ▶ Qendra Shtetërore e Provimeve
- ISHA** ▶ Inspektorati shtetëror për arsim
- TIK** ▶ Teknologjia informatike - komunikuese
- INA** ▶ Integrimi ndëretnik në arsim
- QMEQ** ▶ Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar
- ASHJ** ▶ Arsimimi për shkathtësitë jetësore
- BK** ▶ Bashkësia e klasës
- PINA** ▶ Projekti i USAID për Integrimin Ndëretnik në Arsim
- KBSH** ▶ Kryesia e bashkësisë shkollore
- RM** ▶ Republika e Maqedonisë
- SIT** ▶ Ekipi për integrim shkollor
- KSH** ▶ Këshilli i shkollës
- USAID** ▶ Agjencia e SHBA-ve për zhvillim ndërkombëtar
- AFSH** ▶ Arsimimi fizik dhe shëndetësor
- QAPT** ▶ Qendra për arsim profesional dhe trajnim
- QDNJZK** ▶ Qendra për të drejtat e njeriut dhe zgjidhjen e konflikteve

# FJALORTHI I NOCIONEVE

Kjo është një pasqyrë e shkurtër e kuptimeve të koncepteve dhe akronimeve nga lëmia e integritit ndëretnik në lëmin e arsimit që ka për synim për ta lehtësuar leximin e këtij publikimi.

**E FOLURA E URREJTJES** - është e folur që fyen një person ose një grup të tërë mbi bazë të attributeve sikundër janë prejardhja, gjinia, përkatësia etnike, religjioze ose racore, nevojat e posaçme ose orientimi seksual

**ETNOCENTRIZËM** – Bindje në epërsinë e caktuar të kulturës së vet ose etnikumit të vet ndaj një kulture ose etnikumi tjetër. Në përputhje me këtë, etnocentrizmi nënkupton edhe dhënie gjykimesh mbi kulturat dhe etnikumet e tjera, kryesisht në bazë të sistemit të vlerave dhe standardeve të kulturës së vet..

**MULTIKULTURALIZMI** – Shumëllojshmëria kulturore e bashkësive në një shoqëri dhe politika për promovim të saj. Shumëkulturalizmi nënkupton edhe grumbull idesh në suazat e filozofisë politike dhe të teorive mbi shumëkulturalizmin për një trajtim të njëjtë të shumëllojshmërisë kulturore dhe religjioze në një shoqëri.

**NDËRKULTURALIZMI** – është një koncept dinamik që buron nga kritika e pasivitetit të multikulturalizmit dhe promovon dialogun e ndërveprimin ndërmjet njerëzve.

**INA** – Integrimi ndëretnik në arsim i përfshin të gjitha llojet e aktiviteteve të organizuara në lëmën e arsimit, në shkollë dhe ndërmjet shkollave, duke synuar përparimin e integritimit ndëretnik në lëmën e arsimit.

**PARAGJYKIME** – Qëndrime të cilat nuk mbështeten mbi përfundime të arsyeshme dhe as që argumentohen me fakte të provuara.

**STEREOTIPA** – Atribuimi i të njëjtave karakteristika për secilin anëtar të një grupi, pa marrë parasysh ndryshmëritë ndërmjet pjesëtarëve të atij grupi.

**ASHJ - Arsimim për shkathtësi jetësore** – Nënkupton arsimim për zhvillimin e shkathtësive të nxënësve për sjellje pozitive (gjykim kritik, zotësi ndërpersonale, zgjimi i vetëdijes për veten), duke synuar përballimin me sukses dhe efektiv të situatave të përditshme në jetë.

**SIT – SIT-et** – Ekipe për integrim shkollor që krijohen si një trup vendimtar për zbatimin e PINA -s në shkollë dhe ndërmjet shkollave fillore e të mesme (nga anglishtja - **School Integration Team**). SIT-in e përbëjnë këta anëtarë: drejtori i shkollës, bashkëpunëtori profesional, mësime dhënësi i mësimit klasor dhe lëndor dhe përfaqësuesi i Këshillit të shkollës. Në shkollat shumëgjuhësore, përbërja e SIT-it është me më shumë anëtarë dhe e ekuilibruar ndërmjet tyre.

**PINA - Projekti për Integrim Ndëretnik në arsim**, i mbështetur nga USAID, kurse i zbatuar nga Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ) në partneritet me disa organizata joqeveritare vendore.

# PARATHËNIE

Republika e Maqedonisë është shtet në hapësirën e të cilës nga kohë të shkuara ekzistojnë dhe bashkëjetojnë shumë kultura. Tipari i tyre është i dukshëm edhe sot në trashëgiminë materiale dhe jomateriale, në arkitekturë, në folklor, në mënyrën e të ushqyerit dhe në praktikën e përditshme dhe zakonet që i kultivojmë dhe të cilat i quajmë si pjesë e domosdoshme e jetës sonë. Multikulturalizmi dhe bashkëjetesa e qetë në Maqedoni, edhe pse shpesh herë përballen me sfida serioze, janë vënë në themelet e shtetësisë sonë. Sfidat moderne me të cilat po përballlet Republika e Maqedonisë, siç është procesi i integritimit ndëretnik në lëmin e arsimit, bashkëjetesa dhe ndërtimi i përbashkët i ardhmërisë duhet domosdoshmërisht të përfaqësohen, të kuptohen dhe të ndërthuren në mënyrë të drejtë në shoqëri, me qëllim që ideja për një shoqëri multikulturore të kuptohet dhe të përqafohet në mënyrë të drejtë.

Nevoja për të realizuar një arsimim ndërdisiplinor, përmes të cilit në mënyrë të drejtë do të trajtohej çështja e multikulturalizmit, e ndërkulturalizmit si dhe esenca dhe realiteti shoqëror, e shoqëruar me sfidat me të cilat po përballemi dhe me pasurinë të cilën të gjithë individët dhe të gjitha grupet kulturore kontribuojnë në shtet, na jep të drejtën për të konsideruar që nevoja për ta bërë edhe arsimimin multikulturore dhe, mbi të gjitha, ndërkulturore si në teori, si në praktikë, përbën një kontribut të vërtetë për ardhmërinë.

Në këtë aspekt, do ta prezantojmë, shkurtimisht, misionin dhe synimet e Projekti i USAID-it për Integrimin Ndëretnik në Arsim. Misioni PINA-s është që Maqedonia të realizojë një integrim ndëretnik të qëndrueshëm në shkolla, në institucionet e tjera arsimore dhe në shoqëri. Për ta përmbushur këtë mision, PINA, nëpërmjet saj, zhvillon një sërë aktiviteteve përmes të cilave synon që të krijojë një klimë të dobishme, për të vendosur në Maqedoni një integrim të qëndrueshëm ndëretnik jo vetëm në sistemin arsimor, por edhe në mbarë shoqërinë. Këto aktivitete janë përqëndruar në mesin e nxënësve, të prindërve, mësimitdhënësve, drejtuesve, administruesve dhe në mesin e anëtarëve të këshillave shkollorë në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë. Me këtë rast, këshilltarët e institucioneve kryesore dhe inspektorët arsimor, në rrafshin vendor dhe shtetëror, kanë një rol qendror për arritjen e ndryshimit të qëndrueshëm dhe marrin pjesë në aktivitetet për forcimin e aftësive të mësimitdhënësve për të zhvilluar aktivitetet e përbashkëta me nxënësit.

Qasja holistike në zbatimin e PINA krijon një mjedis në të cilin të gjitha palët marrin pjesë aktive në zhvillimin e aktiviteteve për përmirësimin e integritit ndëretnik në lëmin e arsimit. Ata e kuptojnë rëndësinë e integritit ndëretnik në lëmin e arsimit dhe ndaj tij sillen me përgjegjësi dhe me llogaridhënie.

Synimet kryesore të PINA janë:

- Përfitimi i vetëdijes për nevojën e integritit ndëretnik në lëmin e arsimit;
- Zhvillimi i aftësive të mësimitdhënësve, drejtorëve të shkollave, bashkëpunëtorëve profesional, të këshillave shkollorë dhe të përgjegjësve për arsimin në komunat që kanë zhvilluar aktivitete të parapara në PINA;
- Realizimi i ndërveprimit të drejtpërdrejtë mes nxënësve me përkatësi gjuhësore të ndryshme dhe i mundësive për mësim multikulturor dhe ndërkulturor;
- Sigurimi i ndihmës teknike dhe nxitja për të mbështetur integrimin ndëretnik në lëmin e arsimit;
- Institucionalizimi dhe sigurimi i zhvillimit të qëndrueshëm të PINA.

Për të përmbushur misionin dhe synimet e PINA, aktivitetet zhvillohen në katër komponentë komplementar, siç janë:

**KOMPONENTI 1:** Informimi i publikut dhe i bashkësive.

**KOMPONENTI 2:** Aftësimi i mësimdhënësve, i udhëheqësisë dhe drejtorisë së shkollave dhe të punësuarve në komuna – përgjegjësve të arsimit

**KOMPONENTI 3:** Shkolla modele.

**KOMPONENTI 4:** Sigurimi i nxitjes së bashkësisë shkollore dhe vendore.

# HYRJE

## PËRSE ARSIMIM I INTEGRUAR NDËRETNIK NËPËR FAKULTETET PËR ARSIMITARË?

Arsimi ndikon ndaj formimit të personalitetit të fëmijëve dhe të rinjve dhe u hap perspektiva të reja në zgjedhjen e mënyrës së jetës dhe të sajimit të formave dhe përmbajtjeve të reja të jetës së përbashkët e të ndryshme. Realizimi i multikulturalizmit në shoqëri nuk është i mundshëm pa e integruar edhe qasjen e respektit, njohjen dhe përkrahjen reciproke të ndryshmërisë kulturore, para së gjithash në lëmin e arsimit - në plan programet arsimore, në përmbajtjet mësimore dhe në praktikat. Pikërisht për këtë, në shoqëritë bashkëkohore, institucionet arsimore kanë obligim që përmes veprimtarisë së tyre, ta ndryshojnë edhe kontekstin shoqëror, duke i promovuar qasjet ndaj multikulturalizmit, si standard universal të shoqërisë civile dhe ndaj përcaktimeve kryesore të strategjisë për zhvillimin e shoqërisë në shekullin njëzetën.

Në Republikën e Maqedonisë, si shoqëri multikulturore me 4 gjuhë mësimore (maqedonisht, shqip, turqisht dhe serbisht) ka shumë shkolla etnikisht të përziera. Nga gjithsej 440 shkolla në Maqedoni, në afro 115 shkolla fillore dhe të mesme,

mësimi zhvillohet në dy apo në tri gjuhë. Analizat nga hulumtimi i shkollave në fazën fillestare në lëmin e integritimit ndëretnik në arsim këtu, e bërë për nevojat e PINA-s, tregojnë se shkollat shumëgjuhësore funksionojnë në mënyrë paralele. Në një pjesë të konsiderueshme të shkollave fillore dhe të mesme “të përziera”, nxënësit që u takojnë gjuhëve mësimore të ndryshme mësojnë duke ndenjur të ndarë fizikisht mes tyre. Edhe në rastet kur mësojnë nën të njëjtin pullaz, janë të shpërndarë nëpër pjesë të ndryshme të ndërtesës shkollore ose nëpër turne të ndryshme. Ndërkaq, nxënësit që mësojnë në shkollat njëgjuhësore dhe që mësojnë gjuhë të ndryshme nuk kanë mundësi për ndërveprim. Si në shkollat njëgjuhësore, ashtu edhe në shkollat shumëgjuhësore, kontakti i drejtpërdrejtë ndërmjet nxënësve që u takojnë bashkësive të ndryshme etnike/gjuhësore është i vështirësuar për shkak të ngarkimit të tyre me stereotipe dhe me paragjykime ndaj të tjerëve.

Situata e tashme mund të përmirësohet me krijimin e kushteve për kontakte të drejtpërdrejta ndërmjet nxënësve që u takojnë bashkësive të ndryshme etnike/gjuhësore në aktivitete të përbashkëta të nxënësve, jo vetëm në shkollat shumëgjuhësore, por edhe në mesin e shkollave njëgjuhësore me gjuhë mësimore të ndryshme. Për këtë qëllim, PINA e zbaton qasjen e tërësishme të përfshirjes në nivel të shkollës, duke bërë të mundshëm zhvillimin në vazhdimësi të aktiviteteve për integrim ndëretnik në shkollë nëpërmjet realizimit të një varg punëtorish për zhvillim profesional të mësimit dhe nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta mësimore dhe jashtë mësimore të nxënësve. Nxënësit, prindërit, mësimitdhënësit, drejtorët e shkollave, shërbimet profesionale dhe këshillat shkollore në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në vend, përbëjnë fokusin e programit për trajnim dhe takime mentoriale, dedikuar për zbatimin e aftësive të fituara dhe të metodologjisë për aktivitete të përbashkëta me nxënës me përkatësi të ndryshme etnike. Metodologjia përfshin qasje për reduktimin e stereotipeve dhe të paragjykimeve, duke forcuar përbashkësinë ndërmjet nxënësve nëpërmjet komunikimit të shpeshtë, të drejtpërdrejtë dhe ndërpersonal.

Qasja e këtillë holistike zbatohet me qëllim për të vendosur në sistemin arsimor mekanizma në të gjitha nivelet, të cilat u japin shtytje kontakteve të drejtpërdrejta, komunikimit aktiv dhe bashkëpunimit ndërmjet fëmijëve dhe të rinjve që u takojnë bashkësive të ndryshme etnike/gjuhësore. Institucionet

kryesore arsimore, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (MASH), Byroja për zhvillimin e arsimit (BZHA), Qendra për arsim profesional dhe trajnim (QAPT), Inspektorati shtetëror për arsim (ISHA) dhe Qendra shtetërore e provimeve (QSHP) janë ndër institucionet më të rëndësishme për të siguruar mekanizma për integrimin e qëndrueshëm ndëretnik në sistemin arsimor. Për këtë qëllim, edhe këshilltarët nga këto institucione, bashkë me ekspertët e vendit dhe edukatorët me përvojë, japin ndihmën e tyre teknike në rolin e këshillëdhënësve në sajimin e moduleve për INA në trajnimin e ekipeve për integrim shkollor, shërbimet profesionale, këshillat shkollore dhe përgjegjësit për arsim pranë komunave. Ata janë përfshirë edhe në sistemin mentorial dhe në sistemin për mbikëqyrjen e aktiviteteve të nxënësve në shkollat.

Në bashkëpunim me ISHA u bënë ndryshime edhe tek indikatorët për cilësinë e veprimit të shkollave, respektivisht u përplotësuan me indikatorët për INA. Doracak i tashëm për evaluimin integral të shkollave përfshin instrumente të reja, të cilat e bëjnë të mundshme që inspektorët e ISHA ta vëzhgojnë, ta ndjekin dhe ta evalulojnë, në mënyrë të fokusuar, integrimin ndëretnik në lëmin e arsimit në rrafshin lokal.

Me qëllim për të siguruar në mënyrë më komplekse qëndrueshmërinë e integritit ndëretnik në sistemin arsimor, nëpërmjet integritit të konceptit në arsimin e lartë, PINA zhvillon bashkëpunim edhe me fakultetet për mësimdhënie. Nëpërmjet integritit të segmenteve për arsimim ndërkulturor në programet e lëndëve do të sigurohet zbatimi i mëtejshëm i konceptit të tashëm për integrimin ndëretnik në arsimin inicial të mësimdhënësve.

Ky publikim për integrimin ndëretnik në mësimdhënien në fakultete, brezave të ri të mësimdhënësve do t'u ofrojë qasje, metoda dhe praktika nëpërmjet të cilave do të hyjnë në shkolla me një profil të ndërtuar profesional dhe individual si edukatorë me ndjeshmëri dhe aftësi ndërkulturore. Në të vërtetë, vetëm mësimdhënësit me ndjeshmëri dhe aftësi mund të ofrojnë mësim dhe të mësuar nga përmbajtjet dhe praktikat që krijojnë mundësinë e ngritjes së vazhduar të cilësisë së arsimit.

# PËR BOTIMIN

Botimi “Pikëpamje teorike dhe praktike për zbatimin e integritit ndëretnik në fakultetet për mësimdhënie” është hartuar konkretisht për profesorët e fakulteteve për mësimdhënie të vendit, por gjithashtu edhe për edukim të mësimdhënësve të tashëm e të ardhshëm në shkollat fillore.

Qëllimi i këtij botimi është që të ofrojë përmbajtje të cilat do të sigurojnë receptim përkatës të konceptit për integrimin ndëretnik në lëmin e arsimit dhe zbatimin e tij praktik në fakultetet për mësimdhënie. Ndërtimi i kapaciteteve për INA i kuadrove drejtuese dhe i profesorëve të fakulteteve do të kontribuojnë për një diseminacion përkatës të dijeve dhe aftësive për INA tek studentët - mësimdhënës të ardhshëm dhe do t’u bëjë të mundur përballjen me sfidat në procesin e realizimit të aktiviteteve për përmirësimin e integritit ndëretnik në lëmin e arsimit.

Me këtë rast duhet të merret parasysh fakti se arsimi i integruar ndëretnik është:

- ▶ Arsimit për të gjithë nxënësit pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, që njëherësh e luan rolin e rëndësishëm për t’i përgatitur nxënësit që të jetojnë në mjedisin multikulturor të Maqedonisë.

- ▶ Arsim që i jep vlerë shumëllojshmërisë dhe promovon barabarësinë pa marrë parasysh shtresën shoqërore, gjininë, përkatësinë etnike, religjioze dhe gjuhësore.
- ▶ Arsim që promovon qëndrimin se kontakti dhe përvoja me kulturat e tjera është pasuri dhe përfitim për secilin dhe se kulturat e ndryshme mund dhe duhet të bashkëpunojnë.
- ▶ Arsim që synon promovimin e këtyre vlerave në çdo segment të shkollës, siç janë strategjitë organizative, mësimore, jashtë mësimore dhe ato pedagogjike si dhe mekanizmat e vlerësimit.

Botimi përbëhet nga këto pjesë:

**PJESA E PARË –** Në pjesën e parë të këtij botimi përkufizohen nocionet mbi stereotipet e paragjykimet etnike e kulturore dhe bëhet paraqitja e problematikave rreth tyre. Krahas përkufizimit të koncepteve dhe analizës së stereotipave e të paragjykimeve, kjo pjesë përfshin edhe ushtrime konkrete dhe aktivitete për parandalimin e stereotipeve e të paragjykimeve etnike e kulturore.

Në këtë pjesë vendosen edhe bazat historike dhe teorike - filozofike të koncepteve mbi të cilat bazohet INA. Krahas disa teorive kryesore që diskutohen në këtë segment, këtu hapen portat drejt disa prej debateve dhe teorive të rëndësishme se çka paraqet shoqëria multikulturore dhe multietnike, si dhe çfarë është arsimi multikulturore, në njërin anë, por edhe çfarë është integrimi ndëretnik në arsim, në anën tjetër.

**PJESA E DYTË –** Në këtë pjesë, në mënyrë më të detajuar, i kushtohet vëmendje shkollës dhe misionit të saj në shoqëri si një agens / shtytës i ndryshimeve.

Kjo pjesë trajton këto aspekte:

- ▶ Nevojën për përfshirjen e integritit ndëretnik në arsimim.
- ▶ Analizon situata të caktuara në lëmin e arsimit.
- ▶ Jep kahjet si të futen ndryshimet për integrimin ndëretnik dhe ndërkulturore në shkollë dhe në komunitet, me çfarë strategjish mësimore, me çfarë mjetesh dhe qasjesh metodike të bëhet kjo.

- ▶ Pasqyron, jep vështrimet dhe thekson rolin e rëndësishëm të mësimitdhënësve, të programeve të punës së aktiveve, të shërbimeve profesionale, të Këshillit të prindërve, të organeve të shkollës, të aktiviteteve për mësim të përbashkët në orët mësimore dhe të aktiviteteve jashtë mësimore të nxënësve dhe gjithë kjo në përputhje me konceptin e INA.

**PJESA E TRETË –** Në këtë pjesë bëhet një analizë me sygjerime përkatëse për forcimin e aftësive ndërkulturore të mësimitdhënësve dhe të bashkëpunëtorëve profesionalë. Në këtë drejtim, kjo pjesë, i analizon këto çështje:

- ▶ Çfarë paraqesin aftësitë e mësimitdhënësve (aftësitë evropiane të mësimitdhënësve dhe aftësitë e mësimitdhënësve në sistemin tonë arsimor)?
- ▶ Cilat janë aftësitë e mësimitdhënësve për integrim ndëretnik në arsimim?
- ▶ Si përfitohen këto aftësi (njohuri, aftësi dhe aktivitete)?

Kjo pjesë jep edhe shembull se si një aftësi e caktuar ndërkulturore mund të realizohet dhe të manifestohet nëpërmjet një aktiviteti përkatës nga ana e mësimitdhënësit.

**PJESA E KATËRT –** Kjo pjesë merr në vështrim përmbajtjen e aktiviteteve të përbashkëta për bashkëpunim reciprok ndërmjet nxënësve me përkatësi të ndryshme etnike dhe ndan bashkë përvojat nga aktivitetet e realizuara në mjedis të ndryshme dhe shkolla, të cilat mund të realizohen në mënyrë të suksesshme në një klasë mësimore multikulturore. Gjithashtu, kjo pjesë e fundit e botimit, përfshin edhe shembuj të praktikave të mira për realizimin e aktiviteteve të integritimit ndëretnik për INA.

**PJESA E PARË**



# 1. STEREOTIPET DHE PARAGJYKIMET NË LËMIN E ARSIMIT DHE MUNDËSITË PËR KAPËRCIMIN E TYRE

*Prof.dr.* Rozalina Popova-Koskarova

## 1.1. ÇFARË JANË STEREOTIPET DHE PARAGJYKIMET DHE SI SAJOHEN ATO?

Stereotipet dhe paragjykimet sajohen në atë mënyrë që njerëzve u përshkruhen tipare të caktuara për shkak të përkatësisë së tyre në një grup të caktuar. Në të vërtetë, stereotipet formohen në bazë të gjinisë, moshës, dallimeve etnike, racës, aftësive dhe vështirësive për të mësuar etj. (Shembull: Studentët me bukurshkrim janë të ndërgjegjshëm, të tjerët jo, ose romët gënjejnë dhe vjedhin; vllahët janë dorështrënguar, etj). Stereotipet dhe paragjykimet e vështirësojnë dukshëm komunikimin ndërmjet njerëzve, prandaj është i nevojshëm përballimi i tyre, veçanërisht në procesin e edukimit dhe arsimimit.

Në sajimin e paragjykimeve ndikojnë qëndrimet tona, ose më konkretisht thënë, komponentë emocionale e qëndrimit. Së këndejmi, për stereotipet dhe paragjykimet zakonisht thuhet së janë qëndrime shumë rigide, më shpesh edhe pa bazë reale. Është e ditur se qëndrimi përbëhet nga tre komponentë: kognitive, afektive dhe motivuese. Kongitivja ka të bëjë me njohjen që secili individ e ka përfutur mbi diçka ose ndaj ndonjërit.

Komponenti afektiv ka të bëjë me emocionet dhe ndjesitë, kurse komponenti motivues me qëllimin për sjellje ndaj ndonjërit ose ndaj diçkaje. Shkurt, qëndrimi përmbledh – njohje, ndjesi dhe qëllime për të bërë diçka në lidhje me të. Të gjitha komponentët janë të rëndësishme, kurse ndër më të rëndësishmet njihet komponenti emocional, sepse ajo i adresohet forcës dhe shkallës së forcës së pozitivitetit apo të negativitetit të qëndrimit.

Qëndrimin e vet njeriu e përjeton si një pjesë të personalitetit të vet dhe nëse dikush e sulmon atë e përjeton si sulm ndaj personalitetit të vet. Nga ana tjetër, ndërkaq, ndodh që njeriu të formojë qëndrimin e vet mbi bazë të përvojave të pakta dhe ta mbrojë atë fuqishëm. Qëndrime kësodore jo objektive dhe të pambështetura janë paragjykimet. Ato janë jo objektive dhe të pabazuara, por nga ana tjetër janë qëndrime të ngurta dhe rezistuese. Paragjykimet janë qëndrime të cilat më shpesh nuk gjejnë bazë objektive as në botën reale, as në përvojën jetësore të individëve. Kësodore janë për shembull paragjykimet me bazë religjioze, etnike, racore dhe paragjykimet llojesh të tjera që e pengojnë komunikimin normal ndërmjet njerëzve.

Paragjykimet ndryshojnë me shumë vështirësi, madje shpesh nuk ndih-

mojnë as nuk ndikojnë edhe argumentet ndaj tyre. Me forcën e argumenteve mund të ndikohet për mposhtjen e paragjykimëve dhe të stereotipeve nëpërmjet procesit të gjithmbarshëm edukativo - arsimor. Për të arritur këtë, duhet ndikuar në mënyrë të qëllimshme (intencionale) tek të rinjtë që nga mosha më e vogël. Rolin kryesor në këtë kontekst e kanë prindërit, ambienti brenda të cilit individ i jeton dhe zhvillohet, por gjithsesi edhe shkolla, respektivisht mësimdhënësit.

### **1.1.1. STEREOTIPET DHE PARAGJYKIMET MË TË SHPESHTA NË SHKOLLAT TONA**

Në shkollat e Republikës së Maqedonisë shumë zëshëm manifestohen stereotipet. Kjo ndodh me nxënësit në shkollat njëgjuhësore dhe shumëgjuhësore kur nuk kanë kurrfarë njohje të kulturave të ndryshme, për shkak të mungesës së çfarëdo lloj aktiviteti të përbashkët. Në shkollat shumëgjuhësore, mësimdhënësit dhe nxënësit nuk zhvillojnë komunikime, respektivisht më shpesh mësojnë në turne të ndryshme, kurse shpesh edhe në ndërtesa të ndryshme.

Ndarja rezulton me mbylljen në mjediset e veta - në rajone banimi,

vende dëfrimi, kafeteri, e të ngjashme, ku shkojnë vetëm “tanët”, ku dëgjohe vetëm muzika “jonë”. Paralelizmi i të jetuarit dhe i sistemit arsimor i ngrit paragjykimet e njërës palë ndaj tjetrës dhe kështu edhe pa durueshmërinë, mungesën e respektit, mosgatishmërinë për të vështruar ngjashmëritë dhe mosreceptim të ndryshmërive. Shoqëria jonë deklarohet si multikulturore, por në thelb etnocentrizmi ose lartësimi i kulturës së vet ose i etnikumit të vet në dëm të zhvlerësimit të së huajës - tashmë prej shumë kohësh është realitet - gjithnjë e më shpesh jemi dëshmitarë të konflikteve ndërmjet të rinjve me përkatësi të ndryshme etnike.

## 1.2. ROLI I SHKOLLËS NË MPOSHTJEN E STEREOTIPEVE DHE TË PARAGJYKIMEVE NË INTERES TË INTEGRIMIT NDËRETNIK

Stereotipet dhe paragjykimet më lehtë mund të mposhten dhe njëkohësisht edhe të ngriten ndjeshmëria ndaj tjetrit nëse fëmijët kanë mundësinë të njihen mes tyre, respektivisht të përfshihen nëpër aktivitete të përbashkë-

ta, si në kuadër të mësim nxënies së rregullt dhe veçanërisht në veprimtarinë jashtë mësimore. Shkolla duhet të sigurojë mundësisht sa më tepër aktivitete të përbashkëta ndërmjet nxënësve që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore, si për shembull ndërmjet atyre që mësojnë maqedonisht dhe atyre që mësojnë shqip.

Me këtë rast, aktivitetet jashtë mësimore janë forma më e përshtatshme për aktivitete të përbashkëta ndërmjet nxënësve me përkatësi të ndryshme etnike (maqedonas, shqiptarë, turq, romë etj.)

Veçanërisht të përshtatshme janë ekskursionet e përbashkëta, si dhe format e punës shoqërisht të dobishme, në të cilat fëmijët me përkatësi të ndryshme gjuhësore dhe etnike, në ambientet e një shkolle, mund të organizojnë aktivitete solidariteti dhe humanitare. Sikundër u cek edhe më lartë, ndërveprimi ndërmjet fëmijëve është me rëndësi shumë të madhe, shoqërimi i përbashkët mes tyre po ashtu. Lidhja mes tyre, ndikimi reciprok dhe në fund, kënaqësia që ua jep prodhimi final që duhet të jetë rezultat i pjesëmarrjes së të gjithëve barabarësisht. Është e kuptueshme se aktivitetet e përbashkëta duhet të zhvillohen mbi bazë të kooperimit

dhe të barabarësisë, nëpërmjet ndërnikimit reciprok, që nënkupton një lidhni reciproke mes tyre, në mënyrë që puna të kryhet në mënyrë cilësore dhe të përmbushet synimi i paracaktuar. Këto aktivitete duhet të praktikohen që nga klasat filltare të shkollimit fillor. Përmbajtjet aktuale të programeve mësimore, për disa lëndë të caktuara, që kishin për qëllim njohjen me kremtat fetare të llojit të krishterët ortodoksë kremtojnë Pashkët, kurse myslimanët - Bajramin, përbëjnë vetëm një informacion formal që nuk ndihmon për ndërveprim reciprok. Më e goditur është një vizitë e përbashkët e një objekti fetar që i takon një përkatësie të ndryshme fetare. Në rastin konkret, do të ishte më mirë sikur të bëhej një vizitë e përbashkët një kishe dhe një xhamie, ndjekja e ritualit dhe të bëhet shpjegimi përkatës etnografik i tij. Kjo është rruga e njohjes dhe e respektimit reciprok që nga mosha e njomë, por edhe e mposhtjes së stereotipave dhe paragjyqimeve tek fëmijët. E drejta, kjo mënyrë e arsimimit shumëkulturore, praktikohet në sistemet arsimore në shumë vende të zhvilluara, veçanërisht në Suedi. Në të vërtetë, ky është qëllimi i arsimimit të integruar ndëretnik, që në Republikën e Maqedonisë përbën një strategji për të gjitha shkollat fillore dhe të mesme.

### **1.2.1. USHTRIME PËR ANALIZË TË SITUATAVE PËR ROLIN E SHKOLLËS NË MPOSHTJEN E STEREOTIPAVE DHE TË PARAGJYKIMEVE NË INTERES TË VENDOSJES DHE PËRPARIMIT TË INTEGRIMIT NDËRETNIK<sup>1</sup>**

Studentët duhet të bëjnë analizën e situatave në arsimim nëpërmjet dialogut rreth tri pyetjeve që vijojnë:

1. Çfarë lloji stereotipesh dhe paragjyqimesh manifestohen në situata të caktuara?
2. Si kontribuon / si ka kontribuar shkolla për mbetjen apo forcimin e tyre?
3. Çfarë duhet bërë që të mos përsëritet një situatë e atillë?

<sup>1</sup> Ushtrimet janë marrë nga materiali punues: Integrimi ndëretnik në arsim. Trajnime për ekipe të integritit shkollor. PINA, QDNJZK në partneritet me QMEQ, Qershor 2013

## SITUATA 1.

Nxënësit e klasës III-4 i bëjnë pyetje kujdestarit të klasës, Aleksandar Nikollov, vallë do të mundin që në vitin e ri shkollor ata të mësojnë në njërën nga mësonjëtoret që do të rinovohen gjatë pushimeve verore, duke marrë parasysh se kanë dëgjuar fjalë se ato janë caktuar për maturantët.

Kësaj pyetje, kujdestari i klasës i jep përgjigje se ka dyshime rreth saj, sepse drejtoresha Vjollca Imeri me siguri do t'ua ndajë të gjitha mësonjëtoret e rinovuara paraleleve "shqiptare". Mendimin e vet do ta mbështesë me "argumente" nga një përvojë e kaluar: "Në sajë të drejtoreshës, kompjuterët më të mirë i morën nxënësit shqiptarë". Mandej, shton: "Gjithë shqiptarët janë të atillë - kujdesen vetëm për të vetët dhe duan të grabisin gjithçka për veten. Kur do marrin pushtetin në duar, vetëm për interesat e veta mendojnë dhe çfarë është më tmerruese, mendojnë se kanë të drejtë të bëjnë kështu".

### PËRGJIGJET QË PRITEN JANË KËTO:

- ➔ Sipas maqedonasve, shqiptarët janë interesxhinj dhe egoist - mendojnë vetëm për veten dhe për nevojat e veta.
- ➔ Mësimdhënësit i krijojnë drejtpërdrejt këto stereotipa dhe paragjykime.
- ➔ Vendimmarrja në shkollë duhet të bëhet transparente, pjesëmarrëse dhe në interes të të gjithëve - të përfshihen edhe mësimdhënësit (maqedonas dhe shqiptarë), madje edhe nxënësit dhe në mënyrë të hapur të bisedojnë e të merren vesh për shpërndarjen e resurseve, duke i marrë parasysh nevojat e të gjitha bashkësive etnike që përfaqësohen në shkollë.

## SITUATA 2.

Na sallën e arsimitarëve bisedohet rreth përgatitjeve për manifestimin përfundimtar në shkollë. Tashmë është vendosur që Ana dhe Igori - nxënës të dalluar nga klasa e shtatë dhe e tetë që tashmë kanë një përvojë manifestimesh, ndaj edhe shkolla nuk do të dalë e turpëruar nga kjo. Një prezantim do të ketë edhe kori i nxënësve me një këngë popullore, mandej do të pasojë pjesa qendrore e manifestimit, e cila është konceptuar tashmë dhe gjatë kohë po bëhen ushtrime më mësimdhënësen e maqedonishtes.

Ajo që mungon, është ndonjë pikë muzikore për në fund, prandaj dhe mësimdhënësi i muzikës propozon që të pyeten Orhani dhe Nadireja, që të paraqiten bashkërisht. “Ai luan shumë bukur në tarabukë me babanë e tij nëpër dasma, ndaj edhe nuk do të ketë frika nga paraqitja publike, kurse ajo që nga mosha e vogël luan mrekullisht një valle me përdredhje të belit. Dhe, kështu do të përfshihen edhe romët në këtë manifestim.

### PËRGJIGJET QË PRITEN JANË KËTO:

- ➔ Maqedonasit janë më të përgjegjshëm dhe më të aftë. Romët janë të aftë vetëm për të kënduar dhe vallëzuar.
- ➔ Nëpërmjet manifestimeve, shkolla i nxit drejtpërdrejt stereotipet dhe paragjykimet e këtilla.
- ➔ Në manifestimet e radhës nxënësit romë duhet të përfshihen edhe në pikat e tjera, sikundër që edhe nxënësit e tjerë duhet të përfshihen në pikat me të luajtur ndonjë instrumenti dhe në pikat e valleve - pjesëmarrja e nxënësve romë dhe e atyre që nuk janë romë duhet të jetë e përbashkët gjatë tërë programit.

## SITUATA 3.

Në orën e kujdestarisë, mësimdhënësi Ismeti diskuton me nxënësit rrahjen ndërmjet nxënësve maqedonas dhe shqiptarë, që një ditë më parë u shfaq si lajm qendror në të gjitha mediat. Qëllimi i tij është që të zmbrops nga mundësia edhe ata vetë që të mos marrin pjesë në rrahje

të ngjashme dhe ua bën pyetjen: “Çfarë mund të bëhet për të penguar dhunën ndërmjet të rinjve?” I pari përgjigjet Blerimi: “Ne nuk jemi të fajshëm - ata gjithherë bëjnë provokime, fyejnë dhe na sulmojnë, kështu na detyrojnë që të mbrohemi”. Ndaj kësaj mësimdhënësi reagon: “Përse përziheni me ata? Kur do shihni se jeni në afërsi të tyre, ikni sa më larg. Kur tashmë e dini se çfarë janë, të mos keni punë me ta!”

#### PËRGJIGJET QË PRITEN JANË KËTO:

- ➔ Maqedonasit janë provokatorë (nxisin dhunën), kurse shqiptarët janë viktima.
- ➔ Nxënësit vijnë të ngarkuar me këto stereotipe dhe paragjykime, kurse mësimdhënësit i pohojnë dhe i forcojnë ato.
- ➔ Duhet siguruar një komunikim më i rregullt ndërmjet nxënësve maqedonas dhe shqiptarë për t’u njohur mes tyre dhe të që të mos ndjehen të kërcënuar njëri nga tjetri.

#### SITUATA 4.

Gjatë vizitës tek një përmendore e luftëtarëve të rënë në LNÇ, Igori fillon të rrëfejë zëshëm se si gjyshi i tij e di që në Luftën e Dytë Botërore të gjithë shqiptarët kanë luftuar në anën e fashistëve dhe i kanë vrarë maqedonasit për hakmarrje nga shkaqet se kanë luftuar kundër fashistëve. Lidhur me këtë, Elena ndërhyr duke pohuar se pas luftës, kur shqiptarët kishin humbur, nga Shqipëria kishin filluar të vendosen në territorin e Maqedonisë, me qëllim që ta pushtonin hap pas hapi. Kjo u jep nxitje edhe nxënësve të tjerë të tregojnë “çka dinë” - se shqiptarët qëllimisht kanë lindur shumë fëmijë me direktivë të prijësve politikë, se hoxhallarët nuk u kanë dhënë leje të shkojnë në shkollë, që ta kenë më lehtë për t’i manipuluar.

Shihet qartë se të gjithë nxënësit i mbështesin këto pohime, ndërsa mësimdhënësi vetëm hesht dhe shtiret gjoja se nuk po dëgjon.

### PËRGJIGJET QË PRITEN JANË KËTO:

- ➔ Sipas maqedonasve, shqiptarët kanë qenë fashistë dhe armiq të maqedonasve, të pashkolluar dhe primitivë dhe prandaj edhe lehtësisht të manipulueshëm nga prijësit e tyre të cilat kanë pasur qëllime të fshehura. Maqedonasit janë viktima të tyre.
- ➔ Nxënësit vijnë të ngarkuar me këso stereotipe dhe paragjykime, kurse mësimdhënësit i pohojnë ato dhe u japin fuqi gjithherë kur nuk marrin të reagojnë ndaj tyre dhe t'i korrigjojnë.
- ➔ Mësimdhënësi mund t'u tregojë atyre se ka pasur shqiptarë që kanë qenë në anën e fashistëve, porse ka pasur edhe maqedonas që kanë qenë në anën e okupatorëve, duke theksuar se ka pasur viktima edhe tek njëra edhe tek pala tjetër, gjë e cila më tepër është varur nga fakti se në cilën anë kanë luftuar, sesa nga fakti se cilit grup etnik i kanë takuar.

### SITUATA 5.

Në një shkollë fillore, me mësim në gjuhën maqedonase, seksioni i dramës kishte përgatitur një pikë për shfaqjen në vijim, me të cilën dëshiron që ta ilustrojë karakterin multietnik të Republikës së Maqedonisë. Dramatizimi me karakter komik flet për një grup fëmijësh me përkatësi të ndryshme etnike që jetojnë në të njëjtën ndërtesë dhe shoqërohen shkëlqyeshëm:

Vllado luan rolin e maqedonasit, që është një gjeni për kompjutoret, kurse Dejani luan rolin e shqiptarit që tmerron fëmijët e tjerë në atë rrethinë, Ivani luan rolin që i shkon për dore në një mënyrë magjike të “sigurojë” gjithçka dëshirojnë nga shitoret në afërsi, Zorani luan boshnjakun, të cilin e qesh secili, sepse gjithherë flet marrëzira dhe Sasho luan turkun, i cili e dëgjon vetëm babanë dhe i zbaton vetëm urdhrat e tij. Dramatizimi që ilustron një ndodhi në një grup shokësh trazon një të qeshur gjëmuese të publikut dhe mbaron duke marrë një duartrokitje të fuqishme.

---

### PËRGJIGJET QË PRITEN JANË KËTO:

---

- ➔ Maqedonasit janë të mençur, shqiptarët janë të dhunshëm, romët janë hajdutë, boshnjakët janë mendjetrashë, kurse turqit janë patriarkalë.
  - ➔ Shkolla, përmes shfaqjes i nxit drejtpërdrejt stereotipat dhe paragjykimet e këtilla.
  - ➔ Në dramatizime të ngjashme, për shfaqjet e radhës, nxënësve të cilët përfaqësojnë grupet e ndryshme etnike duhet t'u caktohen role jo stereotipe (për shembull, romi është i mençur, maqedonasi është hajdut, kurse shqiptari muzikal).
  - ➔ Mund edhe fare të shmangen dramatizimet me personazhe tiparesh negative dhe të zëvendësohen me tjetër lloj pikash që do t'i prezantojnë bashkësitë e ndryshme etnike.
- 

**Përmbledhja për rolin e shkollës** në sajimin dhe vazhdimin e stereotipeve dhe te paragjykimeve shpjegohet në këtë mënyrë:

- ▶ Stereotipet dhe paragjykimet nxiten dhe vazhdohen përmes sjelljes së mësimdhënësve (çka flasin dhe çka bëjnë), përmes sjelljes së nxënësve (çka flasin dhe çka bëjnë) dhe përmes materialeve të mësimdhënies.
- ▶ Shkolla kultivon një qasje etnocentriste (për shembull, muzika jonë është më e bukura prej të gjithave;

ne jemi viktimat më të mëdha na Ballkan; objektet tona fetare janë më të bukurat në botë; ose tanët janë vrarë gjatë kohës së luftës X; alfabeti ynë është i pari mbi të gjithë të tjerët ngjashëm me të; gjuha jonë është unike ndaj të tjerave etj., por edhe përmes aktiviteteve jashtë mësimore (ekskursione vetëm në vendet e rëndësishme për etnikumin e vet (identiteti kulturor).

### 1.3. ROLI I MËSIMDHËNËSVE NË REDUKTIMIN E STEREOIPEVE DHE PARAGJYKIMEVE

Në procesin edukativo - arsimor, mësimdhënësi luan rolin kyç në procesin e zvogëlimit dhe të mposhtjes së stereotipeve dhe të paragjytimeve. Me zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme dhe të përbashkëta, me të cilat, përmes një bashkëpunimi intensiv, shoqërimi dhe ndërveprimi, nxënësit me përkatësi të ndryshme kulturore, njihen mes tyre, i kuptojnë ngjashmëritë dhe i respektojnë dallimet kulturore ekzistuese. Me këtë rast, gjatë kontaktit të drejtpërdrejtë, kur nxënësit bashkëpunojnë për krijimin e një produkti konkret të përbashkët, barrierat ndërmjet tyre shemben. Kur nxënësve u krijohen kushte të mira për komunikim dhe bashkëpunim, nuk del asnjë pengesë për shoqërimin e tyre të përbashkët, për miqësi dhe për funksionim të grupit të nxënësve dhe jo si grup sipas përkatësisë etnike. Vetëm sipas këtyre kushteve të siguruara për nxënësit që udhëhiqen ngandjeshmëria ndërkulturore dhe nga mësimdhënësit të trajnuar bëhet e mundur që, hap pas hapi, të shemben stereotipet dhe paragjykimet, të kapërcehet

paralelizmi ekzistues, të praktikohet dhe të zbatohet suksesshëm integrimi në arsimim.

Nxënësit duhet të edukohen që t'i ndryshojnë stereotipet dhe t'i imponojnë paragjykimet e gabuara, kurse për këtë, krahas prindërve, të përgjegjshëm janë edhe mësimdhënësit e tyre. Nxënësit duhet të mësohen të kapërcejnë diskriminimin sistematik dhe të thonë qëndrimin e tyre kundër çdo lloji diskriminimi dhe paragjykimi. Shembull, mësuesja ose edukatorja duhet patjetër të ndërhyjë nëse disa nxënës, përshkaktë disa paragjytimeve, i refuzojnë fëmijët e tjerë të hyjnë në grupin e tyre. Pikërisht për këtë, më së miri është që të vendosen rregulla të llojit: "Secili meriton edhe respekt edhe solidarizim. Nuk do t'i lejoj askujt që të më fyejë dhe as që do të lejoj që të lëndoni dikë tjetër". Për të funksionuar kjo rregull mund të paraqitet nevoja që mësimdhënësi të asistojë në sqarimin e komunikimit ndërmjet fëmijëve. Ndonjëherë paragjykimet mund të depërtojnë në jetën shoqërore dhe të mos vërehen. Mësimdhënësit dhe edukatorët, përveç prindërve, janë ata që duhet t'i mësojnë fëmijët të jetojnë në mjedis multikulturore. Vërtet, mësimdhënësit dhe edukatorët duhet t'i ndërtojnë

dhe t'i forcojnë njëkohësisht aftësitë shumëkulturore të fëmijëve. Në radhë të parë vetë ata duhet të bëhen model për respektimin e fëmijëve që janë të ndryshëm, si dhe në programet e veta duhet të përfshijnë studime të rasteve, përralla, tregime, socio-drama e të ngjashme, që trajtojnë çështje të ndryshme kulturore, etnike ose madje çështje gjuhësore. Kjo do të thotë që mësimdhënësit duhet që t'u japin mbështetje nevojave të të gjithë fëmijëve dhe, çfarë është shumë me rëndësi, të veprojnë në kundërvënje me paragjykimet, të cilat në shoqërinë tonë manifestohen fuqishëm ndaj njerëzve të tjerë për shkak të: gjinisë, moshës, pamjes, ngjyrës së lëkurës, orientimit seksual ose përcaktimit religjioz. Prandaj, të mësuarit e fëmijëve që t'i njohin dallimet ndërmjet njerëzve duhet të jetë një detyrë po aq e rëndësishme sikundër është të mësuarit e fëmijëve për të lexuar, shkruar ose për të njehsuar. Në vazhdim japim dy shembuj që dallojnë thelbësisht ndaj paragjykimeve, pikërisht në sajë të sjelljes së mësimdhënësve.

### Shembulli. 1

*Maja dhe Bojani janë në klasën e parë. Në orën mësimore, gjatë qëndrimit gjithëditor, luajnë me dy komplete figurash familjare që ekzistojnë në shkollë. Figurat e njerit komplet kanë ngjyrë të errët të lëkurës, kurse të tjetrit të ndritur. Bojana u qaset dhe i tregon me gisht figurat me ngjyrë të errët dhe mandej flet zëshëm: "Nuk i dua njerëzit lëkurëzinj, sepse janë të këqij". Mandej që të dy bëjnë grimasa që shprehin neveri, duke shikuar figurat e errëta. Mësimdhënësja e ndjek lojën e tyre dhe vendos që të mos ndërhyjë. I lejon të mendojnë zëshëm...<sup>2</sup>*

Në shembullin e sjellë më lart, mësimdhënësi i lejon paragjykimet ndaj njerëzve lëkurëzinj ("Zezakët"). Shembulli i sjellë është negativ, ai duhet të shërbejë si shembull se si nuk duhet të jetë sjellja e mësimdhënësës. Vërtet, me vetë mosndërhyrjen e saj, ajo jep sinjale për një sjellje të heshtur ndaj mendimeve dhe sjelljeve të fëmijëve, në rastin konkret të manifestuara si sjellje raciste tek fëmijët...<sup>3</sup>

<sup>2</sup> Arsimi dhe kultura demokratike (1991), (përkthim), Instituti për shoqëri të hapur. Shkup, Maqedoni, faq.60

<sup>3</sup> Po aty, faq.61

**Shembulli. 2**

*Maja dhe Bojani janë në klasën e parë. Në orën mësimore, gjatë qëndrimit gjithëditor, luajnë me dy komplete figurash familjare që ekzistojnë në shkollë. Figurat e njërit komplet kanë ngjyrë të errët të lëkurës, kurse të tjetrit të ndritur. Bojana u qaset dhe i tregon me gisht figurat me ngjyrë të errët dhe mandej flet zëshëm: “Nuk i dua njerëzit lëkurëzinj, sepse janë të këqij”. Mandej që të dy bëjnë grimasa që shprehin neveri, duke shikuar figurat e errëta. Mësimdhënësja e ndjek lojën e tyre dhe u afrohet, duke u thënë: “Çka i bën këta njerëz të këqij? Nuk mund të dini se janë të këqij vetëm duke i shikuar nga pamja e tyre, por vetëm sipas sjelljes së tyre. Ejani hapim një shitore të bukur me kutia, kurse familja me ngjyrë të errët të lëkurës mund të jetë pronari i saj. Mësimdhënësja mandej i ndihmon që të hapin një shitore të vogël dhe merr rolin e njerës nga figurat me lëkurë të errët, duke i pyetur fëmijët se çfarë duan të blejnë. I lë vetëm në momentin kur ata tashmë janë dalldisur pas lojës, duke luajtur shitoren e figurave.”<sup>4</sup>*

Në shembullin 2, mësimdhënësja është ajo që i udhëzon fëmijët që të mos mbajnë qëndrime negative ndaj

4 Po aty, faq. 71

njerëzve më ngjyrë të errët të lëkurës dhe, njëkohësisht, me futjen e saj në lojë, ajo u jep një shembull të mirë për respektimin e dallimeve, të cilat, në këtë rast, janë rezultat i ngjyrës së errët të lëkurës. Shprehja e respektit ndaj një bashkësie tjetër etnike është “njëra prej gjërave më të fuqishme të cilën mësimdhënësi mund ta bëjë për të promovuar njëjtësi (barabarësi) në klasë që nga moshën më të re. Është e dëshirueshme që këtë ta bëjë duke përdorur të shprehurit e urtë dhe të kulturuar gjithëherë kur flitet për një tjetër, duke u përmbajtur për të mos folur për gjëra jo të hijshme dhe të mos manifestojë paragjykime, si dhe jo shprehje mosbesimi ndaj një grupi të caktuar njerëzish. Për shembull, mësimdhënësi mund t’u drejtohet nxënësve në këtë mënyrë: “Sara sot është në shtëpi, sepse familja e saj kremton një festë të rëndësishme të religjionit të tyre. Kur do të vijë nesër në shkollë, ejani ta pyesim që të na thotë diçka rreth kësaj feste”.<sup>5</sup> Metodrat dhe strategjitë për edukim në mjediset multikulturore ndikojnë edhe në ngritjen e mekanizmave për jetë grupore dhe punë, veçanërisht për shoqërim, solidaritet, mbështetje, bashkëpunim reciprok dhe të ngjashme. Nxënësit vihen në situatë që kërkojnë bashkëpunim dhe

5 Po aty, faq. 66

ndihmë të ndërsjellë, përkujdesje ndaj njëri tjetrit, mirëkuptim më të madh të ndërsjellë e të ngjashme. Është e kuptueshme se të gjitha këto aspekte nuk janë të mundshme nëse nuk ngritet empatia dhe ndjesitë empatike.

### **1.3.1. USHTRIME PËR ANALIZË SITUATASH DHE ZHVILLIM DISKUTIMI PËR ROLIN E MËSIMDHËNËSVE DHE TË EDUKATORËVE NË REDUKTIMIN E STEREOTIPEVE DHE PARAGJYKIMEVE**<sup>6</sup>

Analiza e situatave nga ana e studentëve duhet të zhvillohen duke dhënë përgjigje mbi tri pyetje:

1. Cilat grupe etnike janë “të ndara” në këtë situatë?
2. Si manifestohet ndarja?
3. Çfarë duhet ndryshuar në situatën e caktuar në mënyrë që të lehtësohet ndërveprimi?

<sup>6</sup> Ushtrimet janë marrë nga materiali punues: Integrimi ndëretnik në arsim. Trajnime për ekipe të integrimit shkollor. Projekt për Integrimin Ndëretnik në Arsim. QDNJZK në partneritet me QMEQ, Qershor 2013

## **SITUATA 1.**

Në tabelën e shpalljeve, në një shkollë të mesme profesionale në Tetovë, është ngjitur një lajmërim për vizitën e të gjithë nxënësve të vitit të dytë në një shkollë profesionale në Strumicë. Një grup nxënësish nga paralelet “shqipe” e lexon lajmërimin dhe nis e komenton: “Ku e kanë hallin këta tanët - kush dëshiron që të shkojë tek ata në Strumicë? Nëse ata vërtet kanë dashur të njihen me ne, do të vinin këtu! Prapë ne duhet të jemi të parët që shtrijmë dorën, kurse ata... Dhe, kush të garanton se nuk do të na shpien të vizitojmë edhe ndonjë kishë dhe të kryqëzohemi!”. Bisedën e dëgjon njëri nga mësimdhënësit dhe për t’i qetësuar u thotë: “Doni s’doni, vizita patjetër të bëhet. Edhe për ne do të ishte më mirë të shkonim në Strugë, por erdhi urdhri se duhet patjetër të lidhemi me ndonjë shkollë nga ajo anë. Por, nëse mendoni që ideja nuk është e mirë, atëherë shkruani një peticion dhe do t’ua paraqesim kompetentëve për të ardhmen”.

---

### PËRGJIGJET QË PRITEN JANË KËTO:

---

- ➔ Ndarje mes maqedonasve dhe shqiptarëve.
  - ➔ Nga ana e mësimdhënësve janë nxitur paragjykime të shoqëruara me mosbesim dhe “frikë” nga e panjohura.
  - ➔ Të përgatiten nxënësit për një formë të tillë vizite, që t’i kuptojnë përfitimet nga vizita dhe të marrin pjesë në marrjen e vendimit për vizitën.
- 

### SITUATA 2.

Në mbledhjen e shkollës është planifikuar ekskursioni i gjysmë maturantëve në Ohër. Është vendosur që të gjithë nxënësit e dy gjuhëve mësimore - 4 paralele me mësim në gjuhën maqedonase dhe 2 me mësim në gjuhën turke - do të shkojnë bashkë, si përherë dhe për secilën klasë do të caktohet nga një autobus.

Gjatë udhëtimit do të vizitohet edhe manastiri Shën J. Bigorski, kurse nëpër Ohër, dihet - Shën Sofia, Shën Jovan Kaneo, Shën Naumi. Tashmë është caktuar edhe grupi që do të bëjë muzikë - “Goce bend”. Janë të shkëlqyeshëm, s’ka muzikë që nuk dinë ta luajnë, çfarëdo që të jetë, sikur të të bjerë ndërmend edhe ndonjë këngë e moçme apo e re maqedonase, muzikë argëtuese ose popullore. Dhe shumica e nxënësve janë të lumtur nga kjo zgjedhje. Këtë e tregoi edhe anketa që e bëri shërbimi profesional.

---

### PËRGJIGJET QË PRITEN JANË KËTO:

---

- ➔ Ndarje ndërmjet maqedonasve dhe turqve.
  - ➔ Udhëtim ndaras dhe trajtim jo i barabartë ndaj nxënësve turq (me rastin e zgjedhjes për vizitë të vendeve dhe kuriozitetet për vizitë, me rastin e zgjedhjes së muzikës dhe gjatë marrjes së vendimit).
  - ➔ Të merren parasysh interesat e nxënësve turq (përgjigjet e tyre në anketë të përpunohen në mënyrë të veçantë nga përgjigjet e nxënësve maqedonas); nxënësit të udhëtojnë të përzier më një autobus; të vizitojnë numër të njëjtë kuriozitetesh me rëndësi për të dyja bashkësitë etnike; të dëgjojnë muzikë që nuk favorizon asnjërin nga këto dy grupe etnike.
-

### SITUATA 3.

Mësimdhënësi i lëndës së edukatës fizike është duke e përgatitur skuadrën futbollistike të meshkujve për turnirin e pritëm shtetëror të gjimnazeve. Mikpritës i turnirit është shkolla e tyre, sepse ajo i ka kushtet më të mira. Do zhvillojnë gara skuadra nga shumë shkolla, ndër të cilat edhe skuadra amë e fuqishme e një gjimnazi “shqiptar”, të cilën duhet ta mundin patjetër për ta mbrojtur nderin e gjimnazeve “maqedonase”.

Vlatko, Gorani, Ivani dhe të tjerë nga skuadra vijnë rregullisht dhe bëjnë trajnim dhe vërtet mundohen të bëjnë përgatitje sa më të mirë që mundet. Duke qenë se u duhet një mbështetje e fuqishme, mësimdhënësi është duke përgatitur veçanërisht edhe një grup tifozësh, të cilët, pas orëve të mësimi, përgatisin edhe transparente dhe kuptohet se e përgatisin edhe hitin e tifozërisë: “Dhe dil, djalo, drejt e në verandë”, si dhe mënyra të ndryshme skandimesh të tjera.

#### PËRGJIGJET QË PRITEN JANË KËTO:

- ➔ Ndarje ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve.
- ➔ Sjellje kompetitive ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve (“thyerje” e shqiptarëve dhe tifozëri, para së gjithash përmes lartësimi të maqedonasve).
- ➔ Të përgatiten nxënësit për një mënyrë tjetër tifozërie - në vend që të jetë e orientuar etnikisht ose në mënyrë etnocentrike, të jetë një tifozëri sportive dhe për shkollën.

### SITUATA 4.

Muaremi dhe Sasho njihen që nga mosha më e re. Gjithë fëmijërinë e kanë kaluar bashkë, nga mëngjesi gjer në mbrëmje. Që të dy shkojnë në të njëjtën shkollë, por në klasa të ndryshme. Muaremi është në klasën VII-A, kurse Sasho në klasën VII-B. Për faktin se ata duan që të jenë gjithmonë bashkë, edhe jashtë shkolle, u nxjerr problem. Shokët e Sashos, nga klasa e tij, përherë e vënë në siklet që shoqërohet me një rom dhe refuzojnë ta fusin Muaremin në shoqëri kur shkojnë në ngjarje argëtuese ose në ndonjë aktivitet sportiv. Kur Sasho iu ankua kujdestares së klasës për këtë, ajo e këshilloi që të rrijë anësh nga Muaremi, që të mos t’i provokojë të tjerët dhe të mos i qesë vetes telashe tjera.

### PËRGJIGJET QË PRITEN JANË KËTO:

- ➔ Ndarje ndërmjet maqedonasve dhe romëve.
- ➔ Paragjykime tek nxënësit maqedonas ndaj romëve, të fryra nga mësimdhënësit dhe për këtë shkak distancohen nga ata.
- ➔ I pakëson mundësitë për ndërveprim dhe njohje të anasjelltë dhe rritet ndarja.
- ➔ Të krijohen më tepër mundësi për aktivitete të përbashkëta jashtë mësimore dhe jashtëshkollore në të cilat do të mund të merrnin pjesë nxënësit romë.

### SITUATA 5.

Dy mësimdhënësve të mëimit klasor nga shkolla të ndryshme (njëra në Kratovë, kurse tjetra në Dibër), që ishin njohur dhe kishin bashkëpunuar shkëlqyeshëm gjatë një seminari, kanë vendosur që t'i përfshijnë nxënësit e tyre në realizimin e një projekti përmes internetit. Kur këtë e sheh një kolege e kësaj nga Kratova, komenton spontanisht: “Në vend që t’ua mësosh thyesat dhe barazimet (ekuacionet) që do t’u duhen në jetë, ti po e humb kohën me ca shqiptarë atje, të cilët asnjëherë në jetë edhe nuk do t’i shohin”. Njëkohësisht, edhe një kolege e asaj nga Dibra reagon: “Në vend që t’ua mësosh thyesat dhe barazimet (ekuacionet), ti po humb kohën duke komunikuar me shkrim me ca maqedonas atje. Nëse aq shumë ta do zemra të bësh diçka pikërisht me ata, ke këtu të atillë sa të të dojë zemra”.

### PYETJET QË PRITEN JANË:

- ➔ Ndarja ka të bëjë drejtpërdrejt mes mësimdhënësve dhe në mënyrë të tërthortë edhe mes nxënësve maqedonas dhe shqiptarë.
- ➔ Mësimdhënësit edhe nuk janë të vetëdijsëm për nevojën e integritit ndëretnik përmes arsimimit.
- ➔ I pakëson mundësitë për ndërveprim dhe njohje të ndërsjellë dhe rritet ndarja.

- ➔ Të ngritet vetëdija e mësimeve për nevojën e bashkëpunimit me kolegët nga bashkësia tjetër etnike, si dhe për nevojën e zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta me nxënësit nga bashkësia tjetër etnike, përmes krijimit të mundësive plotësuese për përfshirje të më shumë mësimeve dhe nxënësve.
- 

Pritet që ushtrimet e ofruara për studentët e fakulteteve për mësime ta thellojnë ndjeshmërinë e tyre ndërkulturore dhe t'i rrisin aftësitë e tyre në procesin për realizimin e integritit ndëretnik në mësime.



## 2. NJË PASQYRË E TEORIVE MBI MULTIKULTURALIZMIN, ZHVILLIMIN E AFTËSIVE NDËRKULTURORE DHE PARANDALIMIN E STEREOTIPEVE DHE PARAGJYKIMEVE

*Docent dr. Trajçe Stojanov*

### 2.1. KULTURA DHE IDENTITETI

Kultura është një process dinamike dhe kompleks i formimit.. Gjithçka që mendojmë se në realitet jemi, “nga lindja”, “nga natyra” ose “nga Zoti na është dhënë”, është një formim kulturor. Në kuptimin social, ne jemi qenie të krijuara. Asgjë prej asaj që na bën si qenie shoqërore nuk e kemi trashëguar nga gjenet, as religjionin tonë, as grupin, as përkatësinë etnike, madje as gjuhën. Të gjitha këto janë mësuar dhe krijuar përmes ndikimit të kulturës.

Kjo do të thotë se në masën më të madhe ne jemi një prodhim “rastësor” i mjedisit në të cilin jemi ndodhur. (Fig. 1 është ilustrim i disa prej faktorëve që na determinojnë). Kuptohet, përkatësia në një identitet të grupit nuk na bën të determinuar tërësisht dhe detyrimisht, por, megjithatë, një sjellje e caktuar këtë e bën më pak ose më shumë të mundshme.




Fig. 1 – Faktorët determinues

Përkufizimi i mësipërm i kulturës jep kuptimin më të drejtpërdrejtë dhe më të ngushtë të saj. Ndërkaq, nëse duam që kulturën të përkufizojmë më gjerësisht, do të thoshim thjeshtë se ajo është një program grupor për mbijetesë dhe përshtatje me mjedisin.<sup>7</sup> Ky program përbëhet nga dijet, konceptet, vlerat, të cilat bashkësisht i ndan përmes sistemit të komunikimit. Në këtë aspekt, kultura përbëhet nga bindjet, simbolet dhe interpretimet brenda vetë grupit.

<sup>7</sup> Bullivant, B. M. (1993). Culture: Its Nature and Meaning for Educators in J. A. Banks & C. A. M. Banks, *Multicultural education: Issues and perspectives* (2nd ed., pp. 29-47), Boston: Allyn & Bacon.

Kjo më tepër është një reprezentim simbolik, ideor dhe jomaterial i realitetit, diçka që përjetoni, që kuptoni dhe që interpretoni botën “përmes”. Pasoja e të kuptuarit kësodore të kulturës është kjo: identiteti ynë nuk zhvillohet në mënyrë të veçantë, ai është fryt i kulturës, historisë, traditës, mediave, arsimit, rrethanave, madje edhe i lidhjeve individuale dhe i rrëfimeve jetësore. Nëse kjo është kështu, atëherë ne si konstrukt me vështirësi mund të kuptojmë se jemi konstrukt (krijim, formim) përgjithësisht. Ne nuk kemi mundësi të njohim veten se jemi formuar nëpër atë proces të gjatë dhe të pavarësisht të ndikimit të kulturës.

Vërtet është vështirë të dilet përtej këtij identiteti social të formësuar gjatë kohë dhe të njohim po ashtu edhe rolin tonë në shoqëri. Prandaj, një qasje e këtillë ndaj identitetit si një formim (konstrukt) social, jep mundësinë që të shihet se të gjitha perceptimet tona, qëndrimet, bindjet, sjelljet dhe me këtë edhe stereotipet dhe paragjykimet, në një masë të madhe, janë krijuar, janë kalitur dhe imponuar përmes një procesi të gjatë të fermentimit social - historik.

Nga ky pozicion, mund të nxjerrim edhe këtë hipotezë - multikulturalizmi mund të inkorporohet në identitetin tonë! Kjo jep mundësinë për bazën teorike të konceptit për integrimin ndëretnik në arsim, i cili duhet të inkorporojë multikulturalizmin në arsim. Kjo duhet të bëhet pjesë e identitetit tonë individual dhe kolektiv, kryesisht përmes procesit arsimor. INA është mënyra më e përshtatshme për këtë, pikërisht se këtë e bën përmes ndërveprimit. Ideja qendrore në një masë të madhe e garanton suksesin e multikulturalizmit si integrim përmes ndërveprimit.<sup>8</sup>

Mandej, një e kuptuar e këtillë e konceptit të multikulturalizmit, si pjesë e identitetit individual dhe kolektiv, bëhet e mundshme që INA

të bëhet pjesë integrale e tërësisë së hapësirës arsimore në shtetin tonë, për arsye se synimi i saj nuk është vetëm që nxënësit të ekspozohen nga përmbajtjet multikulturore, por edhe multikulturalizmi të bëhet pjesë e identitetit të tyre.

Pra, nuk ka multikulturalizëm pa individ me identitet multikulturor! Dhe kjo u duhet edhe atyre që jetojnë në mjedise etnike relativisht homogjene, si dhe atyre që jetojnë në mjedise etnike heterogjene. Prandaj, çka na duhet më parë se kjo, jo vetëm mësimdhënës me aftësi multikulturore, por edhe qytetarë me identitet të përvetësuar shumëkulturor. Pikërisht për këtë INA është një koncept i dobishëm për t'u zbatuar në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.

Çështje kyçe për çdo arsimim multikulturor është që të rishqyrtohet ky proces i formimit të identitetit tonë. Kjo vërtet mund të kuptohet si rrezik, sepse kërkon nga të përfshirët të rishqyrtojnë veten dhe identitetet vetanake, të rishqyrtojnë diçka që është formuar gjatë kohë dhe që konsiderohet si relativisht e qëndrueshme. Por, kjo është mënyra e vetme që secili të përballlet me "sfidat" vetanake. Gjegjësisht, t'i detektojë dhe t'i mposhtë stereotipet dhe paragjykimet e veta. Kur

8 Më poshtë është dhënë një shpjegim i kësaj

mësimdhënësit dhe nxënësit nuk e shohin identitetin e vet si konstruksion (ndërtim) social, ata:

- ▶ nuk mund të mposhtin stereotipat dhe paragjykimet;
- ▶ nuk ndjejnë aftësinë dhe fuqinë për të futur ndryshime në vete dhe tek nxënësit;
- ▶ nuk mund të kultivojnë ndjeshmëri ndaj tjetrit, ndaj identitetit të tjetrit;
- ▶ nuk mund të futet shumëkulturalizmi si pjesë e gjithsecilit identitet vetanak;
- ▶ nuk mund të identifikohen si anëtarë, “pjesë” e identiteteve të ndryshme sociale, nëngrupe kulturore, njëkohësisht, nuk mund të shohin se, edhe pse të ndryshëm në shumë gjëra, megjithatë janë të ngjashëm, ngase ndonëse janë anëtarë grupesh të ndryshme etnike, kanë huazuar karakteristika të njëjta me pjesëmarrjen në ato grupe.
- ▶ nuk mund ta pasurojnë identitetin e vet dhe nuk mund t’i zgjerojnë përvojat e veta me faktin që identitetin e trajtojnë si të mbyllur dhe të përhershëm;
- ▶ i vënë kufizime edhe vetënjohjes, edhe vetëpërjetimit;
- ▶ kanë një vetëvlerësim të fshehur, që përbën pikënisjen për stereotipet dhe paragjykimet.

Të kuptuarit e kulturës si “program”, kurse e identitetit si konstrukt (formim, ndërtim), na hap një fushë të gjerë për zbatimin e konceptit të integritit ndëretnik në arsim, sepse një ndryshim i vogël, një variabël e vogël në atë “program”, do të nxisë ndryshime në atë se si e përjetojmë botën dhe njerëzit rreth vetes. Sjellja jonë mund të ndryshojë nëse futen në program një ide e re, një përfytyrim i ri, një perceptim i ri ose nëse ndryshohet e vjetra. Prandaj, edhe arsyeshmëria e të gjitha përpjekjeve tona për të përfshirë multikulturalizmin përmes INA do të sjellë edhe ndryshimin e para bindjeve, mposhtjen e stereotipeve dhe të paragjykimeve dhe përmirësimin e integritit.

## 2.2. NGA MULTIKULTURALIZMI GJER TEK NDËRKULTURALIZMI DHE NEVOJA E INTEGRIMIT NDËRETNIK NË SHOQËRINË E INTEGRUAR MULTIKULTURORE/ MULTIETNIKE

Në kuptimin më të gjerë, në kuptimin përkrahës, multikulturalizmi do të thotë e njëjta gjë si pluralizëm kulturor, gjegjësisht tregon shumëllojshmërinë,

shumanshmërinë dhe ndryshmërinë kulturore në një shoqëri. Por në një kuptim më të ngushtë të fjalës, në kuptimin normativ, kur thuhet multikulturalizëm, mendohet në ide, teori dhe praktikë, e cila duhet ta organizojë atë ndryshmëri kulturore që në mënyrë të barabartë do ta reflektonte identitetin e të gjitha kulturave. Multikulturalizmi si ide ndërlidhet me filozofinë politike e cila mëson t'i japë përgjigje ndryshmërisë në një shoqëri.

Mbështetësit e kësaj filozofie, diskursin e saj e bazojnë në bindjen se të drejtat dhe liritë individuale nuk janë të mjaftueshme për ta reflektuar, mbrojtur dhe përparuar ndryshmërinë kulturore, prandaj është i nevojshëm edhe një “set” i caktuar dhe special i të drejtave kolektive që duhet t'u njihet bashkësive të ndryshme kulturore në një shoqëri. Koncepti i këtillë promovon nevojën për të drejta të veçanta që i njihen një grupi të veçantë apo grupeve, që t'u jepet mundësia për të shprehur identitetin e tyre, si dhe rivendikimet e tyre, gjegjësisht, të drejtat.

Multikulturalizmi ka buruar nga shumë teori politike: “politika të identitetit”<sup>9</sup>, “politika të dallimeve”<sup>10</sup>, “politika të njohjes”<sup>11</sup> ose “të drejtat e diferencuara grupore”<sup>12</sup>. Pa hyrë veç e veç të flasim mbi secilën nga këto teori, të gjitha këto kryesisht mund t'i përmbledhim se rrjedhin nga dy burime.

I pari vjen nga komunitaristët<sup>13</sup> dhe kritika e tyre ndaj liberalizmit. Në të vërtetë, paraqitjet e para të multikulturalizmit erdhën pikërisht

9 Gutmann, A., 2003, *Identity in Democracy*, Princeton: Princeton University Press

10 Young, I.M., 1990, *Justice and the Politics of Difference*, Princeton, NJ: Princeton University Press

11 Taylor, C., 1992, “The Politics of Recognition,” in *Multiculturalism: Examining the Politics of Recognition*, A. Gutmann (ed.), Princeton: Princeton University Press

12 Kymlicka, W. 1989, *Liberalism, Community, and Culture*, Oxford: Oxford University Press

13 Me komunizëm nënkuptohet një filozofi politike dhe sociale, e cila në plan të parë e vendosë bashkësinë, më saktë-bashkësinë para individit. Këto teori depërtojnë në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar si një kundërpërgjigje ndaj liberalizmit dhe libertarianizmit, edhe pse vetë nocioni “komunitarizëm” është brumosur në 1841 nga Gudvin Barbi. Mes përfaqësuesve më të njohur të kësaj teorie është filozofi kanadez Çarls Tejlor dhe amerikanë Majkëll Sandell, dhe ai britanik Alisdir Mekintaer

nga tabori i komunitaristëve. Kështu, mbrojtësit e multikulturalizmit fillimisht ishin tërhequr nga komunitarizmi, si një bazë e mundshme filozofike për të drejtat e pakicave”(…), gjegjësisht, evoluimi i natyrshëm i komunitarizmit mori kahe drejt një forme të multikulturalizmit”.<sup>14</sup> Për komunitaristët, kolektiviteti vihet para individit dhe, më tepër, individ është fryt i kolektivitetit. Me këtë, për mendimin e tyre, grupi (bashkësia) vjen para individit. Në këtë kuptim, të gjitha të mirat shoqërore patjetër t’u ofrohen të gjithëve. Sikundër do të kishte thënë Tejlor, njëri nga përfaqësuesit më të njohur i teorisë së të mirave shoqërore, këto janë pikërisht të mira shoqërore, sepse u përkasin të gjithëve. Në këtë kuptim, nuk mund ndonjë grup, për vetë faktin se është “i ndryshëm” të mos ketë qasje në të gjitha të drejtat, së këndejmi, komunitaristët e shikojnë multikulturalizmin si mënyrën më përkatëse për mbrojtjen e bashkësive nga efekti shembës i autonomisë individuale”.<sup>15</sup>

Burimi i dytë i multikulturalizmit vjen, në të vërtetë, nga suazat e vetë teorive dhe të teoricienëve liberal. Përfaqësuesi më i njohur mes tyre, Vil Kimlika, thotë që pikërisht

për shkak të vlerave themelore të liberalizmit autonomia, liria dhe barabarësia e individëve mund t’u bëjnë të mundshme më shumë të drejta grupeve, të cilat vetëm për nga ndodhjet e rastësisë përbëjnë pakicën në një shoqëri dhe nuk mund të kenë përgjegjësinë për situatën e tyre.

Ai përpiqet ta rishikojë idenë liberale që thotë se individ vetë dhe vetëm ai është përgjegjës për fatin e vet, me atë që do në teorinë liberale të inkorporojë idenë e bashkësisë. Në të vërtetë, sikundër thotë edhe vetë Kimlika, “ca rivendikime për të drejtat e pakicave i forcojnë vlerat liberale”.<sup>16</sup>

Kimlika pajtohet me teorinë liberale dhe pohon se të gjithë ne jemi përgjegjës për veprimet tona dhe përmes atyre veprimeve ndërtojmë jetën tonë dhe nga ato varet edhe suksesi dhe fati ynë. Megjithatë, disa rrethana nuk mund t’i ndryshojmë, as që ne vetë i krijojmë. Nuk mund ta pranojmë pabarazinë vetëm për faktin se ajo buron nga vetë fakti se i takojmë grupit pakicë, sepse kjo nuk ka qenë vendimi ynë dhe për atë ne nuk mund të jemi përgjegjës. Prandaj, duhet të merren parasysh këto pabarazi dhe të pranohet sfida për kapërcimin e tyre. Kjo përmbledh shkurtimisht thelbin e pikëpamjeve të multikulturalizmit. Për

14 Vill Kimlika, *Filozofia politike bashkëkohore, Shtypi akademik, Shkup, 2009, 361* Ckonje,

15 Po aty, faq. 361

16 Po aty, faq. 367

çdo rast, të dyja pikëpamjet e afirmojnë qëndrimin se kultura, gjegjësisht grupet e ndryshme kulturore, duhet të vihen në qendër të teorisë dhe të praktikës politike. Shteti nuk duhet të rrijë indiferent ndaj kulturës dhe ndaj dallimeve kulturore. Dhe, pikërisht për këtë, këto “të drejta të diferencuara grupore” (Kimlika), përfshijnë përjashtime nga praktikat ekzistuese, krejt me qëllimin që grupeve të ndryshme t’u jepet mundësia e reflektimit mbi veçantitë dhe të drejtat e tyre. Përjashtimet e këtilla nënkuptojnë aktivitete të ndryshme: nga fletëvotimet shumëgjuhëshe për zgjedhjet, përmes financimit të shkollave në gjuhët e pakicave dhe gjer tek kuotat dhe “diskriminimi pozitiv” në arsim, në punësimet në aparatin shtetëror e të ngjashme. Kjo shkon edhe më tutje sa këto “të drejta grupore të diferencuara” ndonjëherë mund drejtpërdrejt ta kufizojnë lirinë ose të drejtat e atyre individëve që janë pjesë e atij grupi, për të vetmin qëllim që anëtarëve të grupit t’ua bëjë të mundshme që ta mbrojnë kulturën e tyre dhe t’i realizojnë të drejtat e tyre. Me këtë, koncepti i multikulturalizmit bëhet praktikë, jetësohet, sepse, në këtë rast, bëhet fjalë për ndërkulturalizëm, përmes ndërkulturës, kurse në rastin tonë, në Maqedoni, ka marrë një intonim kryesor si integrim ndëretnik.

Por, shumë shpejt u vërejt se multikulturalizmi nuk është i mjaftueshëm. Koncepti i multikulturalizmit u sfidua nga praktika dhe u vu në situatë që kërkonte një rishqyrtim të tij.

Ngjashmërisht, si edhe me situatën në Maqedoni, u tregua se “politikat e njohjes”, e “të drejtave grupore të diferencuara” dhe të ngjashme, nuk patën sukses që të bëjnë të mundshëm një inkluzion në shoqëri të grupeve të ndryshme kulturore, por ndodhi e kundërta, e ndanë shoqërinë dhe e thërrmuan, i ndanë dhe i getoizuan bashkësitë. Kështu lindi koncepti i quajtur ndërkulturalizëm, që insiston për një dialog ndërkulturor, mirëkuptim reciprok dhe mbështetje të ndërsjellë.

Në këtë aspekt, multikulturalizmi mund të konsiderohet si “pasi”, një koncept përshkruar i cili vetëm që e reflekton një gjendje të caktuar të pluralizmit kulturor, që reflekton ekzistencën e më tepër kulturave në një hapësirë, por që kjo nuk do të thotë që ajo gjendje paraqet një komunikim të përbashkët kulturash që ndajnë atë hapësirë. Multikulturalizmi përbën bazën e nevojshme, bazën filltare. Pa një koncept të qartë dhe të elaboruar të multikulturalizmit nuk ka pranim të ngjashmërive, por as respektim të dallimeve. Multikulturalizmi, në

realitet, është pikërisht vetëdija se kulturat kanë specifikat e tyre, po ashtu edhe dallimet e tyre dhe pikërisht për këtë është e nevojshme të pranohen ngjashmëritë dhe respektimi i dallimeve.

Ndërkaq, ndërkulturalizmi është “dinamik”, por edhe koncept normative, i cili insiston kryesisht në nevojën për dialog dhe ndërveprim, por edhe bashkëpunim dhe respektim reciprok ndërmjet kulturave. Ky në këtë aspekt paraqet një program për veprim shoqëror. Së këndejmi, ndërkulturalizmi paraqet edhe proces që synon drejt ndryshimeve cilësore në një mjedis multikulturor. Për arsye se tashmë nuk është i mjaftueshëm vetëm fakti i perceptimit të multikulturalizmit në shoqëri, tashmë nuk është e mjaftueshme vetëm toleranca, sepse toleranca është një princip pasiv; nuk është e mjaftueshme vetëm njohja e faktit të multikulturalitetit të shoqërisë, është i nevojshëm integrimi.

Por, për integrimin është i domosdoshëm, në radhë të parë, ndërveprimi! Integrimi është rezultat i ndërveprimit, kurse ndërveprimi, prapë është kusht për integrim. Nuk mund të integrohemi nëse fare nuk komunikoni. Prandaj, ideja për integrim ndëretnik në arsim dhe ky botim janë

konceptuar dhe janë nisur nga ideja për integrim përmes ndërveprimit. Vetëm kontaktet e ndërsjella mund t'i integrojnë bashkësitë.

Ndërkaq, integrimi do të thotë më tepër se bashkekzistimi i disa kulturave brenda një hapësire (prandaj edhe koncepti i multikulturalizmit tashmë nuk është i mjaftueshëm); integrimi do të thotë më tepër se njohje dhe respektim të asaj ndryshmie. Përse? Për arsye se aspekti i parë -bashkëjetesa- është pasivitet, këtu ne nuk bëjmë asgjë, përveç se e konstatojmë atë fakt të thjeshtë se një hapësirë e ndajnë disa kultura. Kulturat bashkekzistojnë edhe pa vetëdijen tonë ndaj këtij fakti. Aspekti i dytë -pranim dhe respektim- është vetëm një mungesë shovinizmi dhe ksenofobie dhe përsëri nuk ngërthen më vete ndonjë komponentë aktive. Çfarë duhet të bëjmë që në mënyrë aktive të pranohen dhe të respektohen? Asgjë, përveç se ta përmbajmë veten që “të mos e shfarosim tjetrin”!


Kjo tregon se edhe dy aspektet nuk kërkojnë përpjekjen tonë të vetëdijshme për ta ndryshuar.

Por, kur bashkëjetesa supozon jo vetëm ndarje bashkë në një hapësirë të njëjtë dhe jo vetëm pranim dhe respektim (tolerancë), por edhe bashkëpunim të ndërsjellë, afrim njëri me tjetrin për të


siguruar bashkëjetesë të përbashkët - atëherë bëjmë fjalë për ndërkulturën dhe integrimin. Është e pamundshme që të kemi shoqëri të integruar, nëse individët nga bashkësitë e ndryshme etnike e kulturore fare nuk kanë kontakte mes tyre. Në një rast të këtillë ndoshta edhe do të ketë një paqe dhe rend aparent (që duket nga jashtë), por ajo në themelin e vet do ta ruajë konfliktin potencial. Bashkekzistenca dhe toleranca aparente janë një konflikt i ngrirë. Prandaj bashkëjetesa nuk është e mjaftueshme, është e nevojshme edhe jeta e përbashkët. Pra, thënë përmbledhtas, bëjmë fjalë për tri situata në lidhjet shumëkulturore.<sup>17</sup>

1. **SEGREGACIONI** - kur kulturat ekzistojnë në një hapësirë, por janë tërësisht ta ndara, të veçuara nga njëra-tjetra.
2. **PARALELIZMI** - kur kulturat ekzistojnë njëra pranë tjetrës, pa ndërveprim dhe bashkëpunim të ndërsjellë.
3. **INTEGRIMI** - kur ekziston besim i ndërsjellë dhe bashkëpunim ndërmjet kulturave për sigurimin e ekzistencës së përbashkët.

<sup>17</sup> Ushtrimet janë marrë nga materiali punues: Integrimi ndëretnik në arsim. Trajnime për ekipe të integrimit shkollor. Projekt për Integrimin Ndëretnik në Arsim. QDNJZK në partneritet me QMEQ, Qershor 2013



*Bashkekzistencë me segregacion*



*Bashkekzistencë me paralelizëm*



*Bashkekzistencë me integrim*

**Fig. 2 – Mënyra të bashkekzistencës ndërmjet kulturave**

Në rastin e parë, njerëzit rrinë njëri pranë tjetrit; në rastin e dytë janë njëri me tjetrin, kurse vetëm në rastin e tretë janë bashkë dhe njëri për tjetrin. Kjo i jep kuptim përbashkësisë - njëri për tjetrin, sepse synimi është i përbashkët, ai kërkon që të jenë njëri për tjetrin, ngase nuk mundet njëri pa tjetrin.

Dhe, kështu mund të themi se bashkekzistenca e disa bashkësive etnike, të cilat përveç se ndajnë një hapësirë edhe mbështesin njëra-tjetrën për të siguruar ekzistencën, supozon një shoqëri ndëretnike të integruar.<sup>18</sup>

Në Maqedoni bashkësitë e ndryshme etnike shfaqin një nivel të lart të distancimit nga njëra-tjetra. Hulumtimet empirike kanë detektuar një nivel themelor të bashkëpunimit dhe integritetit.<sup>19</sup> Mbi bazë të këtyre hulumtimeve mund të nxirren këto përfundime mbi raportet e bashkësive të ndryshme etnike ndaj njëra-tjetrës:

- ▶ Maqedonasit dhe shqiptarët jetojnë paralelisht - njëri pranë tjetrit.
- ▶ Romët mbajnë një distancë të njëjtë si ndaj maqedonasve, ashtu edhe ndaj shqiptarëve.
- ▶ Serbët “përzihen” me maqedonasit, por rrinë të distancuar ndaj shqiptarëve.
- ▶ Turqit “përzihen” kryesisht me shqiptarët, kurse janë disi më të distancuar ndaj maqedonasve.

Në të gjitha këto situata shohim se bashkësitë ose janë njëra pranë tjetrës, të segreguara dhe të veçuara ose, në rastin më të mirë, jetojnë në mënyrë paralele; dhe në asnjë rast asnjëra nga bashkësitë nuk jeton “njëra për tjetrën”, në asnjërin rast nuk kemi bashkekzistencë me integrim. Pikërisht kjo është gjendja të cilën konsiderojmë se duhet ndryshuar vetëm përmes arsimimit.

Mund të themi lirisht se në një masë të madhe situata është e atillë pikërisht për shkak të arsimit i cili “prodhon” tendenca të atilla. Në të vërtetë, në shkollat shumëgjuhëshe në Maqedoni, një pjesë e madhe e nxënësve janë shpërndarë mbi bazë të gjuhës mësimore - ose në turne të ndryshme, ose në pjesë të ndryshme të shkollës, madje jo rrallë edhe në ndërtesa të ndryshme, të veçanta. Derisa

18 Ushtrimet janë marrë nga materiali punues: Integrimi ndëretnik në arsim. Trajnime për ekipe të integritetit shkollor. Projekt për Integrimin Ndëretnik në Arsim. QDNJZK në partneritet me QMEQ, Qershor 2013

19 Hulumtimi Gjendja fillestare në lidhje me integrimin ndëretnik në arsim realizuar në vitin 2012: [http://mk.pmio.mk/wp-content/uploads/2013/04/IIEP-BASELINE-STUDY\\_MAC.pdf](http://mk.pmio.mk/wp-content/uploads/2013/04/IIEP-BASELINE-STUDY_MAC.pdf).

në shkollat njëgjuhëshe, nxënësit - pjesëtarë të vetëm prej njëres nga bashkësitë nuk kanë kurrfarë mundësie për afrim dhe komunikim me nxënës të gjuhës dhe të bashkësisë tjetër.<sup>20</sup>

Dhe pikërisht kjo është gjendja të cilën, në të vërtetë, duam ta ndryshojmë - të punojmë për të krijuar një shoqëri të integruar. Ndërkaq, ai ndryshim duhet të ndodhë patjetër në arsim, prandaj edhe mendojmë se ideja për integrim ndëretnik në arsim është çelësi i ndryshimit. Njëri nga teoricienët më eminent, të cilin edhe e përmendëm më parë, Tejlor, në studimin e tij “Politikat e njohjes”, kur flet për “njohjen” e vlerës së kulturave dhe identiteteve të ndryshme, menjëherë përmend shkollën si vendin ku kjo njohje operacionalizohet.<sup>21</sup>

Shkolla edhe me kurrikulat (e dukshme dhe të fshehura), por edhe me praktikën e përgjithshme pedagogjike duhet ta implikojë, të reflektojë dhe ta promovojë ndryshimin. Në këtë aspekt, vetëm përmes arsimimit mund të përftoheshin aftësitë ndërkulturore dhe të kultivohet ndjeshmëria ndaj

tjetrit si dhe të formohet personaliteti mbi bazë të principeve të demokracisë dhe barabarësisë së të drejtave të njeriut.

Neve na duhen *shkolla* që do ta promovojnë dhe përparojnë integrimin ndëretnik, *sepse vetëm individët që dalin nga ato shkolla, atë integrim do ta promovojnë në shoqëri.*

## 2.3. ARSIMI I INTEGRUAR NDËRETNIK DHE ZHVILLIMI I AFTËSIVE NDËRKULTURORE

Në këtë aspekt, integrimi ndëretnik në arsim është, para së gjithash, një ide, por edhe një reformë dhe me vetë këtë është edhe një proces, synimet kryesore të të cilit janë që ta ndryshojnë strukturën e arsimit dhe të institucioneve arsimore. Ai proces duhet të depërtojë deri aty që gjithçka është pjesë e sistemit arsimor, të gjitha materialet, plan programet mësimore, por edhe të gjitha sjelljet e qëndrimet e të përfshirëve në këtë proces, të ndryshojnë në mënyrën që të nxisin barabarësi arsimore dhe përfshirje të të gjitha dallimeve.

Por, më tepër se kaq, integrimi ndëretnik në arsim duhet të sigurojë kontakt dhe ndërveprim të të gjitha

20 Po aty

21 Taylor, C., 1992, “The Politics of Recognition,” in *Multiculturalism: Examining the Politics of Recognition*, A. Gutmann (ed.), Princeton: Princeton University Press

bashkësive etnike mbi bazë të synimeve të përbashkëta dhe aktiviteteve. Dhe, pikërisht për këtë, siç thamë, mësimi i integruar ndëretnik përbën edhe një proces reformues, për shkak se supozon ndryshime të të gjitha variabëlve e jo vetëm të kurrikulës, të përmbajtjeve ose të programeve mësimore. Dhe, së këndejmi, kuptohet, integrimi ndëretnik në arsim nuk është vetëm reformë më vete, po në njëfarë kuptimi përbën edhe një kahje, realizimin e të cilit duhet të synojmë përherë dhe ky ideal përbën një sfidë serioze për secilin që është përfshirë në procesin arsimor, për mësimdhënësin, drejtorin, prindin, nxënësin dhe shoqërinë më të gjerë. Kjo është një sfidë për të gjithë, e denjë për të dhënë përpjekjet tona në realizimin e saj.

Integrimi ndëretnik në arsim është shumë i rëndësishëm edhe për shkak të një aspekti tjetër, në realitet po ashtu të rëndësishëm, sepse ky, në njëfarë mënyre, është orientuar kah përvetësimi i shkathtësive sociale dhe i dijeve, për dallim nga ato shkathtësi dhe dije tërësisht akademike ndaj të cilave tradicionalisht insistojnë të anojnë shkollat. Shkollat në parim janë strukturuar që ta venë theksin në nxënien e shkathtësive, dituritë shkencore dhe aftësive akademike, gjegjësisht, të shkathtësive themelore të leximit, shkrimit ose shkathtësive

numerike. Kështu, për shembull, edhe testimi madje është orientuar vetëm tek shkathtësitë bazike akademike. Rrallë testohen shkathtësitë sociale, gjë e cila e shmang nxënësin prej një arsimim më të gjerë, liberal, që i nevojitet për ekzistencë më efektive në botën multikulturore.

Është e kuptueshme se nxënësve u nevojiten domosdoshmërisht shkathtësitë numerike dhe shkathtësitë për të shkruar dhe lexuar, si edhe dituritë akademike. Por ata duhet të përftojnë dituri, shkathtësi dhe vlera të cilat do t'ua mundësojnë të jetuarit, të komunikojnë ndërmjet tyre dhe të marrin vendime bashkë me bashkëqytetarë të grupeve të ndryshme etnike, religjioze dhe gjuhësore. Prandaj arsimimi multikulturor, në realitet, është një arsimim për socializim. Përmes tij ata bëhen të ndjeshëm ndaj asaj që, në kuptimin më të përgjithshëm, quhet drejtësi sociale, me të cilën përfitojnë potencialin që të bëhen qytetarë aktivë dhe pjesëmarrës, që përbën themelin e demokracisë liberale. Nuk ka demokraci pa individë me kapacitet demokratik.

Në realitet, problemet më të mëdha sot, si në botë ashtu dhe tek ne, sigurisht që nuk janë rezultat i faktit pse njerëzit nuk dinë të lexojnë dhe të shkruajnë, por për faktin se

pjesëtarët e bashkësive të ndryshme etnike, grupet etnike dhe religjionet nuk kanë mundësi të bashkëpunojnë nëpër zgjidhjen e problemeve të tyre të përbashkëta. Me gjasë edhe tek ne, nëse të gjitha grupet etnike, do t'i mbledhnin bashkërisht fuqitë kah qëllimet e përbashkëta dhe do të punonin me një harmoni të ndërsjellë dhe pajtimtare, pjesa e madhe e problemeve të përbashkëta shumë më lehtësisht do të ishin kapërcyer.

Ja, pra, përse është me rëndësi integrimi ndëretnik në arsim. Por, të themi sërish, nuk duhet menduar se integrimi ndëretnik në arsim nënkupton vetëm ndryshimin e programit mësimor, të kurrikulave dhe të futjes së përmbajtjeve prej kulturave të ndryshme. Kjo nuk mjafton. Ky është të kuptuarit të thjeshtësuar dhe jo i përshtatshëm i konceptit.

Sikundër edhe multikulturalizmi përshkoi një evolucion gjer në ndërkulturalizëm, edhe ndërkulturalizmi dhe integrimi ndërkulturore, ashtu edhe arsimimi multikulturore, nuk janë vetëm përvetësim dijesh për konceptin, madje nuk janë vetëm përfitim aftësish të caktuara, por më tepër se aty - aty është vendi i takimit të kulturave! Arsimit, veçanërisht sipas konceptit që e promovon ky botim, është vend i integritit.

Në shkollë patjetër se takohemi me *tjetrin*. Mund të inkurajohemi, madje edhe të themi se integrimi ndëretnik në arsim për Maqedoninë përbën një *condition sine qua non* për ekzistencën e konceptit multikulturalizëm! Pa integrimin asnjëfarë multikulturalizmi nuk mund të qëndrojë. Kjo sepse, sikundër thamë, multikulturalizmi nuk është vetëm bashkekzistencë, ekzistim njëra pranë tjetrës i bashkësive të ndryshme etnike; multikulturalizmi nuk është madje vetëm njohje dhe pranim i kulturave të ndryshme. Multikulturalizmi është sinergji, një afrim reciprok dhe bashkëpunim për sigurimin e ekzistencës dhe ardhmërisë së përbashkët. Dhe këtë mund ta sigurojë vetëm arsimit i integruar ndëretnik, në të cilin jo njëri pranë tjetrit, jo madje as njëri me tjetrin, por para së gjithash njëri për tjetrin punojnë bashkërisht në hapësirën e përbashkët që e ndajnë, në synimet e përbashkëta ku e gjejnë lidhjen mes tyre, për ardhmërinë e përbashkët që e presin. Ndërkaq, për atë ardhmëri të përbashkët punohet sot.

Vetëm si me këtë rast flasim për ndërkulturalizëm, i cili, në këtë rast, realizohet përmes konceptit të arsimit të integruar ndëretnik. Prandaj themi që arsimimi multikulturore nuk është i mjaftueshëm. Sepse, ajo që nënkuptohet vetëm si ekspozim i të

gjithë nxënësve ndaj përmbajtjeve të kulturave të të tjerëve, me çka arrihet njëfarë niveli i respektit ndaj tjetrës, por këtu mungon kontakti, që është shumë me rëndësi për thellimin e lidhjeve ndëretnike dhe për krijimin e mundësisë për jetë të përbashkët. Arsimi multikulturor nuk është i mjaftueshëm, koha është për t'u ngjitur në një nivel më lartë.

Integrimi ndëretnik në arsim, në Republikën e Maqedonisë, para së gjithash, do të thotë kontakt ndërmjet pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme kulturore / etnike / gjuhësore. Ndërkaq, që të vendoset ky kontakt nevojitet planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta, si mësimore ashtu edhe jashtë mësimore mes nxënësve. Edhe njëherë të themi - theksi vihet në aktivitetet e përbashkëta të pjesëtarëve të grupeve të ndryshme kulturore / etnike / gjuhësore. Dhe pastaj, nuk është shumë me rëndësi se çka përfshin aktiviteti i përbashkët, por me rëndësi është vetëm fakti se ai bëhet bashkërisht.

Për këtë arsye është shumë me rëndësi që kjo të bëhet bashkërisht, të jetë me interes të përbashkët për të gjithë ata që janë përfshirë në këtë proces. Në këtë aspekt, nuk është me rëndësi vetëm produkti i aktivitetit të përbashkët, por edhe procesi

që përshkoi krijimi i këtij produkti. Vetëm në këtë mënyrë nxënësit - pjesëmarrës në këtë proces, vendosin një komunikim dhe mësojnë për njëri - tjetrin dhe, vetëm në këtë mënyrë, do të stërviten për ndërveprim. E gjithë kjo do të bëjë që të pakësohen paragjykimet dhe stereotipet, do të rritet niveli i bashkëpunimit dhe do të krijohen raporte të ndërvarshmërisë.

Kjo mënyrë e komunikimit të ndërsjellë dhe e njohjes në finale do të sjellë pashmangshmërisht krijimin e marrëdhënieve ndërpersonale. Kjo paraqet qëllimin kyç dhe kryesor të të gjithë procesit. Ky proces i komunikimit ndëretnik doemos duhet të ngritet në nivelin e komunikimit ndërpersonal, sepse çdo komunikim, në thelb, është dialog ndërmjet personave.

Ndërkaq, gjendja e deritanishme, sikundër e tregojnë hulumtimet,<sup>22</sup> është se komunikimi ndëretnik, kryesisht është komunikim ndërgrupor. Ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë se me tjetrin komunikojmë nga pozicioni i bashkësisë sonë dhe si bashkësisë tjetër, si me një që është "i ndryshëm" nga ne. Në një komunikim të atillë është e theksuar shumë qartë ndarja

<sup>22</sup> Hulumtimi *Gjendja fillestare në lidhje me integrimin ndëretnik në arsim realizuar në vitin 2012*: [http://mk.pmio.mk/wp-content/uploads/2013/04/IIEP-BASELINE-STUDY\\_MAC.pdf](http://mk.pmio.mk/wp-content/uploads/2013/04/IIEP-BASELINE-STUDY_MAC.pdf).

në NE dhe JU! Këtu nuk ka dialog, sepse dialogu nënkupton individë, këtu mungon individi, mungon edhe lidhja njerëzore.

Në një ndarje të këtillë grupi etnik bën trysni të fuqishme ndaj individit që të mos largohet nga grupi dhe ai është i detyruar që të mendojë dhe të veprojë njësoj si grupi, përndryshe do të mund të shpallet “tradhtar”. Dhe pikërisht për këtë, një situatë e këtillë nënkupton dhe stereotipe dhe paragjykime të manifestuara fuqishëm *ndaj tjetrit*, ndaj bashkësisë tjetër, me ç’ rast, kuptohet, *për veten* ka mendim të lartë dhe pozitiv, kurse *për tjetrin*, ka mendim të ulët dhe negativ. Burimi kryesor i stereotipeve dhe i paragjykimeve është pikërisht pamundësia për të dalë nga grupi të cilit i takon dhe të komunikohet si njeriu me njeriun, individi me individin. Stereotipi do të thotë pafuqi për ta kapërcyer veten, të ngrihemi, të vështrojmë përtej vetes sonë.

Prandaj, synimi *i arsimit ndëretnik të integruar është që komunikimin ndëretnik ta ngrejë nga komunikimi ndërgrupor në komunikim ndërpersonal!* Në një mënyrë, në komunikimin e këtillë komunikojnë individë dhe jo grupe ose etnose. Ata bisedojnë mbi tema me interes të përbashkët, pavarësisht nga përkatësia e tyre. Në një komunikim të

këtillë pajtohemi apo nuk pajtohemi me bashkëbiseduesin jo për shkak të faktit se jemi “të ndryshëm”, por për shkak të materies që e kemi vënë për diskutim, e cila është e përbashkët.

Cili do ishte roli i përkatësisë etnike, kulturore ose gjuhësore, nëse bisedojmë rreth një teme me interes të përbashkët? Minimale, thuaja asfarë, sepse në komunikimin ndërpersonal nuk i kushtohet shumë vëmendje përkatësisë etnike, se sa individualitetit. Gjatë një komunikimi të këtillë, ne nuk duam të poshtërojmë apo të lëndojmë njëri – tjetrin, kryesisht, dhe në radhë të parë, si individë dhe mandej si pjesëtar i ndonjë bashkësie. Në komunikimin ndërpersonal ne bëhemi shokë jo për shkak të përkatësisë sonë etnike, kulturore, por për hir të individualitetit tonë që bisedon me një individualitet tjetër.

Prandaj, njëri prej synimeve kyçe të integritetit ndëretnik në arsim është vendosja e komunikimit ndërpersonal, sepse vetëm kjo, më në fund, mund të na shpjerë në shoqëri të integruar. Ndërkaq, shoqëria e integruar nënkupton që secili qytetar ta kultivojë dhe ta ruajë identitetin e vet, por edhe ta zhvillojë dhe të ruajë identitetin e përbashkët, gjegjësisht përkatësinë

në Republikën e Maqedonisë.<sup>23</sup> Me konceptin e integritit ndëretnik në arsim do të futen ndryshime në sistemin arsimor, të cilat, në finalitetin e vet, do ta ndryshojnë shoqërinë. Në të kundërtën, do të vazhdojë tendenca e segregacionit dhe e distancimit të ndërsjellë ndërmjet bashkësive etnike.

Në çfarë mënyrë mund ta promovojë shkollandërveprimin ndëretnik? E para, të gjithë faktorët e procesit arsimor duhet patjetër që të sensibilizohen për rëndësinë e integritit ndëretnik. Të gjithë faktorët e procesit arsimor - mësimit, nxënësit, prindërit, drejtorët, shërbimet profesionale ose ato ndihmëse, si dhe bashkësia më e gjerë, duhet patjetër të kuptojnë se problemi ekziston, por ekziston edhe zgjidhja. Pa pranuar faktin se bashkësitë etnike në Maqedoni jetojnë në botë paralele dhe se kjo nuk është gjë e mirë, nuk mund të fillojmë për të punuar për ndryshimin e gjendjes.

Pasi që “ta pranojmë” këtë fakt, secila shkollë duhet të fillojë për ta hartuar politikën e cila do ta bëjë të mundshme planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve për integritim ndëretnik,

të dizajnuara sipas karakterit të vet shkollës. Patjetër të ndërmerret një kurs i përgjithshëm që demonstroi vullnetin e shkollës që, në mënyrë të vazhduar dhe afatgjatë, do të punojë rreth integritit ndëretnik. Ajo politikë duhet të mbajë llogari për t’i përfshirë të gjithë faktorët e procesit arsimor: mësimit, fëmijët, prindërit dhe komuna, si dhe t’i operacjonalizojnë aktivitetet e tyre me një program konkret.

Pra, në bazë të atij plani të përgjithshëm duhet përpunuar një plan konkret për aktivitetet e përbashkëta të nxënësve. Pa planifikimin e aktiviteteve të përbashkëta nuk mund të ketë realizim të suksesshëm. Në prapë themi – duhet të kihet parasysh se aktivitetet e përbashkëta duhet të bëhen vërtet interesante për nxënësit dhe të burojnë nga interesimi i tyre, në mënyrë që të mundin të nxisin motivimin e nxënësve dhe t’i angazhojnë ata më gjatë kohë. Prandaj është me rëndësi që në planifikimin e aktiviteteve të përfshihen të gjithë nxënësit. Kjo, mandej, nënkupton një nivel të lartë të demokratizimit të shkollës. Shkolla duhet patjetër që të punojë në një atmosferë për marrjen e përbashkët të vendimeve të rëndësishme, dhe kjo do të krijojë ndjesinë për përkatësi dhe kontribut të përbashkët, çka në realitet përbën edhe çelësin e suksesit.

23 Ushtrimet janë marrë nga materiali punues: Integritim ndëretnik në arsim. Trajnime për ekipe për integritim shkollor. Projekt për Integritimin Ndëretnik në Arsim. QDNJZK në partneritet me QMEQ, Qershor 2013

Plani konkret tash duhet të shkrihet në aktivitete konkrete, të cilat, nga ana e tyre, mund të jenë mësimore dhe jomësimore. Planet mësimore mund të realizohen në orët e mësimit që për nga karakteri i tyre japin mundësi për aktivitete të përbashkëta ndëretnike, sikundër janë, për shembull, orët e edukimit muzikor ose vizatimor, ose orët e gjuhëve të huaja, si dhe orët e edukatës fizike ose të kujdesit për shëndetin. Gjithashtu, aktivitetet mësimore mund të realizohen përmes aktiviteteve të ndryshme në bazë të projekteve në suazat e lëndëve të rregullta mësimore, mësimi në natyrë, këmbimi i mësimdhënësve, materiale e të ngjashme.

Ndërkaq, në suazat e aktiviteteve jashtë mësimore mund të zhvillohet një spektër i gjerë aktiviteteve dhe të gjitha në drejtim të integritimit ndëretnik: nga ekskursionet, piknikët, vizitat, miqësimet e ndërsjella, përmes festimeve të përbashkëta, shfaqjeve, argëtimit dhe të tjera aktivitete argëtuese dhe shoqërore, gjer tek aktivitetet që trazojnë çështjet e përbashkëta dhe të përgjithshme, sikundër janë aksionet ekologjike, aktivitetet humanitare dhe angazhimet në bashkësi, por edhe aktivitetet e lira të nxënësve nëpër seksione të dramës, të pikturës, të korit, e të ngjashme.

Për çdo rast, çfarëdo që të jenë aktivitetet mësimore ose jomësimore, afatshkurtra ose afatgjata, në secilin prej tyre duhet të tregohet kujdes ndaj këtyre kriterëve, të cilat secilin aktivitet duhet ta realizojë në mënyrë që të trajtohet si aktivitet i përbashkët, ndëretnik:

- ▶ Grupi i nxënësve duhet të jetë i balancuar sipas përkatësisë etnike.
- ▶ Aktivitetin duhet ta zhvillojnë mësimdhënësit nga radhët e grupit të përfaqësuar etnik, gjuhësor.
- ▶ Pjesëmarrësit nga radhët e bashkësive të ndryshme duhet që të trajtohen barabarësisht dhe paanshmërisht nga ana e realizatorëve të aktiviteteve.
- ▶ Të përdoren të gjitha gjuhët mësimore në mënyrën sa më të barabartë të mundshme.
- ▶ Temat / aktivitetet të përzgjidhen bashkërisht nga ana e të gjitha bashkësive të përfaqësuar.
- ▶ Çdoherë të punohet rreth synimeve dhe rezultateve konkrete, të prekshme dhe që janë rezultat i aktivitetit të përbashkët i të gjitha bashkësive etnike.
- ▶ Të organizohen takime të rregullta që do të krijojnë mundësinë për ngritjen e nivelit të komunikimit ndërpersonal.
- ▶ Të punohet në atmosferë bashkëpunimi të ndërsjellë, dhe

nëse organizohet edhe ndonjë garë, ajo të bëhet me grupe të “përziera” nxënësish.

Në mbarim të procesit arsimor, “produkti” të jetë nxënës me aftësi ndërkulturore, me ndjeshmëri të stërvitur ndaj ndryshmërive dhe të përgatitur për jetë dhe punë në mjedis multikulturor:

- **MULTIKULTURALITETI:** njohje e kulturës së vet, por edhe i veçorive, vlerave dhe praktikave të kulturave të tjera (të dish ç’janë Kërshëndellat në kulturën tënde, por edhe Kurban Bajrami në kulturën e tjetrit dhe anasjelltas),
- **RESPEKTIM I DALLIMEVE:** pranimi i dallimeve kulturore/etnike dhe përmbajtje ndaj vlerësimit të tyre (mirëkuptim se bartja e “shamisë” është pjesë e traditës kulturore/etnike dhe se në asnjë rast nuk do të thotë diçka si “e keqe”),
- **SHUMËPERSPEKTIVITETI:** mirëkuptim ndaj mendimeve dhe ndjesive të të tjerëve, ndaj aftësive të ndryshme në vështrimin e gjërave nga perspektiva e atyre të tjerëve (vështrimi i perspektivës së të tjerëve se nuk dëshiron të quhet “shiptar” ose “slavomaqedonas”, ose “kaur”),
- **REDUKTIM I PARAGJYKIMEVE DHE I STEREOTIPAVE:** kjo jep një mundësi që të mposhtet vetëm perspektiva vetanake.

Vetëm kështu do të arrihet:

- **BESIMI:** - ndërtimi i besimit të ndërsjellë (vetëm me një nivel elementar të besimit dhe pa paragjykime mund t’i qasemi realizimit të ndonjë aktiviteti të përbashkët *me tjetrin*, në të kundërtën, *kjo barrë* do ta ngarkojë komunikimin);
- **KAPACITETI DEMOKRATIK:** të gjitha përfitimet parashikuese në finalitetin e vet do të çojnë tek ngritja e kapacitetit demokratik që secili individ, në të ardhmen, të bëhet faktor aktiv në politikat e përbashkëta dhe të kyçet në marrjen e vendimeve në bashkësinë më të gjerë (vetëm si qytetar “i vetëdijësuar” dhe aktiv unë jam pjesë e bashkësisë demokratike).

Duhet mbajtur mend se në shkolla hyjnë fëmijë, kurse dalin qytetarë të shoqërisë, të cilët dituritë e fituara, por edhe shkathtësitë sociale, si dhe paragjykimet e stereotipat i transmetojnë në komunën e vet, në vendin e punës dhe bëjnë ndikime në mjedisin më të gjerë. Prandaj, besojmë që koncepti për arsim të integruar multikulturor do të kontribuojë dukshëm për një shoqëri më të mirë, një shoqëri të mbështetur në besimin dhe bashkëpunimin, e jo një shoqëri e ndarjeve dhe e urrejtjes.

**PJESA E DYTË**



# 3. SHKOLLA DHE MISIONI I SAJ SI SHTYTËS I NDRYSHIMEVE NË SHOQËRI

*Prof.dr.* Tatjana Atanasoska

## 3.1. SHKOLLA SI INSTITUCION DHE SI MJEDIS SPECIFIK

Shkolla është një institucion përgjegjës për shkollimin e popullsisë dhe luan rol kyç në ngritjen e vetëdijes së njerëzve mbi shumë çështje madhore, të cilat kanë pasur dhe kanë lidhje me njerëzimin. Njëherësh, shkolla duhet që t'i aftësojë nxënësit për punë në sfera të ndryshme, ta nxisë kreativitetin e tyre, ta mbështesë ngritjen e konkurrencës në shoqëri, të ndihmojë në edukimin e popullsisë për t'i kapërcyer konfliktet e mprehta shoqërore, etj.

Duhet pranuar patjetër se ndonjëherë këto institucione, vështruar nga dimensionin historik i ekzistencës së tyre, kanë luajtur edhe rol negativ, duke bërë përpjekje që t'i indoktrinojnë dhe ideologjizojnë njerëzit. Por, thuaja se përherë dhe gjithkund ato shquhen si shtysa të ndryshimeve të caktuara. Në këtë kontekst shkollat sot mund dhe duhet të paraqiten në rolin e futjes së ndryshimeve në vetëdijen dhe në sjelljen e qytetarëve në funksion të integritimit ndëretnik, një proces në të cilin mund të ndihmojnë dukshëm në mënyrën me të cilën asnjë institucion tjetër këtë nuk mund ta bëjë.

Shkolla është një ambient i natyrshëm në të cilin nxënësit, por edhe mësimitdhënësit, duhet të ndjehen të relaksuar edhe përkundër problemeve serioze me të cilat përballen. Ndërkaq, për të qenë ajo kështu, është e domosdoshme që të përmbushen disa parakushte. Para së gjithash, ndërmjet tyre duhet të kenë besim dhe përkujdesje të ndërsjellë. Atmosfera e gjithmbarshme dhe klima në të cilën zhvillohet procesi edukativ - arsimor duhet të jetë pozitive dhe e mbushur me emocione pozitive. Proces i arsimor e ka primatin, por pikërisht shmangia e komponentës edukative mund të shkaktojë edhe situata të caktuara problematike. Kjo është më e shprehur në mjediset në të cilat nxënësit, por edhe arsimtarët janë të përkatësive të ndryshme etnike, religjioze dhe kombëtare. Praktika shumë herë ka treguar se pikërisht në shkollat me një strukturë të këtillë, atmosfera e qetë dhe e relaksuar është shumë e brishtë dhe prekshme. Kjo tregon se ende duhet bërë shumë punë në planin e integritimit ndëretnik dhe atë në mënyrë shumë serioze dhe të përkushtuar.

Specificiteti i mjedisit të quajtur shkollë është i dukshëm sipas disa parametrave. Në atë mjedis jetojnë dhe punojnë njerëz me përkatësi të

ndryshme kulturore, sociale, etnike, religjioze. Madje edhe njerëzit, të cilët ndërmjet tyre nuk dallojnë në bazë të këtyre parametrave, dallojnë sipas nevojave, dëshirave, shpresave, pritjeve, aftësive, mundësive dhe paranjohurive, tipareve të karakterit, reagimeve emocionale të tyre. Laramania e individëve e bënë këtë mjedis unikal sipas karakterit të tij. Kjo tregon se çfarë zotësie është e nevojshme për ta bërë të mundshme realizimin e synimeve që i ngarkohen shkollës, në vartësi nga vlerësimet çka duhet të mësojë, të dijë dhe të bëjë një nxënës.

### 3.2. QËLLIMET EDUKATIVO - ARSIMORE TË SHKOLLËS NË INTEGRIMIN NDËRETNIK

Është e padyshimtë se nxënësit shkollën e vështrojnë si një vend ku duhet të mësojnë për shumë gjëra të ndryshme. Edhe prindërit, si dhe e tërë shoqëria nga shkolla presin të njëjtën gjë. Pas mbarimit të procesit edukativo - arsimor, nga nxënësit presin që të dalin me shumë dituri dhe shkathtësi, por edhe me aftësiqë ato t'i zbatojnë në praktikë. Një pjesë e

mirë nga ato dituri dhe aftësi është e karakterit shkencor, dijeni që u takojnë shkencave të ndryshme dhe duket se, kur bëhet fjalë për përvetësimin e tyre, punët qëndrojnë relativisht më lehtë. Por, kur bëhet fjalë për realizimin e objektivave edukative, gjërat disi dalin më të ndërlikuara. Kjo i detyrohet detyrës relativisht më të ndërlikuar për realizimin e objektivave edukative që kanë të bëjnë me formimin e karakterit, përvetësimin të vlerave, marrjes së qëndrimeve, formësimin të një mënyrë të sjelljes, socializimit. Ai është vendi ku nxënësit duhet të njihen me disa vlera të caktuara civilizuese që janë të pranueshme nga të gjithë. Kjo përfshin ngritjen e ndjesisë së empatisë, demonstrimin e mirëkuptimit dhe të respektimit të të gjithë njerëzve, që janë të ndryshëm nga ata. Integrimi si proces në një mjedis, vetvetiu është i ndërlikuar dhe afatgjatë. Ai proces mësohet dhe ndodh në vetë shkollën, në mënyrë të qëllimshme, por ndonjëherë edhe në mënyrë spontane. Në çdo rast, shkolla duhet të sigurojë patjetër hapësirë dhe kohë, e cila do t'i kushtohet mësimin të integritetit ndëretnik si një përfitim me rëndësi për tërë jetën për individualitetin e nxënësit. Dhe, si u tha edhe më lart, të gjitha përfitimet parashikuese shpiejnë tek ngritja e

kapaciteteve demokratike të secilit individ, në mënyrë që në të ardhmen të bëhet faktor aktiv i politikave të përbashkëta dhe të jetë i përfshirë në bashkësinë më të gjerë dhe në tërësinë e shoqërisë.

### 3.3. DIMENSIONE TË ARSIMIT MULTIKULTUROR NË SHKOLLË

Ekzistojnë gjashtë dimensione të arsimit shumëkulturore në shkollë që përbëjnë bazën e integritetit të suksesshëm ndëretnik. Ato janë këto:

- ▶ integrimi i përmbajtjeve,
- ▶ procesi i përftimit të diturive,
- ▶ reduktimi i paragjytimeve,
- ▶ pedagogjia e barabarësisë,
- ▶ përmirësimi i kulturës shkollore,
- ▶ zgjidhja e konflikteve dhe ndërtimi i paqes.

**Integrimi i përmbajtjeve - do të thotë vlerësim i përmbajtjeve që përpunohen në lëndët e ndryshme mësimore me qëllim që në disa lëndë të predispozuar të futen dimensione që janë në funksion të arsimit multikulturore dhe të ngritjes së shkathtësive të nxënësve për integrim ndëretnik/ndërkulturore.**

Por, kjo nuk do të thotë se lëndët të cilat, në dukje të parë janë të lidhura me arsimin multikulturor, nuk mund të ngërthejnë dimensione të së njëjtës. Për shembull, mësimdhënësi i fizikës mund të flasë për njerëz nga përkatësia e ndryshme etnike, gjuhësore dhe kulturore, që kanë dhënë kontribut në shkencë, dhe, me këtë rast, të theksojë se dallimet e përmendura ndërmjet njerëzve nuk janë aspekte relevante në raport me atë që ata mund ta japin si kontribut në jetë dhe në shkencë.

**Procesi i përfutimit të diturive** është një proces që zhvillohet vazhdimisht në shkollë. Përmes këtij procesi, në të vërtetë, nxënësit mësojnë të bëhen individë që janë të aftë për të menduar në mënyrë kritike. Mësimdhënësit duhet t'u ndihmojnë nxënësve që ata të kuptojnë, të shqyrtojnë dhe të përcaktojnë se si supozimet implicite kulturore, kriteret, perspektivat dhe paragjykimet në një disiplinë ndikojnë në mënyrën me të cilën përftohen dijenitë. Në të vërtetë, fjala është për atë se një tekst i njëjtë mund të interpretohet në mënyrë të ndryshme nga ana e njerëzve të ndryshëm, varësisht nga fakti se çfarë paragjykimesh dhe qëndrimesh kanë, por edhe me çfarë dijesh disponojnë.

Mësimdhënësi duhet t'i ndihmojë nxënësit që ai të mësojë se si të interpretojë tekste të caktuara, duke i identifikuar përmes çfarë supozimesh, paragjykimesh dhe qëndrimesh autori e ka shkruar atë tekst. Për shembull, mund të ngjajë që teksti ka të bëjë me inferioritetin ose superioritetin e një etnikumi, religjioni, kombi, në raport me të tjerët. Mësimdhënësi duhet t'i ndihmojë nxënësit që t'i identifikojnë paragjykimet, stereotipet dhe qëndrimet e autorit të tekstit, si dhe të nxisë zhvillimin e debatit ndërmjet nxënësve.

**Reduktimi i paragjykimeve** paraqet një proces në të cilin insistohet që gjer në maksimum të reduktohen paragjykimet tek nxënësit. Ky dimension fokusohet tek karakteristikat e gjinive, qëndrimet etnike dhe kulturore të nxënësve si dhe si mund të ndryshojnë ato përmes metodave dhe materialeve mësimore. Kjo është e domosdoshme që të bëhet, sepse është fakt se ato ekzistojnë në realitete dhe përbëjnë një kërcënim ndaj çdo lloji integrimi. Kjo ka të bëjë edhe me integrimin ndëretnik.

Ajo që duhet bërë, para së gjithash, është sensibilizimi i mësimdhënësve ndaj kësaj çështjeje. Kjo do të thotë se mësimdhënësit duhet të jenë të

trajnuar dhe të aftësuar që t'i njohur paragjykimet, por edhe me procedime dhe përmbajtje të cilat ato paragjykime mposhten dhe zhduken. Ata duhet të njohin mirë metoda të caktuara që u ndihmojnë për ngritjen e qëndrimeve dhe sjelljeve pozitive tek nxënësit. Në këtë proces duhet të përfshihen patjetër të gjithë mësime të cilat, pa marrë parasysh faktin se cila lëndë mësimore është specialiteti i tyre.

**Pedagogjia e barabarësisë**, në realitet, është mundësia që mësime të cilat, më tepër, u përgjigjen stileve për mësim të nxënësve të tyre, në mënyrë që të nxjerrin maksimumin gjatë procesit të mësimi. Një pjesë e hulumtimeve tregojnë se gjinia, përkatësia etnike, në kushte kontekstuale për jetë dhe mësim, ndikojnë tek suksesi i nxënësve. Ato njohuri duhet shfrytëzuar gjatë praktikës mësimore, me ç'rast mësime të cilat e përshtatin dhënien e mësimi sipas mënyrës që i lehtëson sukseset e nxënësve nga grupet e ndryshme etnike, kulturore, gjinore dhe shoqërore - klasore.

**Përmirësimi i kulturës së nxënësve** e vë në fokus ambientin në shkollë në tërësi, e jo në secilën klasë veç e veç. Në nivel të tërë shkollës, vetë etablimi strukturor dhe organizativ, si dhe

mënyra e funksionimit duhet të bëhen shembull për integrim ndëretnik. Vetë struktura e kolektivit në të cilin bëjnë pjesë përfaqësues të etnikumeve të ndryshme, por edhe pjesëmarrja e tyre e barabartë në funksionet udhëheqëse dhe organizative të shkollës, janë mënyra e vërtetë për të dhënë një shembull për atë se si duhet të funksionojë secila klasë veçmas, si dhe mbarë shkolla. Duhet patjetër të shqyrtohen praktikatat për grupimi, pjesëmarrja në aktivitete sportive, disproporcionaliteti në sukseset akademike dhe ndërveprimi ndërmjet personelit dhe nxënësve sipas bazave etnike dhe gjuhësore, në mënyrë që të krijohet një kulturë shkollë e cila i afirmojnë nxënësit që u takojnë grupeve të ndryshme etnike dhe gjuhësore.

### **Zgjidhja e konflikteve dhe ndërtimi i paqes**

Ndërtimi i paqes është një term që përdoret në mbarë botën, me të cilin përshkruhen proceset dhe aktivitetet që shfrytëzohen për t'u dhënë zgjidhje konflikteve të dhunshme dhe për vendosjen e paqes së qëndrueshme. Kjo përfshin transformimin e konfliktit, shërimin e traumave, pajtimin, zhvillimin dhe liderizmin

### 3.4. PËRKUFIZIMI I MËSONJËTORES SË INTEGRUAR KULTURORE

Në dukje është lehtë të bëhet një përkufizim për mësonjëtores e integruar kulturore. Sipas laikëve ajo do të ishte mësonjëtorja në të cilën kanë hyrë nxënës me përkatësi të ndryshme kulturore. Por, vallë është kjo vërtet kështu, a thua ajo mësonjëtores vetëm sipas kësaj mund të quhet mësonjëtores e integruar kulturore? Mësonjëtores e integruar kulturore është ajo në të cilën edhe mësimdhënësit njohin, e vlerësojnë

dhe e kapitalizojnë ndryshmërinë, me qëllim për ta pasuruar procesin e gjithmbarshëm të mësimin.

Nxijtja e mjedisit të integruar kulturor për mësimin inkurajon të gjithë individët - pa marrë parasysh moshën, etnitetin dhe lidhjen religjioze, statusin socio-ekonomik, orientimin seksual ose prapë bindjet politike – që të zhvillojnë kontakte personale dhe shkathtësi efektive ndërkulturore.

Paraqitja figurative, në fakt, i paraqet strategjitë që duhet shfrytëzuar në jetë dhe në punën e mësonjëtores, me qëllim që ajo të bëhet realisht promovuese e integritimit ndërkulturor dhe ndëretnik.




Fig. 3 - Mësonjëtorja si promovuese e INA

### **Ndërveprimi pozitiv me nxënësit dhe ndërmjet tyre**

Duhet të vendoset që në takimin e parë. Shfrytëzimi i të ashtuquajturave aktivitete për “thyerjen e akullit” ndihmojnë në drejtim të njohjes ndërmjet tyre, gjegjësisht me dallimet në mjedisin në të cilin ata janë lindur dhe rritur. Një mënyrë e mirë për njohje të ndërsjellë është edhe analiza rreth prejardhjes së emrit personal dhe zberthimi i kuptimit të tij, në qoftë se ka. Ky është hapi i parë përmes të cilit shpalohej dallimet, por edhe shumë momente të përbashkëta.

Mësimdhënësi duhet të theksojë se ai e ka marrë me përkushtim të kuptuarit e përkatësisë kulturore/etnike/gjuhësore, si dhe gjithçka që buron prej saj. Gjegjësisht, supozimet mbizotëruese, besimet, vlerat e asaj kulture. Në këtë mënyrë ai jep një mesazh se në mësonjëtoen e tij përkatësia çmohet dhe respektohet. Gjithashtu, një punë shumë e dobishme është edhe sigurimi me kohë i komunikimit joformal ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësit, gjithëherë kur jepet mundësia për këtë. Është shumë me rëndësi komunikimi përkatës joverbal përmes vendosjes së kontaktit me sy, shprehjes së fytyrës që thërret për komunikim, gjestet me duar që shprehin mirëkuptim.

### **Shfrytëzimi i mënyrës përkatëse të të drejtuarit**

Tregon një varg rekomandimesh për mësimdhënësit, të cilat e ndihmojnë për të pasur komunikim të suksesshëm me të gjithë. Gjatë kontaktit me një nxënës mësimdhënësi duhet ta pyesë se cilën formë të adresimit e preferon ai. Gjatë diskutimit në orë, mësimdhënësi duhet që sa më shumë që të jetë e mundur nxënësve t’u drejtohet me emër. Gjatë të drejtuarit me emër, mësimdhënësi duhet të ketë patjetër kujdes në shqiptimin e emrit, duke marrë parasysh faktin se drejtshqiptimi tregon se mësimdhënësi ka vetëdije kulturore, por edhe se, në atë mënyrë, tregon respekt.

Në qoftë se mësimdhënësi nuk është i sigurt për mënyrën me të cilën shqiptohet emri, do të ishte më mirë të konsultohet me nxënësin. Mësimdhënësi duhet të përdorë një gjuhë inkluzive, në vend të asaj etnocentrike. Për shembull, nuk është e preferuar të thotë emrin familjar, por mbiemrin; nuk është e preferuar të thotë emër të krishterë, por emër pagëzimi.

### **Eliminimi i mosrespektimit dhe i sjelljes jo të hijshme**

do të thotë ndër-marrje e shumë veprimeve që janë në funksion të integritetit ndëretnik. Rekomandohet që të vendosen rregulla

eksplicite që janë në funksion të udhëheqjes me sukses të mësonjëtores, gjegjësisht të sigurohet mbrojtja nga ekskluzioni dhe pandjeshmëria kulturore. Promovimi i respektit të ndërsjellë, ndërmjet të gjithëve, është shumë me rëndësi; gjithashtu edhe inkurajimi i nxënësve që të zhvillojnë debat rreth kodit të pranuar të sjelljes dhe një varg masash që duhet të ndërmerren nëse paraqitet ndonjë sjellje jo përkatëse. Gjithashtu, është e domosdoshme që arsimtari përnjëherë të reagojë ndaj çfarëdo sjelljeje, verbale ose jo verbale, e cila mund të konsiderohet si e folur me paragjykime, urrejtje ose diskriminuese për nga paraqitja. Komentet jo përkatëse nga ana e nxënësve nuk duhet toleruar. Të shmanget injorimi dhe mospërfillja e nevojave të secilit nxënës individualisht. Mësimdhënësi duhet të sigurohet se nuk bën preferencë të pyetjeve të njërit grup karshi grupit tjetër.

Mësimdhënësi duhet patjetër t'i shmangë stereotipet dhe gjykimet e bëra paraprakisht dhe pa argumente. Kur mësimdhënësi prezanton diçka lidhur me dallimet kulturore, etnike, gjuhësore të personaliteteve ose bashkësive, është e preferuar të thirret në burime shkencore relevante, dhe jo të thotë mendimin e vet. Gjithashtu, duhet të këmbëngulë që nxënësit të aftësohen për të përdorur burime të

ndryshme kur bëhet fjalë për çështje të dhënash, me qëllim që ta ngrisin shkathtësinë e tyre për argumentim, si dhe për mendimin kritik

### **Diskutimi i inkurajuar dhe i hapur nëpër shkolla**

nënkupton mënyrën e sjelljes së mësimdhënësit që promovon dhënie të hapur të deklaratave, të cilat hapin vend për përgjigje. Për shembull, do të ishte me vend të bëhet pyetja: A do dikush të ndajë mendim të ndryshëm ose ndonjë perspektivë ndryshe? Mësimdhënësi patjetër duhet t'i shmanget theksimit të ndonjë nxënësi të caktuar, ose të vërë një nxënës në qendër të vëmendjes, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështje kulturore të ndjeshme. Nxënësi mund të ndjehet se është vënë nën trysni nëse është vënë në pozicionin që të flasë në emër të të gjithë pjesëtarëve të bashkësisë së tij etnike, ose të prejardhjes kulturore. Mësimdhënësi duhet patjetër që të përdorë një metodë *ti e ke radhën* gjithëherë kur bëhet fjalë rreth çështjeve kontradiktore. Kjo do të thotë se mësimdhënësi duhet të sigurojë patjetër që secili të vijë në radhë për të shprehur mendimin e vet, por njëkohësisht dhe të mendojë rreth qëndrimeve dhe pikëpamjeve të tjerëve.

Me qëllim që të promovohet dhe të praktikohet mësonjëtorja e integruar kulturore, mësimdhënësi, para së gjithash, duhet që të reflektojë rreth

qëndrimeve të veta, supozimeve dhe praktikave të studimit, në mënyrë që të mund të kuptojë se në çfarë shkallë ekstenzive ato e bëjnë të mundshme integrimin e mësonjëtores. Në vazhdim japim një instrument që mësimdhënësit mund t'i ndihmojë për të reflektuar objektivisht rreth kësaj.

### 10 pyetje që shpiejnë në vetëreflektim: FORMIMI I MËSONJËTORES SË INTE- GRUAR KULTURORE

1. Cili është përkufizimi im mbi dallimet?
2. Cilit grup etnik, gjuhësor, religjioz i përkas unë? Cilat praktika të mia të mësimdhënies e reflektojnë këtë?
3. Çkadi unë përkulturën, përkatësinë etnike, gjuhën, religjionin dhe arsimin e përfituar të nxënësve të mi ose të mësimdhënësve të tjerë?
4. Si mund të mësoj më shumë për dallimet e nxënësve të mi dhe të kolegëve?
5. Çfarë janë perceptimet e mia/supozimet për studentët dhe kolegët nga grupet e ndryshme etnike? Ose cilat gjuhë dhe dialekte janë të ndryshme nga të miat?
6. Cilat janë burimet e perceptimeve të mia (për shembull: miqtë, prindërit, mediat, stereotipat, përvojat e mëparshme)?
7. Si reagoj ndaj nxënësve të mi (emocionalisht, në mënyrë kognitive, me sjelljen time) kur nuk mbështetet në mënyrat e mia të perceptimit?
8. Çfarë përvojash kam përfituar unë nga të jetuarit, të mësuarit dhe gjatë punës në mes të kulturave të ndryshme etnike ose gjuhësore? Si mund ta kapitalizoj unë këtë përvojë?
9. Si mund t'i përshtas praktikat e mia të mësimdhënies që të mundem t'u përgjigjem më shumë nevojave unike të nxënësve nga grupet etnike/gjuhësore?
10. Çfarë njohurie, shkathtësie dhe burimi tjetër mund të më ndihmojë mua që të marrë mësim nga perspektiva integruese - ndëretnike?

## 3.5. QASJE DHE SHEMBUJ PËR FUTJEN E NDRYSHIMEVE NË SHKOLLËN E INTEGRIMIT NDËRETNIK

Në procesin arsimor, në mënyrë të përditshme, krijohen situata të cilat paraqesin shembuj të mirë se si duhet të zhvillohet integrimi ndëretnik, por edhe me shembuj të tjerë që duhet të

na tregojnë se si nuk duhet të jetë ky integrim. Shpesh nxirret përfundimi i gabuar se në shkollat në të cilat punojnë mësimdhënës të një etnikumi, kurse edhe nxënësit i takojnë një etnikumi, nuk ka vend për integrim ndëretnik.

Përkundrazi, jemi thellë të bindur se në këto instanca dhe në të këtillat situata është e domosdoshme të realizohen aktivitete dhe stërvitje për ngritjen e vetëdijes për integrim ndëretnik, bashkëpunim, parandalim të stereotipeve dhe zhvillim të aftësive ndërkulturore, për shkak të karakterit multikulturor të shtetit tonë. Padyshim, situata është më e ndërlikuar kur nxënësit dhe mësimdhënësit vijnë në kontakt të ndërsjellë, kurse ndërmjet tyre nuk ka komunikim të vërtetë. Këto situata përbëjnë vetëm një parakusht për shfaqjen e moskuptimeve dhe të konflikteve. Integrimi i vërtetë nënkupton të këmbëjmë shumë fakte dhe informacione për atë tjetrin, për nevojat, interesat, bindjet, zakonet dhe historinë e tij. Kjo, ndërkaq, nënkupton hapjen e kulturës tënde ndaj kulturave të tjera, dialog i hapur për atë se dallimet ndërmjet kulturave janë një dukuri normale që, në të vërtetë do të thotë, se secili ka pasur histori të ndryshme, ka jetuar në kushte dhe rrethana të ndryshme, të cilat kanë kontribuar që bota të

bëhet e pasur me kultura dhe të mos mbetet uniforme mbi këtë bazë. Mësimdhënësit, përmes shembujve konkretë, por edhe përmes sjelljes së tyre, duhet t'u tregojnë nxënësve se bota ka me bollëk dallime, të cilat atë e bëjnë të jetë e pasur, se pikërisht ato pikëpamje dhe bindje kanë kontribuar që shumë çështje të ndriçohen. Mësimdhënësi edhe përmes sjelljes së vet duhet të manifestojë hapje, mirëkuptim dhe besim ndaj çdo dallimi. Duhet t'i shfrytëzojë të gjitha shembujt e disponueshëm pozitivë dhe negativë nga historia e njerëzimit, pedagogjia dhe nga jeta

### **3.5.1. SHEMBULL PËR ZHVILLIMIN E BISEDËS ME STUDENTËT PËR METODAT E RRIJES SË NDËRVEPRIMIT NDËRMJET NXËNËSVE NGA BASHKËSI / GJUHË MËSIMORE TË NDRYSHME ETNIKE**

**Pyetje:** Si mund të ngritët niveli i ndërveprimit ndërmjet nxënësve. A do të mund të arrihet kjo?

1. Mësimdhënësit përherë u flasin nxënësve se duhet të shoqërohen.
2. Prindërit përherë u flasin fëmijëve se duhet të shoqërohen.
3. Nga libri mund të mësojnë se sa është me rëndësi të shoqërohen.

4. Nga mediat shohin se ndjehen mirë ata që shoqërohen.
5. Shohin se shoqërohen ata që përmenden si model nga i cili mësojnë.
6. Ata që merren si model i përfshijnë në aktivitete interesante argëtimi të përbashkët.

Nga diskutimi i zhvilluar duhet të nxirren këto përfundime:

- 1 dhe 2. Vetëm nga fjalët (edhe nga mësimdhënësit edhe nga prindërit) nuk ka dobi të madhe -fëmijët më tepër mësojnë si të sillen nga ajo që e shohin, kurse jo nga ajo që u flitet; ndikim shumë më të madh ka të folurit në drejtim negativ, sesa ai në drejtim pozitiv.
3. Që të bëhen librat të dobishëm për këtë qëllim, duhet që të jenë të dizajnuara, në atë mënyrë, që të manifestojnë një ndjeshmëri ndaj integritimit ndëretnik.
4. Mediat shumë shpesh janë më të dëmshme se sa të dobishme, sepse më tepër informojnë për ngjarje negative, sesa që lajmërojnë për shembuj pozitiv.
5. Nëse i shikojnë prindërit dhe mësimdhënësit duke bashkëpunuar dhe duke u shoqëruar, gjasat më të mëdha janë që edhe ata të ni-

sin të shoqërohen, sepse fëmijët, në masë të madhe, mësojnë duke ndjekur modelin.

6. Më efikase del puna nëse ata që konsiderohen si model nga ana e tyre, të përfshihen në aktivitete interesante argëtimi të përbashkët - sepse jo vetëm që u tregojnë shembuj nga sjellja e tyre se si duhet edhe ata të sillen, por pse i përfshijnë në mënyrë aktive që atë ta mësojnë përmes shembujve të përvojës së vet.

### 3.6. AKTIVITETE PËR REALIZIMIN E NDRYSHIMEVENË ARSIMIN E INTEGRUAR NDËRETNIK

Për të kontribuar në përmirësimin e integritimit ndëretnik si synim, shkollat duhet të fusin ndryshime në këto fusha që vijojnë:

1. Aktivitete të përbashkëta të nxënësve dhe me nxënësit që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore,
2. Aktivitete të përbashkëta të mësimdhënësve që zhvillojnë mësimin në gjuhët e ndryshme mësimore,

3. Atmosfera dhe mjedisi rrethues në shkollat njëgjuhësore dhe në ato shumëgjuhësore,
4. Bashkëpunim me prindërit, bashkësinë dhe komunën.

### **3.6.1. AKTIVITETE TË PËRBASHKËTA TË NXËNËSVE DHE ME NXËNËSIT NË GRUPE TË PËRZIERA ETNIKE -LLOJET, PRINCIPE, KRITERET**

Aktivitetet e përbashkëta të nxënësve dhe me nxënësit në grupe të përziera etnike ndahen në këto kategori:

**A) Aktivitete jashtëmësimore afatshkurtëra:** piknikë, ekskursione, shfaqje, kremtime, argëtime, vizita, punëtori njëditëshe, aksione në shkollë dhe në bashkësi.

**B) Aktivitete jashtëmësimore më afatgjate:** projekt - seksione, punëtori shumëkulturore, ekipe sportive.

**C) Mësimi i rregullt:** mësimi sipas disa lëndëve mësimore, projekte më afatgjate në suaza të lëndëve mësimore, mësim në natyrë, orë të lira/aktivitete sipas projekteve.

**G) Aktivitete për pjesëmarrje demokratike:** veprimi i nxënësve nga bashkësitë e ndryshme etnike përmes organizatave të nxënësve.

### **3.6.1.1. PËRSHKRIMI DHE KARAKTERISTIKAT E LLOJEVE TË NDRYSHME TË AKTIVITETEVE TË PËRBASHKËTA TË NXËNËSVE**

#### **A) Aktivitete jashtëshkollore afatshkurtëra**

Nxënës të gjuhëve mësimore të ndryshme mund të shkojnë në piknikë dhe ekskursione të përbashkëta në të cilat do të bëjnë diçka bashkërisht. Për shembull - të shkojnë për vizitë miqësore tek njëri tjetri me raste të ndryshme, të përgatisin shfaqje të përbashkëta, kremtime ose argëtime, të realizojnë punëtori të përbashkëta njëditore (vizatim i përbashkët, bërje të urimeve) dhe/ose të realizojnë aksione të përbashkëta në shkollë dhe/ose në bashkësi.

#### **Ekskursione**

Elemente të organizimit dhe të realizimit të ekskursioneve, të cilat kontribuojnë për integrimin ndëretnik në arsimin multikulturor:

- ▶ gjatë zgjedhjes së vendeve / kuriozitetëve / objekteve për vizita, duhet të merren parasysh nevojat dhe interesat e nxënësve nga bashkësitë e ndryshme etnike / gjuhësore (pa e theksuar);
- ▶ gjatë vizitës së kuriozitetëve / objekteve duhet të sigurohet përkthyes i shpjegimeve për vendet;

të gjithë nxënësit nga bashkësitë e ndryshme etnike, si një grup “i përzier”, duhet paraprakisht të hulumtojnë dhe të informohen për ato vende që do të vizitohen, si dhe në mbarim të vizitës se ekskursionit të përgatisin prezantim;

- ▶ gjatë organizimit dhe realizimit të transportit, duhet që në një autobus të ketë nxënës nga gjuhët e ndryshme mësimore; muzika që lëshohet për t’u dëgjuar të jetë ose neutrale ose të ketë një përfaqësim të barabartë të muzikës nga të gjitha gjuhët / grupet etnike;
- ▶ gjatë akomodimit të nxënësve nga gjuhët e ndryshme mësimore nëpër dhoma të objektit, duhet që të mos ndahen sipas kateve dhe / ose korridoreve, por të ketë dhoma njëra pranë tjetrës ku janë akomoduar nxënës nga grupe të ndryshme etnike / gjuhësore.
- ▶ gjatë marrjes së ushqimit, duhet mbajtur kujdes për nevojat dietetike të nxënësve nga grupet e ndryshme etnike / gjuhësore,
- ▶ gjatë organizimit të argëtimit, duhet të praktikohen të njëjtat rregulla si për dëgjimin e muzikës në autobus; të gjithë nxënësit të marrin pjesë në të njëjtin argëtim; të bëhen aktivitete të ndryshme bashkërisht (për shembull valle, lojëra argëtuese, etj.)

- ▶ gjatë organizimit të kohës së lirë, duhet të ofrohen aktivitete të strukturuar, të cilat mund të realizohen vetëm në qoftë se krijohen grupe me përbërje të “përzier” etnike / gjuhësore.

### Shfaqje

Shfaqjet janë multikulturore kur përfshijnë përmbajtje për bashkësitë e ndryshme etnike / gjuhësore ose në ato marrin pjesë pjesëtarë bashkësisht të ndryshme kulturore / etnike.

Shfaqjet kontribuojnë për integrimin ndëretnik, kur i integrojnë standardet që vijojnë:

- ▶ Përgatiten bashkërisht për ekzekutimin që bëhet i përzier - me pjesëmarrje të pjesëtarëve të të gjitha grupeve të përfaqësuara gjuhësore / etnike,
- ▶ Përmbajtjet janë ose “neutrale” ose të përbashkëta, ose për secilën bashkësi etnike barabarësisht. Përmbajtje neutrale janë ato që konsiderohen si më universale dhe/ose nuk kanë kurrfarë lidhjeje të dukshme më RM (për shembull ekzekutimi i një kënge të huaj ose vals i ndonjë kënge të huaj e të popullarizuar, dramatizime për pranverën, etj.) Përmbajtje të përbashkëta janë ato që kanë të bëjnë me shkollën, me bashkësinë

më të ngushtë ose më të gjerë dhe janë me interes për të gjithë ose për shumicën e bashkësive të ndryshme etnike (për shembull, dramatizime për raportet në shkollë, krijime individuale të nxënësve rreth temës “Vendi im”, ekzekutim i ndonjë valleje që luhet në dy ose në disa bashkësi),

- ▶ Përfaqësim i barabartë i përmbajtjeve ‘etnike’ me ato përmbajtje që janë të lidhura me identitetin konkret të një bashkësie etnike / kulturore që jeton në Republikën e Maqedonisë (për shembull: këngë popullore shqipe, valle turke, recital për Goce Dellçevin, kostume rome), kurse pikat i realizojnë nxënës nga bashkësitë etnike pa marrë parasysh përmbajtjen etnike,
- ▶ Trajtim i barabartë i të gjitha bashkësive gjuhësore / etnike, sipas përfaqësimit dhe radhës së gjuhëve (dhe të përmbajtjeve).

### **Aksione dhe punëtori njëditore**

Takim i njëhershëm i një grupi “të përzier” nxënësish nga gjuhë të ndryshme mësimore të cilët bëjnë diçka bashkërisht, p.sh. aksion ekologjik, vizatim, përpunim stolisjesh, garë në futboll) mund të kenë lidhje me çfarëdo aktiviteti ose përmbajtje, por duhet të zhvillohen drejt qëllimit të përbashkët/produktit dhe të

nxisin bashkëpunimin e ndërsjellë. Kjo përfshin numër të balancuar nxënësish nga bashkësi të ndryshme gjuhësore/etnike dhe udhëhiqen nga mësimdhënës të të gjitha gjuhëve mësimore të përfaqësuara. Ato janë me efekt të kufizuar. Kur organizohet ndonjë aktivitet njëditor me grup “të përzier nxënësish, me qëllim që të zhvillohet ndonjë aksion i përbashkët ose ndonjë punëtori në formë të ndonjë projekti mësimor ose jashtë mësimor (hulumtuese ose realizuese) ai konsiderohet aktivitet kohëshkurtër.

Aksionet dhe punëtoritë njëditore duhet të organizohen sipas kriterëve që vlejné edhe për aktivitetet më afatgjate:

- ▶ të shprijné drejt qëllimit të përbashkët dhe të nxisin bashkëpunimin, duke përjashtuar garën ndëretnike,
- ▶ të realizohen me grupe që përbëhen nga një numër i barabartë nxënësish nga të gjitha gjuhët mësimore (dhe sipas mundësisë me numër të njëjtë nxënësish nga gjinitë e ndryshme),
- ▶ të realizohen nga mësimdhënës të të gjitha gjuhëve mësimore që përfaqësohen në grup.

Edhe pse janë të popullarizuara dhe organizohen shpesh, veçanërisht gjatë vizitave miqësore, këto aktivitete bëjnë efekt më të vogël nga aktivitetet

më afatgjate për shkak të kontaktit kohëshkurtër i cili nuk siguron një komunikim të mjaftueshëm ndërpersonal.

## B) Aktivitete jashtëmësimore afatgjate

Nxënës me gjuhë të ndryshme mësimore mund të bëjnë bashkërisht projekte që zgjasin së paku një gjysmëvjetor, të kenë seksione dhe ekipe sportive të përbashkëta, ose të realizojnë punëtori multikulturore, pjesërisht përmes kontaktit të drejtpërdrejtë, kurse pjesërisht përmes lidhjeve në internet.

### *Puna e / në seksion të përbashkëta*

Seksionet mund të krijohen në fushat më të ndryshme (seksioni dramatik, i vallëzimit modern, i valltarëve, i gazetarëve, i informatikës, sportit, ekologjisë, i muzikës, i videos etj.). Ato duhet që të jenë tërheqëse për nxënësit nga gjuhët e ndryshme mësimore. Seksionet nuk është e thënë fare që të organizohen lidhur me lëndët mësimore, por mund të jenë rreth çfarëdo tematike e cila është atraktive, interesante dhe argëtuese për nxënësit dhe që do të tërheqin dhe do t'i afrojnë bashkë nxënësit prej gjuhëve të ndryshme mësimore. Gjithsesi se duhet nisur nga hapat e vegjël që të arrihet sukses, i cili do të

nxisë interesin për seksione të reja dhe për aktivitete të tjera të përbashkëta.

Edhe në shkollat shumëgjuhësore, edhe në shkollat partnere, duhet të respektohen të njëjtat kritere për organizimin dhe realizimin e seksioneve të përbashkëta. Seksione për të kontribuar në integrimin ndëretnik, është me rëndësi që të respektohen këto kritere:

- ▶ të organizohen takime të rregullta në kohëzgjatje prej 1-1,5 orë një herë në javë, më së paku gjatë një gjysmëvjetori,
- ▶ tematikën / aktivitetin e zgjedhin bashkërisht nxënësit e të gjitha bashkësive gjuhësore / etnike të përfaqësuar,
- ▶ të punohet në grupe të vogla (“të përziara”),
- ▶ të punohet në atmosferë bashkëpunimi (gara është e mundshme vetëm ndërmjet grupeve “të përziara”),

### *Punëtoritë multikulturore*

Punëtori multikulturore është emërtimi i një programi të veçantë, i cili zbatohet si një lloj i veçantë seksioni - një herë në javë, më së paku gjatë një gjysmëvjetori. Për punëtori shumëkulturore nuk konsiderohen ngjarjet që realizohen njëhershëm ose në disa hera,

sipas programit që e kanë përpiluar vetë mësimdhënësit. Për realizimin e saj ofrohet doracak i posaçëm dedikuar realizatorëve, me një përshkrim të detajuar të aktiviteteve (ngjashëm me punëtoritë në programin e shkathëtësive jetësore) dhe përfshijnë material punuese dedikuar nxënësve. Programin e udhëheqin dy mësimdhënës, edhe atë:

- ▶ ose në dy gjuhë - kur punojnë me grup “të përzier” nxënësish nga dy

gjuhë mësimore (nuk mund nga tre gjuhë - për shkak të natyrës së aktiviteteve), me numër të njëjtë nxënësish nga dy gjuhë të ndryshme mësimore;

- ▶ ose në një gjuhë - kur punojnë me grup “të përzier” nxënësish nga dy bashkësi etnike me numër të njëjtë nxënësish nga të dyja bashkësitë etnike që mësojnë në një gjuhë mësimore (me shpesh maqedonas dhe romë).

### Një shembull për punëtori multikulturore janë nxënësit nga mosha - grupi i tretë i klasave të (IV-V):

#### Punëtorja: NJOHJE E NDËRSJELLË

**Aktiviteti hyrës:** Të gjithë qëndrojnë në rreth. E fillon njëri nga realizatorët duke treguar emrin e vet, si zakonisht, me lartësi normale të zërit. Mandej, njëri pas tjetrit, secili prezantohet sipas radhës.

– Pasi që të gjithë ta kenë thënë emrin e vet, nis loja e rrethit të dytë: tash, një nga një secili e thotë emrin e vet sa më shpejtë që mundet, e mandej, me të dhënë të shenjës, i gjithë grupi e përsërit emrin e thënë në mënyrën si është thënë fillimisht. Në rrethin e tretë, secili e thotë emrin e vet sa më ngadalë që mundet, e mandej, me të dhënë të shenjës, gjithë grupi e përsërit thënien e emrit në të njëjtën mënyrë.

**Aktiviteti kryesor:** Pjesëmarrësit ulen rreth tryezës në grup të përbërë prej 4 deri më pesë. Secili pjesëmarrës merr nga një kopje të fletës punuese: një tërfil në mes të së cilës është lënë hapësirë në të cilën nxënësi e shkruan emrin e vet me germa të mëdha në gjuhën e vet amtare, ashtu si dëshiron ai të thirret në këtë grup dhe e zbukuron të shkruarën.

Mandej, në secilin prej katër gjetheve të tërfillit secili duhet të shkruaj ndonjë fjalë të dashur (lëndë në shkollë, sport, gjallesë ose ditë të javës).

Të gjithë pjesëmarrësit hyjnë në rreth. Realizatorët e thonë, një pas një, ndonjë gjë të dashur që e kanë vërejtur se është shkruar nga pjesëmarrësit, por nga njëra kategori, përderisa ajo nuk shterohet, gjegjësisht gjersa nuk përmenden të gjithë gjërat e shkruara, kurse të gjithë ata që atë gjë e kanë të shkruar në tërfilin e vet - qëndrojnë në mes të rrethit dhe secili, shkurtimisht, e thotë se përse ajo është gjëja e dashur për të.

Mandej, të tjerët që janë në rreth u duartrokasën këtyre, kurse ata kthehen prapë në rreth. Realizatorët mbajnë kujdes që të gjithë pjesëmarrësit të hyjnë nga një herë në mes të rrethit për secilën kategori, pavarësisht se a janë disa pjesëmarrës të tjerë ose janë vetë, përderisa kanë theksuar diçka të dashur që nuk ndeshet tek asnjëri tjetër në grup.

Pjesëmarrësit mund t'i bartin distinktivët në disa punëtori fillestare, në mënyrë që të mundën realizatorët t'i mbajnë mend emrat e tyre, si dhe për njohje më të lehtë mes tyre.

---

#### DISKUTIM:

---

- ▶ Ishin vallë të gjithë në mes të rrethit për secilën gjë që e dëshironin? Përse?
  - ▶ A thua të gjithëve që ishin në mes të rrethit e njëjta gjë u dukej e dashur për të njëjtin shkak? Përse?
  - ▶ A ndodhi ndonjë herë që vetëm një nxënës të jetë në mes të rrethit? Nëse jo, a është e mundur kjo të ndodhë? Përse?
-

### Aktiviteti përmbyllës:

Të gjithë pjesëmarrësit qëndrojnë në rreth, kurse mbajnë të ngjitur tërfilat e përpunuar në aktivitetin paraprak. Dy realizatorët qëndrojnë njëri përballë tjetrit, në anët e përkundërta të rrethit (gjysma e pjesëmarrësve janë në njërin anë, kurse gjysma është në anën tjetër të rrethit, mes tyre). Fillon njëri nga realizatorët që duhet fillimisht ta shqiptojë qartë e zëshëm emrin e realizatorit të dytë, dhe mandej t'ia japë topin. Realizatori i dytë duhet ta zë topin me duar, ta shqiptojë emrin e pjesëmarrësit që qëndron në të djathtë nga ana e realizatorit të parë dhe mandej t'ia japë topin.

Pasi që pjesëmarrësi i parë të ketë zënë topin me duar, e shqipton emrin e pjesëmarrësit që ndodhet në anën e djathtë të realizatorit të dytë dhe ia jep topin. Pjesëmarrësi i dytë e vazhdon rrethin e shqiptimit të emrave dhe me dhënien e topit, sipas të njëjtit princip, kah e djathta e atij nga i cili e mori topin. Rrethi mbyllet kur topi vjen nga realizatori i parë.

Loja mund të luhet edhe në rreth të dytë, që kur pjesëmarrësit do t'i ndërrojnë vendet në rreth, kësaj here, pjesëmarrësit duhet të përpiqen të gjithën ta bëjnë sa më shpejtë, por pa e lënë topin të bjerë në tokë.

**Reflektim:** Çfarë bëmë sot? Nga kjo që bëmë sot, cila ishte më bukur? Çfarë mësuat nga kjo?

**Përfundim:** Njerëzit dallojnë ndërmjet vete në bazë të shumë gjërave, mes tjerash, edhe gjëra të dashura, të ndryshme, për shkak të intereseve të tyre të ndryshme, përvojës së ndryshme dhe diturive. Disa njerëz kanë gjëra të dashura të njëjta nga arsye të njëjta, kurse tek disa shkak për zgjedhjen e njëjtë mund të jetë i ndryshëm. Njerëzit për punë të ndryshme janë të ngjashëm me grupe të ndryshme njerëzish dhe, njëkohësisht, për shkak të ndonjë zgjedhjeje të vetë ose për shkak të ndonjë karakteristike, mund të jenë të vetmit.

## Punëtorja: KORNIZA NJË NGA NJË

**Aktiviteti kryesor:** Pjesëmarrësit ndahen në gjashtë grupe. Nga dy grupe punojnë një lloj kornize për vizatime. Të gjithë bashkë do të marrin pjesë në bërjen e aq kornizave sa persona numëron grupi, kurse në fund, sipas zgjedhjes së rastit, me tërheqjen e fletëzës, do të përcaktohet korniza që do ta marrë. Në kornizë, secili do ta ngjesë vizatimin që e ka zgjedhur në punëtorinë paraprake.

### Korniza – mollë

Të gjithë pjesëmarrësit që e punojnë këtë kornizë fillimisht marrin nga një pjesë hamer me ngjyrë të kuqe në të cilën është vizatuar vijëzimi i mollës në mesin e së cilës është vizatuar vijëzimi (kontura) në një fletë letre (A5), sikundër është paraqitur në fletën e punës për realizatorët: Një skemë për kornizë - mollë. Pjesëmarrësit duhet që ta ngjisin vizatimin në vendin e shënuar në mes, kurse mandej ta presin kornizën në formë molle. Pas kësaj, secili merr edhe një copëzë gjethi e filizi të mollës, të cilat duhet t'i presë, t'i ngjyrosë, t'i mbledhë rreth mollës që ishte bërë më parë. Dhe mandej të zbukurojë mollën me ngjyra të ndriçuara.

### Korniza-radhitje

Të gjithë pjesëmarrësit që e punojnë këtë kornizë fillimisht marrin nga një copë hamer me ngjyrë të kaltër të mbyllyr, ngjyrë të blertë në të cilën është hequr një vijëzim (konturë) në një fletë prej letre A5. Pjesëmarrësit duhet që ta ngjisin vizatimin në vendin e shënuar në mes, kurse mandej ta presin kornizën në formë të këndit të drejtë. Pastaj, secili më parë i ngjyros ato, mandej copëzat i ngjet përmes radhitjes prej kartoni në pjesën ndërmjet vizatimit dhe kornizës.

### **Korniza - llambëza**

Të gjithë pjesëmarrësit që e punojnë këtë kornizë fillimisht marrin nga një copë hamer në ngjyrë të bardhë në të cilën është hequr vijëzimi (kontura) e llambës, në mesin e së cilës është hequr vijëzimi (kontura) në një fletë letre (A5), sikundër që është paraqitur në fletëzën e punës për realizatorët: Skema për kornizën - llambëzë. Pjesëmarrësit duhet ta ngjisin vizatimin në vendin e shënuar në mes, dhe mandej edhe pas mesit, kështu që secilën nga këto dy pjesë të bashkojë me staplersë në secilin cep të llambës së mëparme. Në këtë mënyrë bëhet “kapaku” i llambëzës që hapet e mbyllet, që mandej duket të dekorohet.

## **Punëtorja: KORNIZA TË PËRBASHKËTA**

Pjesëmarrësit ndahen në tre grupe dhe secili grup punon një kornizë të madhe të përbashkët për vizatimet individuale të kornizuara nga punëtorja paraprake. Produktet mandej duhet t'i varin në muret e shkolles, në korridore, afër mësonjëtove të tyre ose në hyrjen kryesore të shkollës.

### **Grupi i parë: Korniza - druri**

Pjesëmarrësit marrin hamer në të cilin është vizatuar një trung druri me aq degë sa ka korniza veç e veç në formë të mollës, sikundër që është paraqitur në fletëzën e punës për realizatorët: skema për kornizën - druri. Pjesëmarrësit duhet që ta presin, dhe mandej të këpusin copëza prej letrës vetëngjitëse, e cila është në nuance të ndryshme të ngjyrë kafesë dhe i ngjisin në trungun si kolazh. Mandej, ndër degët ngjiten një nga një kornizat në formë të mollës. Në hamer duhet të shkruhen emrat e të gjithëve që kanë marrë pjesë në punimin e saj.

### **Grupi i dytë: Korniza - radhitje**

Pjesëmarrësit marrin një hamer të madh në formë të kënddrejtit, ku ngjiten kornizat e veçanta, të cilat janë ngjitur me copëza nga radhitësja prej kartoni në punëtorinë e mëparme. Mandej të gjithë marrin pjesë nga radhitesja prej kartoni, të cilat duhet të ngjyrosen dhe të ngjiten cepeve të hamerit, duke formuar një kornizë të madhe të përbashkët. Në hamer duhet të shkruhen emrat e të gjithëve që kanë marrë pjesë në punimin e saj.

### **Grupi i tretë: Korniza-bredh**

Pjesëmarrësit marrin një hamer në të cilin është vizatuar një bredh sikundër është paraqitur në fletëzën për realizatorët: skema për kornizë - bredh. Atë duhet ta ngjyrosin dhe të presin, dhe mandej mbi të t'i ngjiesin kornizat e veçanta të punuara në punëtorinë paraprake, në forma të llampionëve. Mandej, me ngjitëse bredhi, mund të dekorohet në mënyrë plotësuese. Në hamer duhet të shkruhen emrat e të gjithë pjesëmarrësve në punimin e saj.

### **Aktivitetet sportive**

Aktivitetet sportive duhet t'i japin shtytje bashkëpunimit ndëretnik - garat interne mund të zhvillohen vetëm ndërmjet ekipeve "të përziera". Aktivitetet sportive, me grupe të përziera, mund të organizohen në suazat e çdo sporti. Me këtë rast, fare nuk duhet të bëhet me qëllimin që të krijohet një ekip sportiv që do ta përfaqësojë shkollën nëpër gara, edhe pse edhe ajo është e mundshme.

Nëqoftëse këto aktivitete sportive bëhen gjithnjë e më atraktive, do të zvogëlohet tensioni që paraqitet gjatë garave, por edhe do të mund të

tërheqë një rreth të madh nxënësish. Në qoftë se, bie fjala, shkolla vendos që të ketë një seksion ping-pongu, në udhëheqjen e tij mund të marrë pjesë secili mësimitdhënës që ka afinitet për atë sport ose prind që di të luaj ping - pong. Mandej, duhet mbajtur kujdes që ata të cilët e udhëheqin seksionin e ping-pongut të jenë të përkatësive të ndryshme etnike. Në aktivitetet paraprake të përbashkëta të nxënësve u theksua se përse është i rëndësishëm balancimi i numrit të nxënësve nga bashkësitë me gjuhë mësimore të ndryshme, njësoj sikundër që është me rëndësi që edhe garat interne të mos jenë etnikisht homogjene, por

të zhvillohen ndërmjet ekipeve “të përziera”.

Nga seksionet sportive janë të mundshme këto: futboll, volejboli, hendbolli, ecja / sporti malor, vozitja me biçikletë, vozitje rolerësh, peshkimi, badmingtoni, “popullorja”, etj.

### C) Mësimi i rregullt

Aktivitetet e përbashkëta të nxënësve në suaza të mësimin të rregullt realizohen në mësimin e disa lëndëve, projekte më afatgjate në suazë të lëndëve, mësimi në natyrë, orë të lira dhe aktivitete në bazë të projektit. Nxënësit e gjuhëve të ndryshme mësimore mund të kenë disa aktivitete të përbashkëta në suaza të mësimin të rregullt (që janë në funksion të realizimit të qëllimeve nga programi mësimor), si p.sh. të shkojnë në mësim të përbashkët në natyrë, të kenë orë të përbashkëta në edukatë fizike, informatikë, gjuhë të huaja, ose të kenë orë të lira të përbashkëta / aktivitete në bazë të projektit. Këtu hyjnë edhe realizimi i projektit të përbashkët në artin figurativ ose ndonjë lëndë tjetër, që nuk kërkon shumë komunikim të ndërsjellë, por përfshin 5 orë punë të përbashkët në një gjysmëvjetor.

Orët e përbashkëta në mësimin e rregullt mund të jenë në lëndë të ndryshme (p.sh. edukatë fizike, art

figurativ, informatikë, gjuhë angleze etj.), por gjithsesi, jo siç praktikohet në disa shkolla (nxënësit të ndajnë vetëm hapësirën e përbashkët, ndërsa krejt ndaras t’i zhvillojnë aktivitetet), por ashtu siç duhet të jetë (me integrim të nxënësve dhe mësimdhënësve nëpërmjet ndërveprimit intensiv mes nxënësve / mësimdhënësve me sfonde të ndryshme).

### G) Aktivitete për participim demokratik

Mundësohet kur nxënësit e gjuhëve të ndryshme mësimore duhet të bashkëpunojnë nëpërmjet Bashkësisë së Shkollës (BSH) dhe organeve të tjera të nxënësve në shkollë, që janë të zgjedhur përmes rrugës demokratike dhe që i përfaqësojnë në shkollë. Me përfshirjen e tyre aktive të nxënësve në jetën shkollore, sigurohen kushte që i stimulojnë ata të formësojnë mendimin e tyre, të cilin e shprehin lirshëm dhe, njëkohësisht, të krijojnë mekanizëm dhe procedura që do t’iu mundësojnë ndikim mbi vendimet dhe ndodhitë në shkollë:

- vendosin për çështje** që i tangojnë ata,
- zgjidhin probleme** që ndërlidhen me përditshmërinë në shkollë,
- zhvillojnë **kompetenca për aksion**, dhe
- ndërmarrin **aksione konkrete**.

Nxënësit, në formësimin e rrugës për pjesëmarrje demokratike, kanë nevojë për ndihmë të përhershme të mësimdhënësve, të cilët duhet t'i udhëheqin në zhvillimin e **kompetencave për aksion demokratik**. Për këtë shkak është shumë e rëndësishme që paraprakisht mes mësimdhënësve dhe nxënësve të vendosen:

- ☑ **raporte partneriteti,**
- ☑ **besim i ndërsjellë,** dhe
- ☑ **ndjenja se janë bashkë në këtë rrugë.**

Të rriturit duhet të nxisin aksione të përbashkëta demokratike të të gjithë pjesëmarrësve në jetën shkollore, që nëpërmjet dialogut të përhershëm do t'i harmonizojnë pamjet e tyre dhe do të kërkojnë zgjidhje të përbashkët. Kjo jo gjithëherë është e lehtë. Në këtë rrugëtim dalin pengesa të shumta, që kërkojnë të pranohet sfida për ballafaqim me ta dhe të besohet në potencialet personale, qoftë edhe atëherë kur zgjidhja nuk duket në horizont .

Roli i shkollës është të mundësojë që nxënësit të organizohen dhe aktivisht të marrin pjesë në format e shoqërimit të tyre - **organet për nxënësit**, edhe atë:

- ▶ **Bashkësinë e paraleleve / klasave** - nxënësit organizohen në

bashkësinë e tyre nga 2-9 paralele (puna në bashkësitë zhvillohet sipas programeve që i propozojnë nxënësit);

- ▶ **Bashkësia e shkollës** - Nxënësit e bashkësisë së klasës zgjedhin përfaqësuesit e tyre që merr pjesë në punën e bashkësisë së shkollës (në secilin vit shkollor miratohet program që ngërthen propozimet e bashkësisë së paraleleve / klasave).

Nëpërmjet këtyre organeve nxënësve iu jepet mundësia:

- ▶ **të mësojnë të flasin për problemet që i preokupojnë,**
- ▶ **të bashkëpunojnë në kontekste të ndryshme (në përbërje të ndryshme gjinore dhe etnike me nxënës që kanë pikëpamje të ndryshme),** dhe
- ▶ **aktivisht t'i hulumtojnë dhe diskutojnë aspektet e ndryshme të jetës shkollore dhe të punojnë në përmirësimin e tyre nëpërmjet aksioneve për ndryshime.**

Në këtë mënyrë, shkolla transformohet në vend ku mësohet demokracia dhe funksionimi demokratik i shoqërisë.

Nxënësit kanë mundësi të përfshihen në të gjitha aspektet e jetës shkollore që i tangon edhe atë në mënyra dhe nivele të ndryshme. Ata mund aktivisht të ndërmarrin aksione për ndryshim, për çështje që kanë të bëjnë me segmentet e dhëna të jetës shkollore:

- ☑ **mësimi** – p.sh. si të përmirësohet suksesi dhe notimi, si të përmirësohet cilësia e mësimi;
- ☑ **raportet mes nxënësve dhe raportet me të rriturit** – si të përmirësohen raportet në paralele / klasë, si të zgjidhet një konflikt;
- ☑ **aktivitete jashtëmësimore** – p.sh. ku të shkohet në ekskursion, si të shënohet një manifestim, si të organizohet një aheng i përbashkët, cilat seksione të organizohen në shkollë etj.
- ☑ **kushtet fizike në shkollë** – p.sh. si të rregullohet oborri, si të përmirësohet higjiena në tualete, si t'i kushtohet kujdes inventarit e shkollës etj.

Ndërmarrja e aksioneve për ndryshim, nëpërmjet të cilave nxënësit praktikisht e absorbojnë procesin e zbatimit të aksionit, mund të realizohet sipas hapave pasues:

- I. Së pari me nxënësit punohet në **identifikimin e problemeve** që është në interes të tyre. Problemi mund të jetë nga secila fushë e jetës shkollore. Më pas, nxënësit **hulumtojnë për problemet** dhe japin ide për zgjidhjen e tyre. Në këtë hap nxënësit më shpesh përpilojnë anketë që të mbërrijnë te rezultatet e duhura.

- II. **Gjetja e zgjidhjes për problemin** kuptohet mbi bazën e rishikimit të hulumtimit dhe ofrohen më tepër zgjidhje të mundshme, nga të cilat nxënësit përcaktohen për zgjidhje konkrete.

- III. Hapi i tretë është **përgatitja e planit aksional**, respektivisht përkufizohen hapa konkret, përcaktohet kush do ta përgatisë atë, theksohen materialet e nevojshme dhe përcaktohet suaza kohore që të mbërrihet deri te zgjidhja e problemit. Plani për aksion duhet të përfshijë cilat pengesa parashikohen gjatë realizimit dhe si do të kapërcehen.

- IV. Hapi i fundit është **zbatimi i planit aksional** i cili duhet të sjellë ndryshimin e planifikuar dhe zgjidhjen e problemit që është iniciuar në fillim. Pas realizimit të planit aksional bëhet shqyrtimi i rezultateve dhe cilësia e ndryshimit sipas kriterëve për vlerësim / evaluim të ndryshimeve që nxënësit më parë i kanë përkufizuar. Nëse aksioni nuk është i suksesshëm, nxënësit mund t'i hulumtojnë shkaqet dhe përsëri të ndërmarrin aksione tjera.

**Pas zbatimit të ndryshimit**, informimi i të gjithë nxënësve, në nivel të shkollës për zbatim të aksionit, është

i një rëndësie të veçantë për të siguruar transparencë në punë të BSH dhe shpërndarjen e rezultateve të aksionit. Në këtë mënyrë, sigurohet motivimi te nxënësit për pjesëmarrje në aksionet e ardhshme. Informacionet për punën e BSH-së duhet të jenë gjithmonë në kohë, të qarta, dhe të hapura edhe atë:

- ☑ me gojë (*leximi i njoftimeve, shpalljeve*), dhe
- ☑ të shkruara (*tabela e shpalljeve, webfaqja, broshurat, letra, njoftimi me shkrim, procesverbale, informatori vjetor, gazeta e shkollës*).

Gjatë realizimit të aksioneve për ndryshim, të **rriturit kanë rol vendimtar në dhënien e ndihmës së vazhdueshme dhe orientimit të nxënësve:**

- ▶ gjetja e mënyrës se si të ruhet entuziazmi potencial, kapacitetet dhe përkushtimi që nxënësit e kanë gjatë rrjedhës së punës;
- ▶ nxitja e nxënësve që t'i pranojnë sfidat dhe, në mënyrë të suksesshme, të ballafaqohen me barrierat / pengesat, që njëherësh është elementi kyç për zhvillimin e kapaciteteve për kompetencat gjatë aksionit;
- ▶ inkurajimi i nxënësve për të dhënë idetë e tyre gjatë zgjidhjes së problemeve, pa diktat nga ana e të rriturve;

- ▶ insistimi për vetëdijesim të nxënësve gjatë punës, nëpërmjet reflektimit më të shpeshtë të procesit;
- ▶ orientimi i nxënësve që të bëjnë vetë evaluim / vlerësim të aksioneve sipas kriterëve të përkufizuara paraprakisht nga ana e tyre.

Përvoja nga pjesëmarrja e nxënësve në procesin e ndërmarrjes së aksionit për ndryshim, tregon se kompetencat për aksion demokratik nuk zhvillohen brenda natës dhe për një kohë të shkurtër. Është e domosdoshme që, për një kohë më të gjatë dhe më shpesh, nxënësit të vihen në situata që vetë t'i diskutojnë dhe t'i hulumtojnë gjërat, si dhe të veprohet me aksione konkrete, përkundër mbajtjes së ligjëratave për nxënësit. Kjo është e drejtë dhe mënyrë e duhur funksionimit. Nxënësit, nëpërmjet përvojës së marrë, gjatë aksioneve konkrete, më mirë i zhvillojnë kompetencat për aksione demokratike.

### 3.6.1.2. PARIME PËR REALIZIMIN INTEGRIMIT TË AKTIVITETEVE TË PËRBASHKËTA

Për realizimin e integruar të aktiviteteve të përbashkëta, me grupe të përziera nxënësish dhe arritje të ndërveprimit të fortë dhe intensiv mes tyre, zbatohen parime të caktuara. Kushti i domosdoshëm që duhet të përmbushet është

përgatitja paraprake, në detaje, e mësimdhënësve - realizatorë për mënyrën e realizimit të aktivitetit të përbashkët dhe për respektimin e principeve të mëposhtme:

#### **a. Gjatë përdorimit të gjuhëve:**

- ▶ për komunikim me gojë zbatohet parafrazimi me plotësim në vend të përkthimit. Gjithashtu, renditja e gjuhëve ndryshon me alternim. Zbatimi i këtyre parimeve bëhet për shkak të më tepër përfitimeve: barabarësi ndërmjet gjuhëve, komunikim i papenguar mes nxënësve nga gjuhë mësimore të ndryshme dhe dëgjim aktiv i ndërsjellë,
- ▶ për komunikim me shkrim përdoret i shkruarit në dy gjuhë, me madhësi të njëjtë shkronjash dhe sipas një rendi të njëjtë. Për materialet dygjuhësore, më shpesh, zbatohet renditja e njëjtë e gjuhëve, e më rrallë me ndarje të atillë ku njëra gjuhë shkruhet në njërin anë.

#### **b. Në bashkëpunimin mes mësimdhënësve-realizatorë:**

- ▶ para realizimit të aktivitetit të përbashkët patjetër të bashkëpunojnë që të përgatiten për atë që do të thonë dhe që nuk parashikohet,

- ▶ ofrojnë ndihmë të dukshme, të ndërsjellë, në sigurimin e pjesëmarrjes së nxënësve dhe plotësohen njëri me tjetrin,
- ▶ të gjithë nxënësit i trajtojnë njëjtë, pavarësisht nga cila grup (edhe përkatësia etnike), duke iu dhënë orientim profesional.

#### **c. Në procesin e krijimit të produktit të përbashkët:**

- ▶ secili anëtar i grupit të vogël kontribuon njëjtë për produktin përfundimtar,
- ▶ edhe pse secili kontribuon individualisht në produktin përfundimtar (vizatim, poster, strip etj.), nxënësit bashkërisht e mendojnë (plotësohen gjatë përpunimit, bashkërisht përcaktojnë titullin etj.).

#### **ç. Gjatë formimit të grupeve të vogla të punës:**

- ▶ mbahet llogari për përzierjen dhe ekuilibrin e grupeve të vogla, ndërsa gjatë përzgjedhjes së nxënësve, mësimdhënësit, paraprakisht, përgatisin p.sh. tërheqje të emrave, numërim dhe ngjashëm, që njëkohësisht mundëson përzierje spontane dhe balancim.

**d. Atmosfera në grupin është:**

- ▶ e këndshme, e gëzuar dhe relaksuese, paraprakisht me strukturë dhe rend.

**gj. Motivimi i nxënësve arrihet përmes:**

- ▶ temës dhe produktit të aktivitetit në të cilën punohet, që është me interes për nxënësit e dy / tri gjuhëve mësimore,
- ▶ me më tepër takime (një herë në javë), gjatë një gjysmëvjetori ose gjatë gjithë vitit shkollor.

**e. Efektet për raporte më të ngjeshura të ndërsjella realizohen përmes:**

- ▶ Njohjes në nivelin individual edhe i realizatorëve edhe i nxënësve, me çka vendoset komunikim ndërpersonal, duke mësuar kështu si të bashkëpunohet.

**3.6.1.3. PËRGATITJA E NXËNËSVE PËR PRANIMIN E AKTIVITETEVE TË PËRBASHKËTA NËPËRMJET ATMOSFERËS MULTIKULTURORE NË SHKOLLË**

Aktivitetet që futin ndryshime në atmosferën e shkollës dhe mjedisit dhe që e përgatisin shkollat për realizimin e aktiviteve të përbashkëta përfshijnë:

- ▶ Përgatitje të ikonografisë - në fotot dhe tekstet e vendosura në mur, në korridoret e shkollave, që reflekton karakterin multietnik të

bashkësisë, respektivisht të gjithë vendit;

- ▶ Dokumentet e shkollës - aktivitetet për bashkëpunim multietnik dhe vizion / mision në programin vjetor për punën e shkollës, në përputhje me konceptin për INA.

**3.6.1.4. PËRGATITJA E NXËNËSVE PËR PRANIMIN E AKTIVITETEVE TË PËRBASHKËTA, PËRMES PUNËTORIVE TË PËRFAQËSUARA NË ARSIMIMIN PËR SHKATHËTËSI JETËSORE (ASHJ)**

Punëtoritë e ASHJ, në më shumë mënyra, mund të realizohen edhe në shkollat njëgjuhësore edhe në ato shumëgjuhësore, si përkrahje për aktivitetet për integrim ndëretnik. Me këtë sigurohet përgatitje e nxënësve për pranim të aktiviteve të përbashkëta. Punëtoritë realizohen në orën e klasës, duke diskutuar tema relevante.

Për shkollat fillore temat më të rëndësishme nga doracaku i ASHJ janë:

- Raportet ndërpersonale,
- Raportet shoqërore.

Për shkollat e mesme tema më të rëndësishme nga doracaku i ASHJ janë:

- Raporti me të tjerët,
- Qytetërim i përgjegjshëm.

Në suaza të temave të dhëna ka punëtori nëpërmjet të cilave, në një mënyrë të pranueshme dhe të sigurtë, bisedohet për stereotipet dhe paragjykimet, për pranimin e dallimeve, për zgjidhjen e konflikteve, për komunikim jo të dhunshëm etj.

Punëtoritë e ASHJ mund të realizohen në suaza të seksionit të përcaktuar. Si ndihmë në realizimin e seksionit për temën e dhënë sigurohet edhe zbatimi i këtyre parimeve:

- ▶ punëtoritë realizohen në grup të përzier etnik/gjuhësor;
- ▶ kur punohet në cilëndo temë, që është e përfshirë në doracakët (P.sh. në temën “Zhvillimi personal”, ose “Jetesë e shëndetshme”, ose “Raporti me mjedisin jetësor” etj.), materialet e punës përgatiten në të dy/tri gjuhët mësimore, në të cilat mësojnë nxënësit që marrin pjesë në seksion.

### **3.6.1.5. KRITERE PËR ZBATIMIN E SUKSESSHËM TË AKTIVITETIT TË PËRBASHKËT PËR ARSIM TË INTEGRUAR NDËRETNIK DHE PËR ZBATIMIN E SUKSESSHËM TË AKTIVITETIT TË PAVARUR MULTIKULTURORE**

Kriteret për zbatimin e suksesshëm të aktivitetit për arsim të integruar ndëretnik janë të grupuara në tre sfera: 1. Përgatitja, 2. Realizimi

dhe 3. Promovimi i aktivitetit të përbashkët, ndërsa kriteret për zbatim të aktivitetit të pavarur multikulturor janë grupuar në dy sfera: 1 Përgatitja dhe 2. Realizimi në bazë të kriterëve.

Në suaza të PINA janë përpiluar instrumente, të cilat i shfrytëzon BZHA:

- Instrumenti për përcjelljen e zbatimit të suksesshëm të aktivitetit të pavarura multikulturore;
- Instrumenti për përcjelljen e zbatimit të suksesshëm të aktivitetit të përbashkëta për arsim të integruar ndëretnik.

Këto instrumente ngërthejnë hapat për përcjelljen e aktivitetit të pavarur dhe të përbashkët, kriteret për aktivitet të pavarur dhe të përbashkët sipas të cilave pason aktiviteti me shkallë të vetënotimit dhe pjesës për komente, që duhet t’u ndihmojë mësimdhënësve - realizatorë dhe anëtarëve të SIT-it të kenë qasje që aktiviteti të jetë sa më i suksesshëm. Në instrumentet, gjithashtu, janë dhënë edhe pyetje për refleksion.

Instrumentet shfrytëzohen për përgatitjen dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta të pavarura multikulturore, sidhepërvetërefleksion pas përfundimit të aktivitetit.

Instrumentet me kriteret për zbatim të suksesshëm të aktivitetit të pavarura multikulturore dhe të aktivitetit të përbashkët në arsim të integruar ndëretnik janë dhënë në pjesën e shtojcave të publikimit (Shtojca 1 - Instrumenti për përcjelljen e zbatimit të suksesshëm të aktivitetit të përbashkët për integrim ndëretnik; dhe Shtojca 2 - Instrumenti për përcjelljen e zbatimit të suksesshëm të aktivitetit të pavarur multikulturore).

#### **3.6.1.6. ZBATIMI I AKTIVITETEVE PËR INTEGRIM NDËRETNIK NË DHE MES SHKOLLAVE**

Që shkollat njëgjuhësore të zbatojnë aktivitete të përbashkëta domosdoshmërisht duhet që të krijojnë raporte partneriteti me një shkollë tjetër ose me shkolla të tjera. Një shkollë me mësim në një gjuhë mund të krijojë partneritetet me shkolla të tjera me gjuhë mësimore tjetër ose me një shkollë tjetër me mësim në dy/ tri gjuhë mësimore, ose me dy shkolla të tilla njëkohësisht. Aktivitetet e përbashkëta mes shkollave në partneritet mund të zhvillohen përmes kontaktit të drejtpërdrejtë, por edhe nëpërmjet shfrytëzimit të lidhjeve të internetit (audio/video). Më e dëshirueshme është krijimi i partneritetit në suaza të një komune, por nëse kjo është e parralizueshme,

atëherë kërkohet shkollë partnere në komunat fqinje ose komunat më të largëta.

Theksi për zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta në shkollat me më shumë gjuhë mësimore duhet të vendoset në aktivitetet e përbashkëta të nxënësve që mësojnë në atë shkollë. Një pjesë e aktiviteteve mund të zbatohen si të pavarura - në vetë shkollën, pa kontakt të domosdoshëm me shkollën partnere. Këto janë aktivitete që sigurojnë atmosferë dhe mjedis të përshtatshëm dhe ndihmesë për mësimdhënësit, prindërit, bashkësinë dhe komunën, që konsiderohet si parakusht për realizimin e aktiviteteve për integrim shumëmetnik.

#### **Lloje të aktiviteteve në shkollat me më tepër gjuhë mësimore**

- ▶ Në shkollat me më shumë gjuhë mësimore nuk duhet domosdoshmërisht bashkëpunimi me ndonjë shkollë tjetër për të realizuar aktivitete të përbashkëta me grupe të përziera etnike/ gjuhësore të nxënësve dhe mësimdhënësve. Aktivitetet që duhet të realizohen për ndryshim të këto shkolla janë: aktivitete të pavarura multikulturore, të gjitha llojet e aktiviteteve të përbashkëta dhe të gjitha parapërgatitjet për aktivitete. Megjithatë, edhe shkollat

shumëgjuhësore duhet të krijojnë raporte partneriteti me shkollat njëgjuhësore (në veçanti me shkollat në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën e grupeve që mësojnë një pjesë më e vogël e nxënësve në shkollën shumëgjuhësore), me qëllim që t'u jepet mundësi shkollave njëgjuhësore të realizojnë aktivitete të përbashkëta për një numër më të madh të nxënësve të tyre

- ▶ Në bashkëpunim me shkollën partnere njëgjuhësore: aktivitete të përbashkëta me nxënësit dhe aktivitete të përbashkëta me mësimdhënësit.

### **3.6.1.7. PLANIFIKIMI I AKTIVITETEVE PËR INTEGRIM NDËRETNIK NË ARSIM**

Me qëllimin që të arrihen të gjitha objektivat për integrimin shumëtnik në lëmin e arsimit, si dhe për rumbullaksim të planifikimit, duhet të tregohet më shumë kujdes në realizimin e tyre në shkollë. Planifikimi i aktiviteteve duhet të bëhet në fillim të secilit vit shkollor, ndërsa, më parë, duhet të jenë parashikuar aktivitetet dhe përmbajtjet që realisht mund të planifikohen. Gjithashtu, duhet të lihet hapësirë për futjen e përmbajtjeve dhe aktiviteteve që në rrjedhë e sipër do të planifikohen dhe realizohen. Ky lloj planifikimi është detyrë e ekipit

për integrim në shkollë, të cilin e formon vetë shkolla. Detyra e ekipit është përpilimi i planit për futjen e aktiviteteve në Programin vjetor për punë të shkollës, përgatitja e planit aksional për realizimin e secilit aktivitet si dhe vlerësimin dhe evaluimin e të arriturave. Ekipi për integrim në shkollë është përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve me shkollën partnere, si dhe në promovimin e aktiviteteve që, eventualisht, do të realizohen jashtë shkollës. Anëtarët e ekipit i shpërndajnë mes veti obligimet që kanë të bëjnë me koordinimin e të gjitha aktiviteteve që janë të planifikuara për integrim ndëretnik. Secili aktivitet, gjatë planifikimit të aktiviteteve, duhet të përpunohet në nivel të planit aksional, në të cilin do të përfshihen të gjithë hapat konkret (përgatitja, realizimi dhe promovimi), rezultati i pritur nga to, cilat kushte duhet të përmbushen që të përfundohet me këtë hap, cilët mësimdhënës do të jenë realizatorë, si dhe korniza kohore për realizimin e tyre. Nëse bëhet fjalë për aktivitet që duhet realizuar nga shkollat partnere, atëherë është e domosdoshme të caktohen personat përgjegjës nga të dy/tri shkollat partnere. Secili mësimdhënës, në suaza të planifikimit të punës së tij, duhet që të mendojë hapësirën dhe kohën për aktivitete,

që i sensibilizojnë nxënësit e tij, e që realisht do të stimulojnë aktivitete në nivel të bashkësisë së paraleleve dhe bashkësisë së shkollës.

E gjithë kjo duhet që të mundësojë ndryshime, të cilat duhet të ndodhin para së gjithash në nivel të të gjithë shkollës. Planifikimi i aktiviteteve të lira të nxënësve është fushë me më tepër të dhëna, në të cilën mund të përfshihen shumë aktivitete që trajtojnë problematika të karakterit të integritetit ndëretnik, pikërisht për shkak të dimensionit joformal që e ofrojnë. Ato duhet të shfrytëzohen si në shkollat shumëgjuhësore, po ashtu edhe në shkollat njëgjuhësore, respektivisht në suaza të bashkëpunimit me shkollat partnere. Për këtë shkak, secila shkollë, në planifikimin e aktiviteteve të këtij lloji është e detyruar ta bëjë këtë me shumë kujdes.

Pra, planifikimi i aktiviteteve të përbashkëta nëpërmjet formave dhe metodave të ndryshme duhet të zhvillohet, para së gjithash në suaza të:

- ☑ Planifikimit global vjetor;
- ☑ Planifikimit mujor, javor dhe ditor të mësimit dhe eventualisht:

- ☑ Planifikimit në nivel të bashkësisë së paraleleve;
- ☑ Planifikimit në nivel të bashkësisë së klasës

Planifikimi duhet të bëhet për aktivitetet e përbashkëta, në suaza të mësimit të rregullt dhe aktiviteteve jashtë mësimore. Në veçanti, është e rëndësishme të theksohet se, pavarësisht se në çfarë niveli planifikohen këto aktivitete, patjetër duhet të mbahet llogari se në çfarë moshe janë nxënësit, respektivisht se cilat janë karakteristikat e tyre zhvillimore. Paraprakisht, patjetër të respektohen **parimet didaktike për planifikimin e aktiviteteve**, siç janë:

- ▶ parimi i përshtatjes së mësimit me moshën e nxënësit,
- ▶ parimi i individualitetit,
- ▶ parimi i qartësisë,
- ▶ parimi sistemor dhe veprues në mësime dhe
- ▶ parimi i aktivitetit të vetëdijshëm.

### **3.6.2. BASHKËPUNIMI MES MËSIMDHËNËSVE NGA GJUHË TË NDRYSHME MËSIMORE**

Mësimit nga gjuhët e ndryshme mësimore mund të bashkëpunojnë për dobi të ndërsjellë dhe në dobi të

nxënësve të tyre, nëpërmjet këtyre përmbajtjeve për bashkëpunim, të cilat mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në:

- pjesëmarrjen në trajnime të përbashkëta për zhvillim profesional, të realizuara në kuadër të shkollës dhe jashtë saj, nga ana e ekspertëve të vendit dhe të huaj;
- realizimin i përbashkët i aktiviteteve me nxënës të përkushtuar për mirëkuptim multikulturor;
- realizimin e përbashkët të aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve me grupe të përziera etnike/gjuhësore;
- planifikimin e përbashkët të orëve;
- këmbimin e materialeve mësimore;
- vizitave të ndërsjella për mbi-këqyrjen e orëve;
- përgatitjen e përbashkët e testeve;
- kremtimin e përbashkët të festave;
- shoqërimin gjatë kohës së ekskursioneve të përbashkëta dhe vizitave me nxënës;
- realizimin e orëve të përbashkëta me nxënës përfaqësues të gjuhëve të ndryshme mësimore;
- këmbimin i mjeteve - mësimdhënësit mund të këmbëjnë çfarëdo lloj mjeteve ndihmëse mësimore, mjete nga kabinetet etj., që kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimin;
- zgjidhjen e përbashkët të problemeve me nxënës nga secila gjuhë mësimore. Kur ka probleme në interesin e përbashkët, patjetërtë përfshihen të gjitha palët e prekura, sepse nëse vendoset bashkërisht, atëherë cilësia e sjelljes së vendimeve është më e lartë, ndërsa pasojat nga ky vendim janë më të pranueshme për të gjithë. Kjo do të mundësonte përmirësimin e raporteve mes nxënësve dhe raporteve mes mësimdhënësve;
- vendimmarrjen e përbashkët të mësimdhënësve për të gjitha çështjet me interes për shkollën;
- urimin e ndërsjellë me rastin e Bajramit dhe Pashkëve ose ndonjë feste tjetër të rëndësishme për pjesëtarët e bashkësisë etnike/kulturore. Kjo është forma e zakonshme e bashkëpunimit mes mësimdhënësve nga gjuhë

të ndryshme mësimore dhe vetë mësimdhënësit shpesh këtë e nënkuptojnë kur thonë se bashkëpunojnë. Kjo do të mundësonte përmirësimin e raporteve mes mësimdhënësve.

Aktivitetet profesionale janë organet dinamike edukativo - arsimore të shkollës. Ato janë tepër të rëndësishme për t'u siguruar bashkëpunimi ndërmjet mësimdhënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore, por është e domosdoshme që të punojnë sipas një programi, paraprakisht të përpiluar dhe të miratuar, si dhe të mbajnë takime të formale dhe joformale.

### **3.6.3. PËRFSHIRJA E PRINDËRVE NË AKTIVITETET E PËRBASHKËTA PËR INTEGRIM NDËRETNIK**

Jashtëzakonisht e rëndësishme në integrimin ndëretnik është përfshirja e prindërve nga përkatësi të ndryshme etnike dhe kulturore në Këshillin e prindërve. Është e dobishme të shfaqet gatishmëri për të gjallëruar integrimin ndëretnik nëpërmjet delegimit në të gjitha organet vendimarrëse që funksionojnë në shkollë. Vetëm në këtë mënyrë do të ofrohet shembull i mirë për të gjithë nxënësit se si nga përkatësi të ndryshme kulturore duhet të nxirret ajo që është pozitive dhe se kjo është përparësi dhe jo shkak për konflikt.

Aktivitetet për integrim ndëretnik në arsim, në të cilat prindërit mund të japin kontributin e tyre, janë të ndryshme. Më poshtë janë dhënë aktivitetet për përfshirje të prindërve në dhënien e ndihmes së tyre për avancimin e integritimit ndëretnik nëpër shkolla:

- ndihmë mësimdhënësve në zbatimin e integritimit ndëretnik gjatë mëimit, për shembull: njohja e mjedisit, shoqëri, art figurativ, muzikë, EFSH, gjuhë angleze, mësim qytetar, kulturë

qytetare dhe lëndë të tjera (në shkollat shumëgjuhësore);

- ☑ në aktivitetet jashtë mësimore (në shkollat njëgjuhësore gjatë përgatitjes për realizim të aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve në partneritet bashkëpunues me shkolla të tjera, ndërsa në shkollat shumëgjuhësore gjatë realizimit të aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve);
- ☑ në sensibilizimin e nxënësve nëpërmjet ASHJ-së, si përgatitje për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve (në shkollat njëgjuhësore dhe shumëgjuhësore);
- ☑ gjatë përgatitjes së ikonografisë në shkollë, që reflekton karakterin shumetnik të bashkësisë / vendit (në shkollat njëgjuhësore dhe shumëgjuhësore);
- ☑ në organizimin e ngjarjeve dhe kremtimeve në shkollë (në shkollat njëgjuhësore dhe shumëgjuhësore);
- ☑ në organizimin e ngjarjeve shkollore për promovimin e aktiviteteve për integrim ndëretnik në arsim. Për shembull: përgatitja e

ushqimit, materialet promovuese (në shkollat shumëgjuhësore);

- ☑ në miratimin e rregullave të sjelljes gjatë ekskursioneve me nxënës të përzier në aspektin etnik/gjuhësor (në shkollat shumëgjuhësore);
- ☑ në përgatitjen dhe realizimin e aktiviteteve për shitje, për sigurimin e mjeteve të shkollës (në shkolla shumëgjuhësore);
- ☑ sigurimin e sponsorëve dhe ndihmë tjetër financiare për shkollën, për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me nxënësit nga gjuhët e ndryshme mësimore (në shkollat njëgjuhësore dhe shumëgjuhësore) dhe
- ☑ në zgjidhjen e konflikteve mes nxënësve nga bashkësi të ndryshme gjuhësore / etnike (në shkolla shumëgjuhësore).

Çdo përfshirje e prindërve është me rëndësi të veçantë dhe e mirëseardhur. Në çfarëdo forme të pjesëmarrjes së prindërve është ideale kur organizohet nga ana Këshillit aktiv dhe funksional të prindërve. Të dhënat nga hulumtimi i gjendjes fillestare për integrim ndëretnik në arsim kanë treguar se në shkolla është verifikuar tashmë

Këshilli i prindërve, si një organ formal, por shpesh ai as nuk është aktiv e as funksional. Nëse Këshilli i prindërve do të ishte aktiv dhe funksional, atëherë mund të pritet që, një organ i tillë, do t'i animojë edhe prindërit e tjerë. Apeli që del nga Këshilli i prindërve është më i pranueshëm se sa apeli i bërë nga ana e arsimtarëve.

*Si t'i josh shkolla prindërit të marrin pjesë dhe të bashkëpunojnë?*

Aktivitetet për përfshirjen dhe qëndrueshmërinë e përfshirjes së prindërve në aktivitetet për INA, duhet të zhvillohen me këtë renditje:

- ☑ anketim i prindërve që të grumbullohen informacione për gatishmërinë e tyre për përfshirje në INA. Shkolla përpilon lista me aktivitete të përbashkëta që ka për qëllim t'i realizojë, si dhe kërkon nga prindërit të regjistrohen se në cilin aktivitet dëshirojnë të jenë pjesëmarrës. Pas realizimit të anketës, shkolla i informon prindërit për rezultatet e fituara. Në shtojcën e publikimit është vendosur edhe pyetësori për prindërit (Shtojca nr.3 Pyetësor për gatishmërinë e prindërve për pjesëmarrje në aktivitete të përbashkëta për INA);

- ☑ përfshirja e prindërve në planifikimin e aktiviteteve të përbashkëta;
- ☑ shkolla kërkon mendim nga prindërit si t'i organizojë turnet, pa i ndarë nxënësit nga gjuhët e ndryshme mësimore;
- ☑ informim i vazhdueshëm i prindërve për të gjitha aktivitetet e realizuara. Të gjitha njoftimet/ftesat, që iu drejtohen prindërve, janë të shkruara në të gjitha gjuhët mësimore të përfaqësuara në shkollë;
- ☑ respektim aktiv i përkatësisë së tyre gjuhësore / kulturore;
- ☑ organizim i ngjarjeve sociale, që aktivisht i përfshijnë prindërit;
- ☑ marrje e mendimit nga prindërit për të gjitha çështjet që janë të rëndësishme për funksionimin e shkollës dhe që merren parasysh gjatë vendimmarrjes,
- ☑ me rastin e festës së patronatit shkolla organizon koktej, ku iu jep mirënjohje prindërve për pjesëmarrje në aktivitetet e përbashkëta.

Bashkëpunimi me prindërit i takon sferës së punës së shërbimeve

profesionale (pedagogët, psikologët, sociologët, defektologët), për shkak se shërbimet profesionale, në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, në kuadër të PINA, kanë qenë të trajnuara si t'i përfshijnë prindërit e nxënësve në ndryshimet për avancimin e integritit ndëretnik në shkolla edhe mes tyre.

#### **3.6.4. BASHKËPUNIMI ME KOMUNËN DHE BASHKËSINË LOKALE**

Roli i komunës në avancimin e integritit ndëretnik në arsim do të thotë marrje përgjegjësish dhe obligimesh konkrete gjatë bashkëpunimit me të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të komunës.

Aktivitetet që i bën komuna për avancimin e AIM-it me shkollat, realizohen me këtë renditje dhe përmbajtje:

- pjesëmarrje në trajnime për INA;
- përpilim i planit aksional nga komuna për INA, para fillimit të vitit të ri shkollor, si dhe miratimi i planit aksional nga Këshilli i komunës;
- orientim, përcjellje, koordinim dhe ndihmë shkollave për zbatimin e aktiviteteve për INA;

- sigurim i resurseve materiale dhe resurseve të tjera për realizimin e suksesshëm të aktiviteteve të INA në dhe ndërmjet shkollave (P.sh. sigurimi pa kompensim i sallës për promovim të aktiviteteve për INA, transporti i nxënësve për realizimin e aktiviteteve në partneritet etj.);

- fasiliteti i procesit për lidhje partneriteti mes shkollave për integritim multietnik në arsim;

- përkrahje/nxitje për krijimin e rrjetit të shkollave në komunë ose ndërmjet komunave për realizimin e bashkëpunimit mes shkollave dhe komunave;

- sigurimi i mbulimit medial për ngjarjet dhe promovimet e aktiviteteve të përbashkëta të grupeve të “përziera” të nxënësve.

Paraprakisht, në komunë, formohet grup përgjegjës për planifikim, organizim dhe koordinim aktivitetesh për avancim të INA, i përbërë nga të punësuar në komunë. Në disa komuna më të vogla është përgjegjës vetëm një person - koordinator për INA, i cili merret me zbatimin e arsimit të integruar ndëretnik.

Plani aksional i komunës për INA, që duhet ta përpilojë grupi/koordinatori për INA në komunë, bëhet gati para

ose në fillim të vitit shkollor. Plani miratohet nga Këshilli i komunës.

Aktivitetet për orientim, përcjellje dhe koordinim të aktiviteteve për INA në shkolla, me përkrahjetë përhershme nga ana e komunës, vazhdon gjatë tërë vitit shkollor.

Komuna duhet të jetë përkrahësi kryesor në vendosjen e raporteve të partneritetit mes shkollave dhe të ketë evidencë të qartë për vendosjen e partneritetit mes shkollave, me qëllim që të mund të japë propozime për vendosjen e partneritetit me shkolla tjera, me të cilat ende nuk është vendosur po ky partneritet.

Pasi në komunë të jenë marrë planet aksionale nga shkollat e mesme dhe fillore, si dhe të gjitha informacionet për aktivitetet në shkollë, komuna duhet që gjatë tërë kohës të inicojë rrjetëzim mes shkollave në vetë komunën dhe mes shkollave të komunave tjera, nëpërmjet bashkëpunimit me komunitat tjera (përgjegjës për INA në shkollat tjera).

#### [Aktivitete për bashkëpunim mes komunës dhe shkollës:](#)

Komuna kërkon nga ekipi për integrim shkollor:

- ▶ të dorëzojë plan aksional global dhe plane të detajuara aksionale për aktivitete për INA,
- ▶ të informojë rregullisht për datat e aktiviteteve të INA në shkollë (3-5 ditë punë para aktiviteteve), dhe
- ▶ të informojë rregullisht për të arriturat dhe pengesat eventuale në realizimin e aktiviteteve të INA në shkollë ose bashkëpunimin me partneritet.

Në bashkëpunimin mes komunës dhe ekipeve për integrim në shkollë, grupi përgjegjës për INA në komunë, do të kërkojë nga ekipet për integrim në shkollë që të dorëzojnë plan global vjetor aktiviteteve dhe plan aksional aktiviteteve për INA në shkollë, që duhet të dorëzohen në fillim të vitit shkollor. Plani global do të jetë pjesë përbërëse e Programit vjetor për punë të shkollës, i cili më së voni deri më 31 qershor duhet të dorëzohet në komunë. Ndryshe, ekipi për integrim në shkollë, rregullisht e informon komunën për datat e për realizimin e aktiviteteve për INA, në një afat prej 3 deri më 5 ditë pune para se të realizohet aktiviteti.

Komuna mban komunikim të rregullt dhe bashkëpunon me ekipet për integrim, në të gjitha shkollat. Ajo kërkon nga ekipet për integrim në shkollat të

jenë rregullisht të informuar për të arriturat si dhe për pengesat që shfaqen gjatë realizimit të aktiviteteve për INA, që të ofrojë ndihmë për gjetjen e zgjidhjeve të duhura. Grupi / koordinatori përgjegjës për INA në komunë mund të organizojë takime të rregullta ose periodike me koordinatorët e ekipeve, me qëllim që të ketë qasje dhe t'iu japë ndihmë shkollave për aktivitetet e INA, sidomos në rastet kur duhet të sigurohet: **1.** Diseminim i rrëfimeve të suksesshme në shkollë dhe komunë, **2.** Resurse për realizim dhe promovim të aktiviteteve për INA, **3.** Mbulim medial të aktiviteteve të INA dhe promovim si dhe të gjitha llojet tjera të ndihmës nga ana e komunës.

Në fund të çdo viti shkollor, grupi / koordinatori përgjegjës për INA në komunë dhe koordinatorët e SIT-eve nga të gjitha shkollat, mbajnë takim me rend dite që mund të përfshijë tema të ndryshme aktuale në nivel të shkollës dhe komunës, në kuadër të realizimit të aktiviteteve për INA. Përgjithësisht në këto takime diskutohet dhe arrihet marrëveshje për:

- ▶ vështrime për të arriturat vjetore për INA në shkollë (në bazë të raporteve të dorëzuara nga SIT-et para fundit të vitit shkollor);

- ▶ shqyrtim të mundësive për avancimin e INA në shkolla;
- ▶ planifikim i aktiviteteve pasuese të INA dhe ndryshimet në Planin aksional dhe Programin vjetor të punës së shkollave për vitin e ardhshëm shkollor;

Në zinxhirin e vendosur të bashkëpunimit të komunës me shkollat, institucionet dhe bizneset lokale, komuna është në pozitë që të sigurojë resurse financiare dhe materiale të nevojshme për përkrahjen e aktiviteteve për INA në shkolla.

**PJESA E TRETË**



# 4. KOMPETENCAT NDËRKULTURORE DHE ROLI I TYRE NË SISTEMIN ARSIMOR

*Prof. Dr. Valentina Gulevska*

## 4.1. RËNDËSIA E KOMPETENCAVE NDËRKULTURORE PËR MËSIMDHËNËSIT

Në prag të sfidave të mijëvjeçarit të ri, bashkë me ngritjen e vetëdijes mbi vlerat e përbashkëta njerëzore dhe idesë që i përkasin një hapësire globale kulturore, sërish në mënyrë eksplicite, u vërtetua rëndësia e arsimit për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një shoqërie stabile, paqësore dhe demokratike.

Edhe pse çdo shtet i ka specifikat dhe traditat e veta, ndryshimet në strukturën socio - politike të botës moderne (rritja e mobilitetit migrues dhe profesional, globalizimi ekonomik etj.) vërtetuan se asnjë sistem arsimor nuk mund të mbijetojë në boshësi historike e sociale. Përzierja e njerëzve me përkatësi të ndryshme etnike, kulturore dhe religjioze, sidomos në qendrat e mëdha urbane, i ballafaqoi kreatorët e politikave arsimore me sfida të reja, akoma më të thella.

Duke pasur parasysh karakterin multietnik të shoqërisë sonë, koncepti i integritetit ndëretnik në arsim përfaqëson një sërë aktivitete të koordinuara, mbështetur në vizionin për krijimin e sistemit arsimor në të cilin garantohen të drejtat e njeriut dhe pjesëmarrja demokratike e të gjithë subjekteve relevante në planifikimin dhe realizimin e procesit edukativo - arsimor. Megjithatë, përparimi demokratik i shoqërisë dhe rezultatet e funksionimit të sistemit arsimor, jo gjithmonë janë të kushtëzuara nga planifikimi, udhëheqja dhe kontrolli i procesit mësimor. Ato varen edhe nga cilësitë profesionale të kuadrit arsimor. Me fjalë të tjera, kompetencat kryesore të arsimtarëve paraqesin *conditio sine qua non* për përmbushjen e qëllimeve edukativo -arsimore.

Në shkencën e pedagogjisë ekziston konsensusi se koncepti global i arsimit multikulturor është formësuar me disa parime kryesore, mes të cilave renditen: promovimi i qasjes së barabartë në arsim, tejkalimi i segregacionit në institucionet arsimore, flakja e paragjykimeve dhe stereotipeve, empatia ndaj atyre që janë të diskriminuar dhe të izoluar dhe bindja se çdo individ ka kapacitet të mësojë dhe zhvillohet. Në varësi nga

këto parime modelohen dhe miratohen kompetencat e domosdoshme të arsimtarëve për punë në mjediset multikulturale.

## 4.2. ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE NDËRKULTURORE TE MËSIMDHËNËSIT

Hulumtimet në sferën e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve janë të shumta dhe të shumëllojshme. Para së gjithash, nga ana e hulumtuesve dhe kreatorëve të politikave arsimore, më shpesh, përdoret “tuning”<sup>24</sup> dhe karakteristikat e kompetencave kryesore të mësimitdhënësve në një rajon të caktuar dhe më gjerë.

Zakonisht, kompetencat përkufizohen si kombinim kompleks i dijes, të të kuptuarit, të shkathtësive, aftësive, vlerave dhe qëndrimeve që çojnë në veprimtari efektive në një sferë të caktuar të jetesës njerëzore.

Në analogji me këtë, kompetencat e arsimtarëve mund t’i përkufizojmë si një përmbledhje dijesh profesionale, shkathtësish, aftësish, vlerash dhe

<sup>24</sup> Harmonizimi i projekteve arsimore në Europën Juglindore me sistemin e Bolonjës.

qëndrimesh që mundësojnë veprimtari efektive në procesin edukativ e arsimor.

Koncepti i integritit ndëretnik në arsim ofron perspektiva të ndryshme për përforsimin e kompetencave ndërkulturore të mësimdhënësve. Këto kompetenca nuk mund të përfitohen për një periudhë të shkurtër, por mësohen, zhvillohen dhe mbindërtohen përgjatë jetës, sidomos nëpërmjet kultivimit të qëndrimeve intelektuale dhe të vlerave etike, që u mundësojnë arsimtarëve ta shohin qartë fuqinë dhe përgjegjësinë e tyre në shoqëri. Zbatimi i konceptit fokusohet në sigurimin teorik dhe praktik të atmosferës inkluzive dhe kreative për nxënie, për integrim ndëretnik dhe komunikim në institucionet arsimore, si dhe për trajtim korrekt në drejtim të perceptimit të mendimeve dhe qëndrimeve ndryshe - që vijnë nga kompozicioni etnik i sistemit arsimor në Republikën e Maqedonisë.

Duke pasur parasysh faktin se shkolla është vendi ku qëndrimet e formësuara ndaj grupeve tjera etnike akoma mund të ndryshojnë, përpjekjet e punëtorëve të arsimit duhet të drejtohen në zotërimin e bindjes së zakonshme që kultura është mbi të gjitha e drejtë dhe natyrshëm korrekte. Mësimdhënësi

duhet të ketë njohuri për kulturën e tij, por edhe të shfaq gatishmëri të njohë kultura tjera, të promovojë barazi mes nxënësve dhe të ndërmarrë aktivitete dhe masa kundër çdo lloj diskriminimi dhe gjuhë të urrejtjes.

Dihet botërisht se kompetencat profesionale të mësimdhënësve ngritën mbi tre nivele (dimensione): Niveli kognjitiv (dituri), niveli afektiv (vlerat) dhe niveli pragmatik (shkathtësitë).<sup>25</sup>

Secili nivel përfaqëson një segment të veçantë në procesin e profesionalizimit, njëkohësisht, është e lidhur ngushtë me dy nivelet tjera. Pikërisht për këtë, kur flasim për ndërtimin dhe fuqizimin e kompetencave ndërkulturore të arsimtarëve, duhet të kemi parasysh përputhjen e ndërsjellë të diturisë, qëndrimeve dhe shkathtësive, me të cilat duhet të formësohet një arsimtar që të mundet, në mënyrë të suksesshme dhe efikase, t'u përgjigjet sfidave që vijnë me ndryshimet dhe gjendjet aktuale në arsim.

Duke ecur sipas renditjes, një nga kompetencat më të rëndësishme ndërkulturore të arsimtarëve është dija e domosdoshme dhe të kuptuarit

<sup>25</sup> OECD, »Educating Teachers for Diversity: Meeting the Challenge«, (OECD Publishing, 2010), 28.

e nocioneve: “identitet”, “etnicitet”, “kulturë”, “ndërkulturalizëm”, “multi-kulturalizëm” etj. Kjo kompetencë e rëndësishme parësore e bën kuptimplotë orientimin filozofik të mësimdhënësit, i cili duhet të drejtohet kah ide, principe dhe vlera të caktuara. Nga kjo, në mënyrë suksessive, formësohen qëndrime profesionale që e nxisin hapjen dhe kërshërinë ndaj kulturave tjera.

Nganjëherë mësimdhënësi nuk është i shqetësuar vetëm për atë se si mësojnë nxënësit e tij, por edhe se si ndjehen në shkollë dhe jashtë saj.<sup>26</sup>

Kompetencat që ndërthurin elemente emocionale siç janë: kujdesi, empatia, përhapja e gëzimit, pikëllimit etj., prodhohen nga sfera afektive e procesit për mbathje më cilësore. Në këtë sferë, kryesisht, manifestohet inteligjenca emocionale e arsimitarit.

Sipas disa hulumtuesve, logjika emocionale është e ndryshme nga ajo intelektuale. Për funksionimin e saj nuk është patjetër të vendoset lidhje ndërmjet shkakut dhe pasojës. Logjika emocionale ka të bëjë me sekuencat

e fakteve që përbëjnë majën e kënaqësive dhe nevojave njerëzore.<sup>27</sup> Sfera afektive është e një rëndësie të veçantë për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore të mësimdhënësit. Nuk është aspak detyrë e lehtë, p.sh., t’iu jepet mësim nxënësve që nuk i përkasin kulturës së arsimitarit.<sup>28</sup> Për këtë shkak, arsimitari, me ndihmën e kësaj kompetence, mund t’i zotërojë barrierat etnike dhe kulturore dhe t’i kuptojë ndjenjat dhe mendimet e të tjerëve. Me fjalë të tjera, mësimdhënësi duhet aftësuar që t’i sheh gjërat edhe nga optika e tjetrit. Në këtë kontekst, reduktimi i distancës psikologjike mes subjekteve që i përkasin një kulture dhe etniciteti të ndryshëm arrihet nëpërmjet ekspresionit emocional spontan dhe empatik ndaj tjetrit.

Së këndejmi, aftësia për empati paraqet karakteristikë të brendshme të personalitetit, por ajo mundet, gjithashtu, të mësohet, të kultivohet dhe të zhvillohet. Empatia, zakonisht, përkufizohet si kapacitet për të kuptuar ndjenjat, qëllimet, motivet

<sup>26</sup> Elizabeta Bahtovska, *Këshilla praktike për shënimin e rezultateve të nxënies; doracak*, (Manastir: Univerziteti “Shën. Klimenti i Ohrit”, 2012), 9.

<sup>27</sup> Pharanad J. and M. Doucet, eds. *Éducation, quand les émotions s’émèlent!*, (Québec: Les Presses de l’ Université du Québec, 2013).

<sup>28</sup> Jean Moule, *Cultural Competence: A Primer for Educators*, (Boston: Cengage Learning, 2011), 5.

dhe dëshirat e njerëzve të tjerë. Sipas kësaj, arsimtari mund t'i analizojë emocionet e nxënësve dhe të mësojë si të reagojë në përvojat dhe traditat e ndryshme të tyre kulturore, në mënyrë pozitive.

Mësimdhënësit shpesh e kanë rolin e modelit për sjellje, të cilin, shpejt dhe lehtë, e pranojnë nxënësit. Në këtë kuptim, nëse arsimtari dëshiron që të ndërtojë raporte për respektimin e dinjitetit të njerëzve dhe respektimin e dallimeve etnike dhe kulturore, në sistemin e edukimit dhe arsimimit, duhet patjetër këtë ta demonstrojë me shembullin e vetë. Në këtë mënyrë kompetencat ndërkulturore të arsimtarit manifestohen në nivel pragmatik. Autoriteti pedagogjik i arsimtarit përfaqëson një lloj disipline me ndihmën e së cilës ai e rregullon orientimin e atyre që edukon dhe, në thelb, ndikon mbi bindjet e tyre. Në këtë kuptim, autoriteti pedagogjik i arsimtarit do të varet nga përgatitja e tij paraprake morale - etike dhe psikologjike - pedagogjike.

Si shembull i suksesshëm për organizimin e aktiviteteve për sa i përket zhvillimit të kompetencave të arsimtarëve të ardhshëm dhe gatishmërisë për punë në grup, në mjedis multikulturor, është projekti

“Kurikula universitare për punë ndërkulturore me të rinjtë”, i cili u zbatua nga Qendra për Bashkëpunim Ndërkombëtar “Loja” në Tetovë. Ky projekt filloi të realizohej nga viti 2008, në bashkëpunim me Universitetin e Evropës Juglindore dhe më pas vazhdoi me aktivitete për mbajtjen e kurseve për studentë, të cilët studiojnë në fakultetet pedagogjike në Tetovë, Shkup dhe Shtip.

Projekti është i orientuar në institucionalizimin e kurikulimit universitar, i cili ka për qëllim që arsimtarët e ardhshëm t'i bëjë pjesë e temave mbi të drejtat e njeriut dhe studimeve paqësore.

Qëllimi i projektit është zbatimi i kurikulimit universitar për arsim ndërkulturor dhe qasja jo e dhunshme për transformimin e konflikteve, në trajnimet formale dhe joformale të arsimtarëve të ardhshëm, që do të studiojnë në fakultetet pedagogjike. Aktivitetet janë të orientuara drejt ndryshime të qëndrueshme të sistemit arsimor, në drejtim të arsimit të integruar, që janë ndihmës për proceset demokratike dhe të bashkëpjesëmarrjes paqësore midis bashkësive të ndryshme etnike, dialogut dhe bashkëpunimit të tyre.

Në suaza të këtij projekti po zbatohet një lëndë ndërdisciplinare, e cila, në vete, ngërthen tre segmente kyçe, barabarësisht të shpërndara përgjatë semestrit, tema nga sfera e të drejtave të njeriut dhe demokracia, teoritë shumëkulturore, modelet dhe kontradiktat, si dhe ato të sferës së arsimit, si një burim vendimtar për motivim në ndërtimin e shoqërisë demokratike.

Lënda ka për qëllim që t'i nxisë studentët për temat që ndërlidhen me të drejtat e njeriut dhe demokracisë, zgjidhjen e konflikteve dhe vendosjen e paqes pas konfliktit, si dhe me çështje mbi paqen dhe sigurinë në mjedise shumëkulturore. Për më tepër, si qëllim mbetet që studentët të sublimojnë shkathtësi dhe dije, që më pas, pas mbarimit të studimeve, të mundën t'i zbatojnë në mënyrë cilësore në sferën e realizimit të tyre profesional. Gjithashtu, në suaza të këtij projekti, punohet për ngritjen e vetëdijes te studentët - arsimtarët e ardhshëm për rëndësinë e temave të theksuara, që të kenë mundësi për të identifikuar sferat në të cilat do të mund që, në mënyrë aktive, të përfshihen, të përgatiten për projekte për të rinjtë, me përmbajtje multikulturore, si dhe për përfshirjen e studimeve paqësore në sistemin arsimor.

Programi realizohet në tri komponentë, që janë të shpërndara përgjatë semestrit:

- ▶ Komponenti i parë - ligjërime në tema mbi të drejtat e njeriut dhe studimet paqësore, që realizohen nga profesorët e fakultetit;
- ▶ Komponenti i dytë – trajnime mbi përpunim kreativ të konflikteve (të bazuar dhe avancuar)
- ▶ Komponenti i tretë - punë praktike e studentëve, respektivisht ndihmë për nismat në drejtim të shfrytëzimit të dijeve dhe shkathtësive të përbrendësuar nga dy komponentët e para.

Komponenti i dytë dhe i tretë janë organizuar nga ana e qendrës “Loja”, në bashkëpunim të ngushtë dhe konsultim me përfaqësuesit e universitetit.

### 4.3. STRUKTURA E KOMPETENCAVE NDËRKULTURORE TË MËSIMDHËNËSIT

Roli i mësimdhënësit në shkollën bashkëkohore gjithnjë e më tepër bëhet më kompleks për shkak të sfidave dhe detyrave që shfaqen sot përpara arsimit.

Pikërisht për këtë, lista e kompetencave kyçe ndërkulturore e arsimtarëve është fleksibile, e përshtatshme dhe asnjëherë nuk mund të thuhet se është tërësisht e përfunduar.

Në tabelën e mëposhtme është ofruar struktura e kompetencave ndërkulturore e arsimtarëve, e cila bazohet në përshkruesit e kualifikimeve, në përputhje me Programin nacional për kualifikime në arsimin sipëror. Profesorët e fakulteteve pedagogjike mund ta shfrytëzojnë këtë strukturë kompetencash si bazë nismëtare në edukimin e studentëve të tyre përgjatë arsimimit inicial.

**Tabela 1: Kompetencat kyçe ndërkulturore të arsimtarëve**

<b>DIJA DHE TË KUPTUARIT PËR:</b>	<b>AFTËSI DHE SHKATHTËSI PËR:</b>
<p><b>Aspektet dhe sferat kyçe të mësimit multikulturor (promovimi i multikulturalizmit; promovimi i të drejtave të njeriut, demokracia, drejtësia dhe barazia sociale; zvogëlimi i stereotipeve, paragjykime dhe diskriminim; zgjidhja e konflikteve)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ demonstrim të vetëdijes për kulturën që i përket dhe zhvillim të identitetit pozitiv kulturor;</li> <li>▶ hapje për njohje veçorish të kulturave të tjera (të vlerave, zakoneve, praktikave etj.);</li> <li>▶ respektim të dallimeve etnike e kulturore ndërmjet nxënësve - kolegëve dhe përmbajtje nga vlerësimi i veçorive të dallimeve kulturore;</li> <li>▶ promovimi i barazisë midis nxënësve dhe pranimi i dallimeve;</li> <li>▶ të kuptuarit e mendimeve dhe ndjenjave të tjetrit dhe shikimi i gjërave nga perspektiva e tjetrit (multiperspektivë);</li> <li>▶ demonstrim të vetëdijes dhe respekt ndaj përvojës, veçorive, gjuhës dhe kulturës të secilit nxënës;</li> <li>▶ zhvillim të shkathtësive të nxënësit që t'i zbatojnë konceptet mbi të drejtat e njeriut në situatat e përditshme;</li> <li>▶ zhvillim të shkathtësive të nxënësit që të përballen me sfidat e padrejtësive dhe që të ndërmarrin aksion për barazi sociale;</li> <li>▶ zhvillim të shkathtësive të nxënësit për inicimin e aksioneve demokratike dhe futjen e ndryshimeve në kontekstin e shkollës dhe më gjerë;</li> <li>▶ zhvillim i shkathtësive të nxënësit për njohjen e stereotipeve dhe paragjykimeve tek vetja dhe të tjerët, si dhe angazhimi për tejkalimin e tyre;</li> <li>▶ ndërmarrje aktiviteteve të drejtuara kundër çdo lloji diskriminimi dhe gjuhe të urrejtjes në sistemin edukativ – arsimor;</li> <li>▶ zhvillim i shkathtësive të nxënësit për analizë dhe zgjidhje të situatave konfliktuozë;</li> <li>▶ shfrytëzim i metodave për mësim aktiv dhe të bazuar në përvojë, të cilat promovojnë mësimin multikulturor (dialog, diskutime në grupe të vogla dhe të mëdha, marrja e roleve, demonstrim dhe simulim, analizë e teksteve dhe situatave, shfaqje teatrore).</li> </ul>

**Karakteristikat dhe potencialet e praktikave të mira për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve Avancim të INA**

- ▶ demonstrim i pranimet të tjetrit, adaptim dhe integrim i dallimeve etnike dhe kulturore në procesin edukativ -arsimor;
- ▶ nxitje e nxënësve për njohje më të mirë mes tyre dhe krijim i grupit koheziv;
- ▶ nxitje për pjesëmarrje aktive të nxënësve në kohën kur punojnë në grupe të përziera të vogla dhe të mëdha, duke koordinuar aktivitetet për arritje të një qëllimi të përbashkët.
- ▶ sigurim i statusit të barabartë mes nxënësve për të krijuar idenë që secili vlen njësoj (nxënësit iu bëhen lavde të njëjta për arritjet e tyre, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike;
- ▶ krijimi i atmosferës së respektit të ndërsjellë ndërmjet nxënësve dhe mundësisë për afrim më të madh me njëri – tjetrin, si dhe shoqërim përgjatë aktiviteteve të përbashkëta;
- ▶ përkujdesje gjatë dhënies së mesazheve për AIM deri te nxënësit, nëpërmjet kurikulimit të fshehur, që e manifeston si arsimtar, gjatë dhe pas realizimit të aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore;
- ▶ shfrytëzimi i strategjive dhe metodave të ndryshme për mësim kooperativ, hulumtim, zgjidhja detyrash problemore, dialog dhe diskutim mbi çështje kontradiktore, zgjidhje konfliktesh, aktivitete që kanë për bazë përvojën, aktivitete që shfrytëzojnë mediat;
- ▶ demonstrim i sensibilitetit dhe përgjegjësisë mbi idetë personale, nevojën për mësim, interesat dhe ndjenjat për nxënësit me përkatësi të ndryshme etnike;
- ▶ zhvillim shkathtësish për kreativitet te nxënësit, të menduarit kritik në zgjidhjen dhe marrjen e vendimeve të përbashkëta; kur punojnë janë brenda aktiviteteve mendore dhe praktike manipulative;
- ▶ zhvillim shkathtësish te nxënësit për të vepruar si agjent për ndryshime dhe ndërmarrja e aksioneve për barabarësi sociale dhe praktika aktive demokratike;
- ▶ rregullim dhe dizajnim i enterierit të klasave në shkollë me ndërfutjen e multikulturalizmit, nëpërmjet materialeve pamore (ikonografi karakteristike për identitetin e grupeve të ndryshme etnike | kulturore);
- ▶ bashkëpunim dhe përfshirje e prindërve dhe bashkësisë më të gjerë shoqërore në krijimin e një atmosfere për respektim dhe bashkëpunim të ndërsjellë.

<p><b>Rëndësia e komunikimit, bashkëpunimit dhe ndërveprimit në avancimin e raporteve ndëretnike mes nxënësve</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ inicim i kontakteve të personalizuar, shoqërim dhe kultivim i miqësisë mes nxënësve me përkatësi të ndryshme etnike brenda dhe jashtë mjedisit shkollor;</li> <li>▶ nxitje e dëgjimit aktiv, respektim i ideve dhe qëndrimeve të të tjerëve dhe vendosja e komunikimit empatik me nxënësit;</li> <li>▶ nxitje e bashkëpunimit mes nxënësve me përmbajtje të përzier etnike, që vendos ndërveprim të drejtpërdrejtë, varësi pozitive, mundësi të njëjta për sukses në përgjegjësinë grupore dhe individuale;</li> <li>▶ nxitje e diskutimit të ndërsjellë, me ç'rast nxënësit me përkatësi të ndryshme etnike \ gjuhësore do të kenë mundësi që të shprehin dhe të ndajnë idetë e tyre, përvojat, pikëpamjet dhe ndjenjat;</li> <li>▶ krijimi i mjedisit pozitiv dhe inkluziv në të cilin nxënësit angazhohen dhe tregojnë interes dhe motivacion të madh;</li> <li>▶ shfrytëzim i teknikave dhe praktikave për përmirësimin e komunikimit dhe relacioneve mes ndërgrupeve   multietnike të nxënësve.</li> </ul>
<p><b>Procesi i përcjelljes, reflektimit dhe dhënies së informacioneve kthyesë për realizimin e aktiviteteve për INA</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ përcjellja sistematike dhe dhënia e informacioneve kthyesë gjatë realizimit të aktiviteteve;</li> <li>▶ nxitje e nxënësve për refleksion dhe vlerësim të përvojave vetanake dhe përjetimi i aktiviteteve të INA.</li> </ul>
<p><b>Rëndësia e reflektimit dhe vetëvaluimit të arsimtarëve në praktikën e tyre për INA dhe rëndësia e nevoja për zhvillim të vazhdueshëm profesional të arsimtarëve në sferën e INA dhe arsimit ndërkulturor</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ zbatim i refleksionit dhe vetëvaluimit në punën vetanake gjatë realizimit të aktiviteteve të AIM;</li> <li>▶ sjellja e vendimeve demokratike dhe transparente në lidhje me mësimin dhe prosperitetin e të gjithë nxënësve njësoj;</li> <li>▶ inicim për praktikimin e hulumtimeve aksionale për përmirësimin e praktikave pedagogjike për AIM;</li> <li>▶ identifikim i nevojave dhe interesave vetanake për arsimim të përjetshëm dhe planifikim i zhvillimit profesional në sferën e INA (pjesëmarrja në trajnime dhe forma të tjera të përsosjes profesionale);</li> <li>▶ punë në grup dhe bashkëpunim me kolegët në gjetjen e mënyrave për avancimin e INA (këmbimi i përvojave dhe marrje e dhënie të informacionit kthyes për përmirësimin e praktikave për INA);</li> <li>▶ përcjellje dhe mbindërtim të arritjeve të reja shkencore dhe praktikave nga sfera e INA në praktikat vetanake.</li> </ul>

Klasa është vendi i natyrshëm i multikulturalizmit. Këtu përqendrohen një numër i madh çështjesh specifike kulturore dhe, për këtë arsye, secili mësimmshënës duhet të ketë të ngritura rregulla të qarta, të cilat do t'i zbatojë në punën e tij. Disa hulumtues<sup>29</sup> vlerësojnë se drejtimet kryesore sipas të cilave duhet të udhëhiqet secili mësimmshënës që punon në mjedise multikulturore janë:

- ▶ t'i mësojë nxënësit që të respektojnë kulturën e tjetrit njësoj si të veten.
- ▶ t'i nxisë nxënësit të përfitojnë përvojë mbi dallimet kulturore të njerëzve dhe, njëkohësisht, të krijojnë vetëdije mbi ngjashmëritë e të gjithë njerëzve si qenie njerëzore.
- ▶ t'u japë kurajë nxënësve që të hapen ndaj njëri – tjetrit që të krijojnë qëllime të përbashkëta dhe bashkërisht të mësojnë drejt arritjeve të reja.
- ▶ t'u ndihmojë nxënësve që, në mënyrë të suksesshme, të përshtaten dhe aktivisht të funksionojnë në shoqëri multikulturore.

Në këtë kuptim, kompetencat ndër-kulturore të arsimtarëve ndikojnë

<sup>29</sup> Wilma De Melendez and Verna Beck, *Teaching Young Children in Multicultural Classrooms: Issues, Concepts, and Strategies*, (Wadsworth: Cengage Learning, 2013), 6.

fuqishëm në sigurimin e atmosferës pozitive dhe të bashkëpunimit në klasë. Ata përfshijnë në vete numër të madh elementesh, që në aspektin e përgjithshëm manifestohen nëpërmjet identifikimit personal, të gjuhës, mendimit, komunikimit, aksioneve, shprehive dhe bindjeve të mësimmshënësve.

Ideja e dinjitetit njerëzor është e vjetër aq sa qenia njerëzore dhe ekziston në forma të ndryshme në të gjitha kulturat dhe religjionet.<sup>30</sup> Arsimi, nga ana tjetër, paraqet mjet të pazëvendësueshëm për zhvillimin e thellë dhe harmonik të njerëzimit, që e respekton këtë ide. Për shkak të kësaj, është e domosdoshme që politikat moderne arsimore ta orientojnë me përgjegjësi të madhe vëmendjen e tyre drejtë qëllimeve të sistemit arsimor dhe drejtë mjeteve, me ndihmën e të cilave ky sistem do të funksionojë. Sipas disa analistëve, arsimi shumëkulturore, në realitet, paraqet pjesë nga platforma e një synimi të madh për barabarësi të kulturave në suaza botërore.<sup>31</sup>

<sup>30</sup> LOJA, «Course on multiculturalism: Handbook for students», (Tetovo: Center for Balkan cooperation LOJA, 2013), 16.

<sup>31</sup> Marilynne Boyle-Baise, «Bleeding Boundaries or Uncertain Center? A Historical Exploration of Multicultural Education.» In *History of Multicultural*

Në bazë të kësaj, mund të përfundojmë se raportet ndëretnike dhe ndërkulturore në sistemin arsimor në Republikës së Maqedonisë, në mënyrë të natyrshme dhe sistematike, diktojnë nevojën e komunikimit konstruktiv dhe të ndërveprimit në frymën e trendëve bashkëkohore të arsimit. Zbatimi, nga ana tjetër, i këtyre qëllimeve dhe prioriteteve edukative - arsimore nuk mund të mendohet pa dije adekuate, shkathtësi dhe qëndrime, respektivisht, pa kompetenca adekuate në tërësinë e kuadrove edukativ - arsimor në shkollë (mësimdhënësve, punëtorëve profesional dhe drejtorëve). Mbetet veçanërisht e rëndësishme që studentët - mësimdhënësit e ardhshëm të përfitojnë “dije për aksion”<sup>32</sup> jo vetëm në kuptimin instrumental, profesional (si profesionistë të ardhshëm), por edhe në kuptimin politik dhe shoqëror (si qytetarë të një shoqërie të caktuar).

Në këtë kontekst, zhvillimi i kompetencave ndërkulturore të arsimtarëve paraqet segmentin kyç në ndërtimin e kapaciteteve në shoqërinë tonë

---

*Education, vol. 2: Foundations and Stratifications*, edited by C. A. Grant and T. K. Chapman. (New York: Routledge, 2012).

32 Zgaga, Pavel. *Review of Tuning Teacher Education Curricula in the Western Balkans*, edited by Nataša Pantić. (Belgrade: Centre for Education Policy, 2008).

multikulturore dhe multi-etnike për identifikimin e qëllimeve dhe perspektivave të përbashkëta, të cilat çojnë kah një integrim më i madh.

#### **4.3.1. USHTRIME PËR PËRFORCIMIN E KOMPETENCAVE NDËRKULTURORE TE MËSIMDHËNËSIT**

Me qëllim që të ilustron përforcimi i kompetencave konkrete ndërkulturore, në vazhdim janë dhënë shembuj për aktivitete që realizohen si punëtori multikulturore me nxënës përkatësish të ndryshme etnike dhe gjuhësore.

Punëtoritë multikulturore realizohen në dy gjuhë. Shembujt janë marrë nga doracak “Punëtoritë multikulturore për shkollat fillore”<sup>33</sup>

##### **Ushtrimi 1**

*Si mundet mësimdhënësi që te nxënësi të zhvillojë ndjeshmëri ndaj përkatësisë së grupit, pavarësisht nga përkatësia e bashkësisë së tij etnike konkrete?*


Formohen tre grupe nga shtatë - tetë nxënës. Në fillim të aktivitetit

---

33 Dedova R., Balazhi S., Alushevski S., Negrievska, F “Doracak për punëtori multikulturore për shkollat fillore (botim i redaktuar) () USAID, “Qendra Maqedonase për Edukim Qytetarë”, Shkup.

mësimdhënësi iu tregon nxënësve fotografi se si duhet të duket prodhimi final i punës së tyre të përbashkët (fotoja 4). Pastaj, grupet mes vete arrijnë pajtimin se cilën figurë (drurin, fluturën apo diellin) do ta punojnë. Në tre fletë - hamer mësimdhënësi vizaton: trung me degë pa gjethe, flutur pa krahë dhe diell pa rreze. Nxënësit, të ndarë në tre grupe, duhet që ta përfundojnë figurën, e cila duhet që të ngjajë me punimin të treguar në foton 1. Me ndihmën e mësimdhënësit nxënësit i vizatojnë shuplakat e tyre në fletën e vizatimit dhe më pas i ngjyrosin. Në fund, shuplakat e ngjyrosura ngjiten në fletën - hamer të vizatimit dhe, në këtë mënyrë, druri i fiton gjethet, flutura krahët, ndërsa dielli rrezet. Përpunimet e tri grupeve ngjiten dhe krijohet posteri i përbashkët. Thuhet që ky poster është vepër e përbashkët e gjithë grupit (respektivisht e të tri grupeve) dhe shqyrton të gjitha përpunimet. Si plotësim i këtij ushtrimi mund të shtohet aktiviteti pasues: mësimdhënësi i inkurajon nxënësit që të zgjedhin emër të përbashkët për gjithë grupin. Nxënësit japin propozime. Kur do të shterohen të gjitha propozimet nga nxënësit, atëherë kërkohet që individualisht të deklarohen se cili emër iu pëlqen më tepër, ndërsa mësimdhënësi i

numëron votat për secilin propozim. Në fund mbledhen votat dhe shpallet emri i grupit. Nëse ka dy e më tepër emra me numër të njëjtë votash, atëherë pranohen të gjitha emrat dhe kombinohen. Pasi të zgjidhet emri i grupit mësimdhënësi e shkruan në fletë të madhe në të gjitha gjuhët e përfaqësuara në grup.



**Fotoja. 4 – Pamja e produktit përfundimtar**

#### **Ushtrimi 2**

*Si mund mësimdhënësi të zhvillojë te nxënësit vetëdije për praninë e dallimeve dhe ngjashmërive kulturore tek njerëzit nëpërmjet mësimit të fjalëve në gjuhën e “tjetrit”?*

Para fillimit të aktivitetit të quajtur “Fjalori i Vitit të Ri”, mësimitdhënësi përpunon kartela me vizatime në të cilat janë paraqitur: Babagyshi, dordoleci dhe bredhi (fotoja 5). Secili nxënës në klasë duhet të marrë një komplet nga të tre kartelat. Gjithashtu, mësimitdhënësi, paraprakisht, duhet që të mësojë se si emërohen gjërat të paraqitura në kartelat, në të gjitha gjuhët e përfaqësuara në grup (tabela 1). Në fillim të aktivitetit, të gjithë nxënësit, qëndrojnë në rreth dhe hapet bisedë për ardhjen e Vitit të Ri. Pastaj, secili nxënës, merr nga një komplet nga të gjitha tre kartelat. Së pari, mësimitdhënësi tregon se si quhet secila gjë që është vizatuar në kartelat, në të gjitha gjuhët e përfaqësuara në grup. Nxënësit e ngrenë lartë kartelën përkatëse, duke përsëritur fjalën e thënë në dy ose më tepër gjuhë. Pasi kjo të ushtrohet, shkohet më tej, tashmë vetëm në një rreth ose në gjuhën e tjetrit do të thuhet emri i secilës gjë në kartelë, ndërsa secili nxënës do të duhet shpejt ta mbajë lartë kartelën përkatëse. Kjo përsëritet disa herë, për secilën kartelë. Para kësaj, mësimitdhënësi duhet të mbajë llogari që emrat e gjërave të shfaqura nga kartelat të theksohen barabarësisht në të gjitha gjuhët e përfaqësuara në grup.



Fotoja 5 – Kartelat me vizatime

NË GJUHËN MAQEDONASE	NË GJUHËN SHQIPE	NË GJUHËN TURKE	NË GJUHËN ROME
ДЕДО МРАЗ	BABADIMRI	NOEL BABA	PAHO PAPO
ЧЕШКО	DORDOLEC	KARDAN ADAM	IVJALO
ЕЛКА	BREDH	NOEL AĞACI	NEVE BERSHESKORO KASHT

### Ushtrimi 3

*Si mund mësime të zhvillojë të nxënësit vetëdije mbi ngjashmëritë dhe dallimet për zakonet tradicionale të kulturave?*

Nxënësit ndahen në katër grupe homogjene etnike. Secili grup merr për detyrë që të diskutojë mbi zakonet gjatë dasmave në komunitetin e tij etnik. Pastaj, nxënësit, nga secili grup, zgjedhin nga një zakon dasme për ta aktruar përpara nxënësve të grupit tjetër. Në fund, pasi që të gjithë grupet t'i kenë aktruar zakonet, mësime të nxënësit diskutim mes nxënësve, gjatë të cilit, i jep secilit grup të drejtën të parashtrojë nga një pyetje për grupet tjera në lidhje me zakonet e dasmave të komunitetit të tyre etnik. Secili grup përpiket që të japë përgjigjen më të mirë të mundshme.

### Ushtrimi 4

*Si mund mësime të zhvillojë të nxënësit një vetëdije për trajtim të barabartë të të gjitha bashkësive etnike brenda shkollës?*

1. Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth dhe ndahen në treshe. Secili nga tre nxënësit, në secilën treshe, tregon nga një gjë që më së tepërmi i pëlqen në shkollë (mund të jetë diçka që nuk e ka shkolla tjetër). Pastaj, nxënësit, nga secila treshe, duhet që të bëjnë marrëveshje dhe bashkërisht të zgjedhin një diçka nga gjërat e thëna më parë për shkollën, si më specifike. Në fund, të gjitha treshet i numërojnë gjërat që më së shumti u pëlqen në shkollë.
2. Nxënësit ndahen në katër grupe. Secili grup merr si detyrë që të punojë në temën: “Shkolla që i respekton të gjithë, pa dallim nga përkatësia etnike, gjuhësore, religjioze ose ndonjë përkatësi tjetër”.

Nxënësit në grupet duhet ta përshkruajnë këtë shkollë në mënyrë të ndryshme:

- ▶ grupi i parë: me vizatim
- ▶ grupi i dytë: me vjershë
- ▶ grupi i tretë: me shkrim/ese
- ▶ grupi i katërt: me pllakat në të cilin janë prezantuar sa më shumë detaje dhe aspekte nga tema e dhënë.

Pas mbarimit të aktivitetit, secili grup, e tregon | prezanton grupeve tjera veprën e vet të përbashkët dhe shpjegon si shkolla e prezantuar i respekton të gjithë, pa dallim përkatësie etnike, religjioze ose ndonjë përkatësie tjetër.

#### Ushtrimi 5

**(Ky ushtrim mund të realizohet si aktivitet mësimor ose jashtë mësimor, me nxënës që mësojnë në një ose më shumë gjuhë).**

*Si mund mësimdhënësi t'u ndihmojë nxënësve në zgjidhjen e situatave të konfliktit ndëretnik në klasë?*

Nxënësit vendosen në një mësonjëtorë me kompjuterë. Mësimdhënësi i informon se do të shikojnë një film të shkurtër të animuar, për të cilin do të diskutojnë më pas. Me klikim në nyjën:

[http://www.youtube.com/watch?v=b\\_fl2CihXP8&list=UUdHXb62Cuj24S9VtGtQCCZg](http://www.youtube.com/watch?v=b_fl2CihXP8&list=UUdHXb62Cuj24S9VtGtQCCZg) do të startojë filmi i shkurtër i animuar “Konflikti” nga Gari Bardin. Pasi ta shikojnë filmin mësimdhënësi i fton nxënësit që t'i shprehin përshypjet e tyre. Pastaj, iu parashtron disa pyetje në të cilat nxënësit duhet të përpiqen të japin përgjigje:

- ▶ Si ndodhi konflikti në filmin e shfaqur?
- ▶ Mos vallë dëshira për të qenë “mbi” të tjerët mund të ishte shkak i konfliktit?
- ▶ A mundet që “palët e konfrontuara” të pajtohen?
- ▶ Në çfarë mënyre mund ta bëjnë këtë?
- ▶ E çfarë mund të ndodh kur “nuk lëshon pe” as njëra dhe as pala tjetër?

Në fund të diskutimit, mësimdhënësi mundet të bëjë rezymenë e gjithë përgjigjeve të nxënësve me mendimin e shkurtër këshillues: “Mos ua bëjë të tjerëve atë që nuk dëshiron të ta bëjnë ty”.

**PJESA E KATËRT**



# 5. AKTIVITETE PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLË MES NXËNËSVE PREJ BASHKËSISH TË NDRYSHME ETNIKE DHE SHEMBUJ NGA PRAKTIKAT E MIRA NË ZBATIMIN E AKTIVITETEVE PËR INTEGRIM NDËRETNIK

*Ekipi i PINA*  
(Nebojsa Mojsoski, Tulaha Tahir,  
Snezhana Jankullovska, Ana Piskaçeva)

## 5.1. DISA PËRVOJA NGA AKTIVITETET E PËRBASHKËTA ME NXËNËS NË PINA

Fokusi kryesor i PINA është vendosja e mekanizmit në sistemin arsimor publik, i cili mundëson kontakt të drejtpërdrejtë, komunikim aktiv dhe bashkëpunim mes nxënësve nga bashkësi të ndryshme etnike | gjuhësore. Deri në fund të vitit shkollor 2014|2015 aktivitetet e përbashkëta të nxënësve janë realizuar në rreth njëqind shkolla shumëgjuhësore, ndërsa 270 partneritete janë vendosur në 396 shkolla me gjuhë mësimore të ndryshme, të cilat mundësuan të takohen dhe të njihen pjesëmarrësit nga bashkësi të ndryshme etnike, që jetojnë larg njëri - tjetrit.<sup>34</sup> Këto kontakte të drejtpërdrejta mes nxënësve janë strukturuar sistematikisht (përkundër mos organizimit ose spontanisht) nëpërmjet

34 Petrovska V.B., Kenig N. (2014). Raport nga evaluimi i aktiviteteve të realizuara në shkollat e fazës së 2. Shkup: Projekt i USAID për Integrim Ndëretnik në Arsim.

aktiviteteve të organizuara dhe mirë të planifikuara mësimore dhe jashtë mësimore, me qëllim që të mundësohet bashkëveprimi konstruktiv dhe i suksesshëm mes nxënësve, duke ndikuar kështu në zvogëlimin e stereotipeve dhe paragjytimeve kundrejt kulturave të tjera. Partneritetet e vendosura mes dy e më tepër shkollave përfshijnë aktivitete afatshkurtëra, megjithatë disa aktivitete të përbashkëta nxënësish janë zhvilluar disa herë dhe kanë vazhduar më gjatë.

Aktivitetet mësimore, siç janë orët e përbashkëta në lëndë të ndryshme, projekte dhe mësim në natyrë, kryesisht janë realizuar në shkollat shumëgjuhësore, por, gjithashtu, edhe mes shkollave partnere. Edhe pse zbatohen aktivitete mësimore dhe jashtë mësimore, shkollat më shpesh kanë preferuar aktivitetet jashtë mësimore, për shkak se janë më të lehta për organizim. Pavarësisht nga fakti nëse janë orë mësimore ose jashtë mësimore, afatshkurta ose afatgjata, në zbatimin e të gjitha aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve përmbushen këto kritere bazike<sup>35</sup>:

- ▶ përcaktimi i qëllimit të përbashkët, i cili çon drejt produktit konkret final;
- ▶ komunikimi i drejtpërdrejtë nëpërmjet të cilit nxënësit njihen dhe formësojnë raporte ndërpersonale, në vend të raporteve ndërgrupore etnike;
- ▶ bashkëpunim aktiv, përkundër punës paralele në grup të njëjtë;
- ▶ sigurimi i kushteve për shprehje të lirë të nxënësve në gjuhën e tyre amtare.

### **5.1.1. PROCESI I PLANIFIKIMIT TË AKTIVITETEVE TË PËRBASHKËTA TË NXËNËSVE**

Përvoja nga aktivitetet e projekteve të realizuara ka treguar se procesi i planifikimit luan rol madhor në organizimin e suksesshëm të aktiviteteve, që janë përputhshmëri me kriteret për INA. Sipas rezultateve nga vëzhgimin e aktiviteteve të përbashkëta në shkollat që filluan me realizimin e tyre, është vërejtur se planifikimi, në të shumtën e rasteve, fokusohet në përmbajtjen e aktiviteteve dhe jo në procesin e implementimit.

Për këtë shkak, sado që të jetë e rëndësishme përmbajtja në përcaktimin e qëllimit në aktivitetin e përbashkët të nxënësve, procesi i zbatimit të qëllimit dhe produktit

<sup>35</sup> Negrievska F., Petrovska V.B., Ballazhi S., (2012). *Aktivitete të përbashkëta me grupe të nxënësve me përbërje të përzier etnike / gjuhësore. Doracak për mësimdhënës. Shkup: Projekt i USAID për Integrim Ndëretnik në Arsim.*

konkret të nxënësve duhet të jetë fokusi parësor dhe faktori kryesor në sigurimin e rezultateve të qëndrueshme, që çojnë drejt qëndrimeve të ndryshuara dhe reduktimin e paragjytimeve dhe stereotipeve të fëmijët. Plani për punë të detyrave grupore duhet të mendohet mirë që të shmangët dominimi i punës individuale, gjatë së cilës nxënësit do të punonin paralelisht, e në fund t'i bashkojnë pjesët e përpunuara në produktin përfundimtar.

#### **PRAKTIKAT QË DUHET TË SHMANGEN:**

- ☑ Planifikimi fokusohet kryesisht te përmbajtja;
- ☑ Planifikimi nuk i merr parasysh mundësitë për ndërveprim;
- ☑ Mësimdhënësit – fasilitatorë paraprakisht nuk planifikojnë që t'i ndajnë instruksionet bashkërisht me nxënësit që flasin gjuhë të ndryshme;
- ☑ Grupet e formuara të nxënësve janë të pa ekuilibruar në përfaqësimin në bazë të etnitetit;
- ☑ Metoda e ndarjes së nxënësve në grupe të vogla etnike të përziera nuk është planifikuar paraprakisht;
- ☑ Aktivitetet e planifikuara i theksojnë karakteristikat e një grupi etnik, që çon në etnocentrizëm.

Kjo dukuri ndodh shpesh në aktivitetet e përbashkëta shkollore të nxënësve, kur secili grup nxënësish e përgatit pjesën e vet në gjuhën e tij mësimore dhe në fund të aktiviteteve takohet për përgatitjen e prezantimit përfundimtar. Shpesh ndodh, duke punuar në grupe të vogla në një detyrë konkrete, p.sh. duke përgatitur poster ose strip, secili nxënës ta ngjyros pjesën e tij pa asnjëfarë bashkëpunimi dhe koordinimi me pjesëtarët e tjerë të grupit.

Komunikimi dhe bashkëpunimi janë të një rëndësie të veçantë në aktivitetet e përbashkëta të nxënësve dhe, për këtë shkak, procesi i planifikimit duhet që ta ketë parësore përqendrimin në kuptimin e mësimin dhe organizimin e aktiviteteve dhe detyrave në atë mënyrë që mundëson nivel më të lartë të ndërveprimit të drejtpërdrejtë.

Përvoja nga projekti ka treguar se aktivitetet që japin rezultate më të mira, në raport me ndërveprimin aktiv dhe vendosjen e relacioneve më të thella mes nxënësve, janë me përmbajtje që ofrojnë hapësirë më të madhe për kreativitet dhe pavarësi në sjelljen e vendimeve gjatë kohës sa është duke punuar grupi. Këtu përfshihet edhe fasilizimi më efektiv i mësimdhënësve.

Kjo më tepër ka të bëjë me video produksionin<sup>36</sup> dhe të shfaqjeve teatrore<sup>37</sup>, aktivitete këto që rezultojnë me shkallë të lartë motivimi, interesimi dhe përfshirjeje së nxënësve. Aktivitetet sportive<sup>38</sup> janë treguar veçanërisht të suksesshme me demonstrimin e entuziazmit të madh për punë ekipore dhe krijimin e atmosferës pozitive. Theksimi i mëtutjeshëm i efektit arrihet kur aktivitetet sportive zbatohen në afat të gjatë, me më shumë aktivitete të organizuara për grupin e njëjtë të nxënësve.

Në planifikim mësimdhënësit duhet patjetër ta kenë parasysh natyrën shumëgjuhësore të aktivitetit, përkrah së cilit, për secilin grup të nxënësve, nga një gjuhë e caktuar mësimore, patjetër duhet që të sigurohet mësimdhënës - fasilitator, i cili e flet gjuhën e një grupi konkret gjuhësor të nxënësve. Është me rëndësi të theksohet se gjatë përdorimit dhe përkthimit në gjuhë të ndryshme nga mësimdhënësit - fasilitator nuk duhet të tregohet përkushtim dhe vëmendje më e madhe vetëm ndaj gjuhës së

36 <http://goo.gl/HzZ8tE>

37 <http://pmio.mk/news/western-balkans-love-story-shakespeare-at-the-door/>

38 <http://pmio.mk/archive-capacity-building/a-smile-is-a-smile-in-any-language/>

shumicës, sepse një qëndrim i këtillë i marginalizon nxënësit në grupin që nuk e flasin gjuhën e shumicës. Procesi korrekt i planifikimit duhet të sigurojë që mësimdhënësit - fasilitator t'u japin instruksione nxënësve nëpërmjet parafrazimit të ndërsjellë gjatë komunikimit dhe jo të përkthehet fjalëpërfjalshëm. Në këtë mënyrë fasilitatorët demonstrojnë modelin e njëjtësisë dhe bashkëpunimit, i cili do të kopjohet dhe zbatohet nga nxënësit.

#### PRAKTIKA POZITIVE:

- Fokusi kryesor është drejtuar kah procesi;
- Detyrat e përzgjedhura sigurojnë interaksion maksimal;
- Përmeshja e detyrave kërkon nivel të lartë të kreativitetit;
- Mësimdhënësit - fasilitator paraprakisht sigurojnë instruksione në dy gjuhë;
- Përfaqësim i ekuilibruar i nxënësve në grup.

Një aspekt tjetër që duhet të merret parasysh në procesin e planifikimit është përzgjedhja e nxënësve për çdo aktivitet konkret. Rekomandohet të vendoset baraspeshë në raport me përkatësinë etnike dhe gjinore mes nxënësve në grup. Përfaqësimi relativisht i ulët i një bashkësie etnike

është shumë i papëlqyeshëm, sepse është e mundur që të nxisë ndjenjë inferioriteti në grupin e nxënësve më pak të përfaqësuar, që i ndalon aktivisht të angazhohen në aktivitete të përbashkëta.

Ndarja e grupit më të madh të nxënësve, i cili i realizon aktivitetet e përbashkëta në grupe më të vogla për punë, në pjesë konkrete tërësia e vendosur si qëllim/detyrë/produkt, duhet gjithashtu të planifikohet me vëmendje. Fasilitatorët duhet që të jenë të sigurt se e kanë planifikuar mirë përbërjen e grupeve më të vogla edhe atë në mënyrë që të jetë siguruar baraspeshë dhe diversitet i tyre, por njëkohësisht, nga ana e nxënësve, të mos perceptohet dhe përjetohet përbërja e planifikuar si një aktivitet artificial.

Prindërit, gjithashtu, kanë rol tepër të rëndësishëm në këtë fazë. Përfshirja e prindërve në planifikimin e aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve siguron interes më të madh dhe përkrahje përgjatë gjithë procesit të zbatimit. Kyçja dhe përkrahja mund të sigurojnë përfshirje në planifikim, fasilitimin e aktiviteteve konkrete, këmbimin e përvojave dhe dijës së tyre profesionale, që do të ishte relevante për detyrat konkrete përgjatë aktiviteteve të përbashkëta

të nxënësve. Ata, gjithashtu, marrin pjesë edhe në sigurimin e përkrahjes ose punës me nxënësit në përgatitjen e produktit final.

#### PRAKTIKA POZITIVE:

- ☑ Gjithë nxënësit bashkëpunojnë aktivisht dhe komunikojnë gjatë kohës sa e përpilojnë detyrën, në një atmosferë të gjallë dhe të gëzuar.
- ☑ Detyra është interesante për nxënësit dhe ata të magjepsur punojnë në përmbushjen e saj.
- ☑ Nxënësit aktivisht dëgjohen dhe respektohen mes veti gjatë gjithë procesit.
- ☑ Gjithë grupi i nxënësve, me entuziazëm, e përgatit prezantimin e produktit.
- ☑ Prezantimi realizohet në të gjitha gjuhët mësimore, me përfshirje të sa më shumë nxënësve.
- ☑ Mësimdhënësit e mbikëqyrin vëmendshëm komunikimin në grup dhe kur duhet nxisin ndërveprim.
- ☑ Mësimdhënësit aktivisht komunikojnë mes veti gjatë kohës së aktiviteteve dhe jashtë klasave, duke dëshmuar model bashkëpunimi.
- ☑ Mësimdhënësit iu ndihmojnë të gjithë nxënësve, pavarësisht nga gjuha mësimore.

### **5.1.2. REALIZIMI I AKTIVITETEVE TË PËRBASHKËTA TË NXËNËSVE**

Siç theksuam më parë, fokusi parësor, në procesin e zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve, është krijimi i produktit nëpërmjet mësimin të përbashkët kooperativ. Përvoja në aktivitetet e projekteve ka treguar se ka rëndësi të veçantë për grupin e nxënësve që produkti të jetë shumë me interes për ta dhe në përputhshmëri me interesin dhe moshën e tyre. Kur nxënësit punojnë për produktin që është me interes (zakonisht një produkt i tillë përfshin procese kreative dhe shfrytëzim të të arriturave të reja teknologjike), grupi ka dëshirë të investojë më tepër energji, bashkëpunon në nivele më të larta dhe ka entuziazëm përgjatë gjithë procesit, që stimulon emocione të forta dhe pozitive. Efektet janë shumë të shprehura kur këto lloje aktiviteteve zbatohen në një periudhë më të gjatë kohore dhe me grup të njëjtë nxënësish. Në këtë rast, raportet mes nxënësve të grupit transformohen në miqësi të sinqerta, që ndikon mbi qëndrimet e nxënësve ndaj etniteteve të tjera. Megjithatë, pavarësisht nga lloji i produktit përfundimtar, procesi nëpërmjet të cilit arrihen rezultatet është fokusi parësor i aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve, që, në

masë të madhe, varet nga aftësia e mësimdhënësit për ta facilituar procesin.

Edhe në suaza të grupeve të vogla, mund të pritët që nxënësit të kenë prirje që më së tepërmi të komunikojnë me bashkënxënësit që tashmë i njohin, nëpërmjet gjuhës së tyre të përbashkët mësimore. Kjo, praktikisht, do të thotë se mes nxënësve nganjëherë krijohen ndarje në grupet më të vogla, me çka edhe krijohet punë paralele mes grupeve. Mësimdhënësit janë përgjegjës për fasilizimin e procesit dhe duhet që të inkurajojnë bashkëveprimin në grup, si dhe të nxisin dinamikën e ndërveprimit, që mundëson diskutimin aktiv dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë anëtarëve të grupit.

Duhet pasur parasysh se nxënësit janë shumë të ndjeshëm në perceptim. Fasilitatorët e aktiviteteve duhet të jenë të vetëdijshëm që sjellja e tyre paraqet model për bashkëpunim, i cili kopjohet prej nxënësit. Gjithashtu, edhe mënyra se si mësimdhënësit sillen me nxënësit, që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore nga gjuha e tyre, ndikon shumë mbi procesin. Në fillimet e realizimit të PINA ishin identifikuar situata në kohën e aktiviteteve kur mësimdhënësit, për shkak të mungesës

paraprake të përvojës, komunikojnë spontanisht dhe iu ndihmojnë vetëm nxënësve të “tyre”, respektivisht nxënësve të të njëjtës bashkësi etnike. Kjo qasje e përforcon ndarjen dhe e thëllon hendekun mes grupeve të ndryshme të nxënësve. Për këtë shkak është e rëndësishme që fasilitatorët të jenë të përkushtuar ndaj të gjithë nxënësve në grup, pavarësisht nga gjuha mësimore që ligjërojnë dhe nga përkatësia e tyre etnike.

Në lidhje me përdorimin e gjuhës mësimore të nxënësve, aktivitetet duhet të mundësojnë që secili nxënës të shprehet në gjuhën e tij amtare, respektivisht në gjuhën e tij mësimore. Përvoja në këtë fushë ka treguar se mundësia që iu jepet nxënësve për t’u ndjerë komod kur shprehen në gjuhën e tyre amtare/mësimore, ndikon mbi aftësinë e tyre që aktivisht të angazhohen në aktivitetin e përbashkët dhe të bashkëpunojnë me nxënësit. Këta nxënës ose mbeten pasiv gjatë rrjedhës së aktiviteteve ose vendosin lidhje me bashkënxënësit që i njohin dhe që flasin të njëjtën gjuhë. Nga ana tjetër, kur aktiviteti i përbashkët është i fasilituar nga mësimdhënësit që i stimulojnë nxënësit, që i ndihmojnë bashkëpjesëmarrësit kur diskutojnë dhe sjellin vendime duke krijuar kështu një atmosferë mirëbesimi dhe

përkrahjeje, që ndikon mbi krijimin varësisë në grup, e cila transformohet në grupin e mbështetur në qëllimin e përbashkët. Aktiviteti i përbashkët është veçanërisht i suksesshëm nëse mësimdhënësi ka përfshirë në të nxënës që flasin në dy ose më tepër gjuhë ose më tepër gjuhë lokale, me çka demonstrojnë model pozitiv para moshatarëve të tyre.

### **5.1.3. PROMOVIMI I AKTIVITETEVE TË PËRBASHKËTA TË REALIZUAR NGA NXËNËSIT**

Promovimi i rezultateve të arriturave dhe produkteve të realizuar është edhe një aspekt i rëndësishëm që i përforcon efektet nga zbatimi i aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve. Përvoja ka treguar se promovimi i aktiviteteve për arsimin e integruar ndëretnik, jo vetëm që stimulon ndjenjën e mëvetësisë dhe krenarinë të nxënësit që marrin pjesë në to, gjithashtu, edhe ka ndikim të fuqishëm mbi bashkësinë e shkollës. Te nxënësit që nuk kanë marrë pjesë në aktivitete të këtilla rritet interesimi dhe entuziazmi për pjesëmarrje në të ardhmen. Promovimi përfshin organizimin e ngjarjeve në shkolla dhe bashkësi lokale, publikim materialesh në web faqet e shkollave dhe komunave, si dhe mbulim medial. Organizimi

i shfaqjeve teatrore, aktiviteteve sportive, forum - teatrove janë forma promovimi që nxisin<sup>39</sup> interes të madh edhe te nxënësit që nuk kanë marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta. Shpërndarja në publik e informacionit për aktivitetet e përbashkëta nxit te nxënësit dhe shkollat tjera dëshirën e pjesëmarrjes në aktivitete të këtilla dhe, njëkohësisht, e rrit interesin e publikut të gjerë dhe nivelin e vetëdijes për arsimin e integruar.

#### **5.1.4. ZBATIMI I VAZHUESHËM I AKTIVITETEVE PËR INTEGRIM NDËRETNIK NË SHKOLLA**

Një ndër qëllimet e promovimit të aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve është stimulimi dhe rritja e pjesëmarrjes së nxënësve dhe mësuesve të tjerë në aktivitete të integrit ndëretnik në shkolla. Procesi i integrit ndëretnik në shkolla do të thotë edhe zbatim i vazhdueshëm i aktiviteteve në të gjitha sferat e jetës shkollore. Zbatimi dhe promovimi i aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve është proces i vazhdueshëm. Procesi i realizimit të aktiviteteve

për INA vazhdimisht i përkrah shkollat edhe nëpërmjet të mbajtjes së takimeve mentoriale, vëzhgimit dhe sesioneve për përgjigje kthyesë rreth aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve, me synim avancimin e kompetencave të mësimit për zbatimin e aktiviteteve për integrit ndëretnik nëpër shkolla.

Përnxitje plotësuese të shkollave duhet të sigurohen përkrahje me grante të vogla për zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve, sepse një nga sfidat kryesore me të cilën përballen shkollat në organizimin e aktiviteteve për integrit ndëretnik në arsim është mungesa e financave. Kjo në veçanti vlen për shkollat njëgjuesore, të cilat kanë mundësi minimale për vendosje kontaktesh me nxënësit e përkatësive të ndryshme etnike, njëkohësisht u duhen shumë shpenzime për organizimin e takimeve (pjesa më e madhe e shpenzimeve dedikohet për transport). Prandaj sigurimi i fondit të përhershëm për aktivitete të përbashkëta të nxënësve është i një rëndësie madhore për qëndrueshmërinë e integrit ndëretnik në sistemin arsimor.

Arritja me sukses e qëllimeve të përcaktuara në aktivitetet e përbashkëta të nxënësve është

<sup>39</sup> <http://pmio.mk/archive-community-outreach/forum-theatre-debate-and-workshop-in-stip/>

tregues se fëmijët dhe të rinjtë mund të punojnë bashkërisht dhe të socializohen, të vendosin ndërvarësi pozitive, pavarësisht nga fakti nëse i përkasin një bashkësie etnike ose një tjetre dhe pavarësisht nga gjuha që e flasin. Kreativiteti, arti dhe hulumtimi i përbashkët gjithnjë paraqesin sfidë për një të ri, i cili, në rrjedhë të aktiviteteve të përbashkëta, hapet, i shpreh nevojat e tij, interesat, i realizon dijet dhe i lartëson shkathtësitë sociale. Këto aktivitete të përbashkëta krijojnë mundësinë për njohjen e asaj që është e mirë, si dhe mirëkuptimin se dallimet nuk janë shkas për barriera, por janë përparësi për vendosjen e miqësive të përhershme dhe të sinqerta.

## 5.2. SHEMBUJ PËR PRAKTIKA TË SUKSESSHME NË ZBATIMIN E AKTIVITETEVE PËR INTEGRIM NDËRETNIK NË SHKOLLËN FILLORE “SANDE SHTERJOVSKI”- KËRÇOVË

*Dr.* **Lulzim Mehmedi**

Praktikat e mira nga zbatimi i aktiviteteve në PIMA, në shkollën trigjuhësore “Sande Shterjovski”,

në Kërçovë, që njëherësh është edhe shkollë model në projekt, janë përshkruar në tekstin pasues. Materiali është përgatitur nga drejtori Lulzim Mehmeti, bashkë me SIT-in e shkollës.

### 5.2.1. AKTIVITETE PËR PJESËMARRJE DEMOKRATIKE TË NXËNËSVE

**Qëllimi i aktivitetit:** Qëllimi kryesor i aktiviteteve për pjesëmarrje demokratike është përfshirja e nxënësve në procedurat demokratike të vendimmarrjes, si pjesë e funksionimit të shkollës si bashkësi e organizuar me rregullat e saj, si dhe me detyrat e përgjegjësitë. Kjo do të thotë identifikim i nxënësve me modelin demokratik të vendimmarrjes dhe jetesës në shkollë.

**Aktivitete sipas temave:** Temë bazike rreth së cilës zhvillohen të gjitha aktivitetet nga pjesëmarrja demokratike e nxënësve është të praktikuarit e modelit demokratik të vendimmarrjes dhe punës së nxënësve në një mjedis të integruar ndëretnik.

**Përgatitja dhe realizimi i aktiviteteve:** Pjesëmarrja demokratike e nxënësve është model me të cilin ata ushtrojnë dhe praktikojnë demokracinë që nga mosha më e hershme. Nxënësit

në shkollë përgatiten bashkërisht për mësimin e parimeve bazike të demokracisë (përgjegjësia, drejtësia, autoriteti dhe privatësia). Ky model është i mirë dhe një praktikë adekuate, veçanërisht për shkollat në të cilat realizohet mësimi në më tepër gjuhë, sepse është treguar si i suksesshëm në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve në grupet e përziera etnike/gjuhësore. Me futjen e rregullave për përbërje të ekuilibruar të nxënësve në bazë etnike/gjuhësore e të gjinisë dhe zbatimin e të njëjtave rregulla gjatë zgjedhjes së udhëheqësish së nxënësve dhe organeve, praktikohet përfaqësimi i drejtë dhe pjesëmarrja e të gjithë nxënësve. Në këtë mënyrë, ata krijojnë Bashkësitë e klasave (BK) dhe zgjedhin organin më të lartë, respektivisht Kryesinë e Bashkësisë së shkollës (KBSH).

Në shkollë, tashmë tre vite, praktikohet zgjedhja demokratike e organeve të përkohshme dhe të përhershme në BK dhe KBSH dhe në këto organe, secili individ, ka detyrat dhe përgjegjësitë e veta. Këto organe i koordinojnë udhëheqësit dhe koordinatorët e klasave dhe i realizojnë aktivitetet e tyre. Udhëheqësit e klasave punojnë me BK-ës, ndërsa koordinatorët me KBSH-ës e koordinojnë punën e BK-së. Organi më i lartë në KBSH

përpilon programin e vetë nëpërmjet trajnimeve dhe më pas bashkë me koordinatorët realizohet programi. Përfaqësuesit e tyre, si organ më i lartë i nxënësve, janë të përfshirë edhe në organin më të lartë të shkollës - Këshillin e arsimtarëve, ku edhe i shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre.

**Produktet:** Mënyra për t'iu drejtuar me shkrim të gjithë organeve të shkollës, tabela për shpallje, anketat, prezantimet, aksione me qëllime të ndryshme, aktivitetet sportive, ahengjet etj. Këto praktika të suksesshme janë të përshtatshme për përfaqësimin e çdo lloji ndryshimi që iu intereson nxënësve. Me produktet ata mësojnë se si të dëgjohen kërkesat dhe mendimet e tyre për përmirësimin e mjedisit për mësim.

## PËRFITIMET

- ▶ Të praktikuarit e zgjedhjeve demokratike në organet e nxënësve;
- ▶ Ekuilibri në përbërjen etnike dhe gjinore, i cili është më i rëndësishëm për funksionimin e të gjitha organeve;
- ▶ Interesi i rritur të nxënësit për zgjidhjen e dilemave dhe problemeve;

- ▶ Vetëdijesimi i mësimdhënësve për nevojat e organeve të nxënësve të jenë të zgjedhura;
- ▶ Të praktikuarit e komunikimit me shkrim;
- ▶ Respektimi mendimeve të nxënësve;
- ▶ Zhvillimi i shkathtësive për komunikim të mirë dhe parashtrimi i pritjeve reale;
- ▶ Njohja, shoqërimi, pakësimi i stereotipeve dhe paragjytimeve, respektimi i ndërsjellë i dallimeve dhe ngjashmërive.

#### SFIDAT

- ▶ Të praktikuarit e demokracisë të nxënësit kërkon kohë dhe motivim;
- ▶ Kufizimet kohore dhe hapësinore;
- ▶ Puna për rritjen e vetëbesimit të nxënësit.

Participimi demokratik i nxënësve është një praktikë e mirë për zgjidhjen e problemeve ose nevojave për t'u organizuar të gjitha aktivitetet në shkollë, veçanërisht në mjedisin e integruar multi-etnik.

#### 5.2.2. PUNËTORI MULTIKULTURORE

Punëtoritë multikulturore janë realizuar me shumë grupe nxënësish

grupmoshash të ndryshme. Një seri punëtorish multikulturore kanë përfshirë 24 nxënës nga grupe të të rriturve sipas periudhave zhvillimore, të përfshira në mënyrë të ekuilibruar në aspektin etnik dhe gjinor, për të ndjekur mësimin në gjuhën maqedonase, shqipe dhe turke. Takimet me nxënësit janë mbajtur njëherë në javë, në një termin të përcaktuar bashkërisht, me kohëzgjatje një gjysmëvjetor.

Aktivitetet e punëtorive multikulturore janë organizuar në bazë të temave dhe kryesisht janë zhvilluar sipas kësaj renditje dhe këtyre temave:

- ▶ Punëtori hyrës (punëtori: njohja e ndërsjellë, ne jemi grupi, rregullat e grupit);
- ▶ Punëtori multikulturore (punëtori për njohjen e ngjashmërive të të dy bashkësive etnike, si p.sh: Si thuhet e zezë në gjuhën e tjetrit?; Festojmë ditëlindjen; Zakonet gjatë lindjes së foshnjës; Muzikë, instrumente dhe valle; Më thuaj si të bëj? etj.);
- ▶ Punëtori të performuara dhe në bazë të projektit (punëtori në të cilën nxënësit bashkëpunojnë në përpunimin e produktit final - pllakat, planifikim dhe realizim i ekspozitës, ku do t'i prezantojnë veprat e tyre para prindërve dhe bashkësisë).

Punëtoritë i organizuam dhe realizuam sipas orientimeve të dhëna në doracakun për punëtorë multikulturore për shkollat fillore<sup>40</sup>. Aktivitetet në secilën punëtorë multikulturore u pranuan nga ana e nxënësve me entuziazëm dhe dëshirë për bashkëpunim, me çka u krijua një atmosferë e gjallë, e rehatshme dhe gazmore për punë. Përfitimet nga ky lloj punëtorie ishin të dukshme që nga fillimi. Komunikimi mes nxënësve, gjatë kohës së punëtorive, menjëherë u bart edhe në korridoret e shkollës, jashtë shkollës dhe në familje. Dinamika e punëve, gjatë kohës së aktiviteteve kryesore, u përcaktua nga vetë nxënësit dhe ishte kënaqësi të jesh dëshmitar i bashkëpunimit të nxënësve kur kanë një qëllim të përbashkët para vetes. Edhe pse të gjithë u mahnitën në aktivitetet hyrëse dhe përmblylëse, me të njëjtën energji u përfshinë edhe në aktivitetet kryesore dhe refleksionin në fund të çdo punëtorie.

Nxënësit diskutuan hapur për temat e dhëna, sinqerisht i ndanë ndjenjat pozitive dhe hapur biseduan për stereotipet dhe paragjykimet, me të cilat ishin ballafaquar deri në atë kohë.

<sup>40</sup> Dodeva R., Ballazhi S., Alushevski S., Negrievska F., Doracak për punëtorë multikulturore për shkollat fillore (botim i shkurtuar) USAID, Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar, Shkup.

Nga punëtoritë dolën shumë ide dhe propozime konstruktive, ndërsa idetë dhe ndjenjat u mishëruan në një numër të madh punimesh, që pas përfundimit u ekspozuan para prindërve.

Prindërit, në ekspozitën përmblylëse, kishin mundësi t'i shohin me vëmendje produktet e punuara të nxënësve, të bisedojnë me prindërit e tjerë dhe ta ndjejnë frymën ekipore të nxënësve. Produktet e aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve përherë i stolisnin muret e hapësirave, si dëshmi e miqësisë edukative, barabarësisë dhe bashkëpunimit mes nxënësve të gjuhëve të ndryshme mësimore, që doli nga realizimi i punëtorive multikulturore.

#### **Disa produkte të realizuara nga punëtoritë multikulturore:**

- ▶ Kodi i sjelljes (sjellja e rregullave të përbashkëta nga grupi);
- ▶ Vizatime dhe vjersha kushtuar shkollës;
- ▶ Libër bisedash në të dy gjuhët e bashkësive etnike;
- ▶ Pllakate që prezantojnë punëtoritë multikulturore;
- ▶ Ftesa për ekspozitën përmblylëse;
- ▶ Ekspozitë përmblylëse për prindërit dhe bashkësinë lokale.

### Përfitimet:

- ▶ Nxënësit njihen mes veti dhe respektohen;
- ▶ Bashkëpunimi mes anëtarëve të grupit dhe sjellja e vendimeve për dobinë e të gjithë anëtarëve të grupit;
- ▶ Zhvillimi i vetëdijes për ekzistencën e ngjashmërive dhe dallimeve mes kulturës së tyre dhe kulturës së të tjerëve;
- ▶ Zhvillimi i ndjeshmërisë për përkatësi ndaj grupit, pavarësisht nga përkatësia e bashkësisë konkrete etnike;
- ▶ Mësimi i fjalëve në gjuhën e tjetrit;
- ▶ Nxënësit zhvillojnë ndjenjën e përkatësisë së grupit, pavarësisht nga përkatësia bashkësisë konkrete etnike;
- ▶ Nxitja e kreativitetit të nxënësve gjatë përpunimit të përbashkët të produktit kolektiv, të dobishëm për të gjithë, i cili e përfaqëson bashkësinë më të gjerë;
- ▶ Lëvizja e nxënësve vazhdon edhe pas punëtorisë multikulturore, jashtë shkollës;
- ▶ Dhe shumë të tjera.

### Sfidat:

Sfidat gjatë planifikimit dhe realizimit të punëtorive multikulturore, kryesisht kanë të bëjë me sigurimin e një hapësirë të përshtatshme dhe përcaktim të kohës së mbajtjes, e cila u përshtatet gjithë nxënësve, duke pasur parasysh punën në dy turne dhe në tre ndërtesat shkollore.

Gjatë formimit të grupeve si sfida më e madhe ishte të sigurohej një numër i mjaftueshëm nxënësish të gjuhës mësimore maqedonase, për shkak të numrit të vogël të nxënësve që mësojnë në këtë gjuhë mësimore. Kjo paraqet një barrierë që na krijon vështirësi gjatë respektimit të rregullit për ekuilibër (etnik dhe gjinor).

Sfidë e madhe është se si të ruhet raporti pozitiv i vendosur mes nxënësve, që mbisundon gjatë kohës së këtyre punëtorive, si dhe pas mbarimit të tyre. Kjo, në veçanti, ka të bëjë me ndikimin e familjes dhe mediave mbi ndërtimin e qëndrimeve të mëtutjeshme dhe mbijetesës së paragjykimeve.

Në tekstin e mëposhtëm pason përshkrimi praktik i realizimit të punëtorive multikulturore me grupmosha të ndryshme, në suaza të INA, në shkollën “Sande Shterjoski”-Kërçovë:

## PUNËTORI MULTIKULTURORE ME NXËNËSIT E GRUPMOSHËS SË PARË (KLASA II DHE III)

**Gjuha:** maqedonase dhe turke.

**Pjesëmarrës:** 12 nxënës me mësim në gjuhën shqipe dhe 12 nxënës me mësim në gjuhën turke.

**Qëllimi:** Njohja e nxënësve, respektimi i ndërsjellë, zhvillimi i bashkëpunimit mes nxënësve nga të dy grupet etnike/gjuhësore dhe socializimi.

**Tema e punëtorive:** Ne dhe miqtë tanë.

**Aktivite:** Punëtoritë janë përgatitur paraprakisht nga ana e mësimeve - realizatorëve, duke kërkuar paraprakisht dhe materialet adekuate. Aktivitetet në punëtorinë multikulturore realizohen, më shpesh, të premtën edhe atë para orëve. Pas realizimit të punëtorive, mësimeve-realizator, bashkë me nxënësit që mësojnë në ndërtesën e re në f. Pashinë, i bëjnë me transportin e vetë. Në këtë mënyrë, shmanget vonesa e nxënësve në mësim, sepse në shkollën tonë mësimi klasor gjithnjë fillon në orën 14:00. Nëse nuk ka kushte për realizimin e punëtorisë multikulturore të premtën, atëherë caktohet për të mërkurën. Gjatë muajit dhjetor të vitit 2012 deri më maj të vitit 2013 janë realizuar gjithsej 15 punëtori të karakterit multikulturore dhe të performuar, përmes të cilave janë vendosur, ndërtuar dhe kultivuar miqësi të pashkëputura mes nxënësve.

### PRODUKTE

- ➔ posterë dhe vizatime,
- ➔ maska të punuara,
- ➔ shënues fletësh në libër,
- ➔ stoli dhe
- ➔ gjëra për ruajtjen e pajisjeve.

Punimet janë ekspozuar në muret e shkollës dhe në disa klasë, në rafte.

---

## PËRFITIMET

---

- ➔ Avancim i socializimit;
  - ➔ Tejkalim i disa stereotipeve, që nxënësit i përvetësojnë në shtëpitë e tyre;
  - ➔ Identifikim i ngjashmërive, pavarësisht nga përkatësia etnike/fetare;
  - ➔ Mësim i vjershave në gjuhën e tjetrit.
-

## PUNËTORI MULTIKULTURORE ME NXËNËSIT E GRUPMOSHËS SË TRETË (VI DHE VII)

*Gjuha:* maqedonase dhe shqipe

*Pjesëmarrës:* 12 nxënës nga gjuha mësimore maqedonase dhe 12 nga gjuha shqipe

### Qëllimet

- ▶ Njohja e ndërsjellë, vendosja dhe mirëmbajtja e komunikimit me pjesëtarë të bashkësive tjera etnike;
- ▶ Njohja e kulturës së bashkësive të ndryshme etnike dhe zhvillimi i respektit ndaj saj;
- ▶ Zhvillim i vetëdijes mbi ngjashmëritë dhe dallimet të karakteristikave të kulturës tjetër;
- ▶ Nxitje e bashkëpunimit dhe sjellja e vendimeve grupore me interes të përbashkët;
- ▶ Zhvillimi i vetëdijes për trajtim të barabartë të bashkësive të ndryshme etnike.

### Aktivitete në bazë të temave

- ▶ Punëtori për njohje të ndërsjellë;
- ▶ Punëtori për njohjen e ngjashmërive dhe dallimeve të të dy bashkësive etnike;
- ▶ Punëtori të performuara dhe në bazë të projektit në të cilat nxënësit bashkëpunojnë në përpunimin e produktit përfundimtar, pllakate, planifikim dhe realizim ekspozitash, në të cilat do t'i prezantojnë veprat e tyre para prindërve dhe bashkësisë.

### Përgatitja dhe realizimi i punëtorive

Pas trajnimit për drejtimin dygjuhësor të punëtorive, dy mësimdhënësit – realizator, bashkërisht, përgatiten për realizimin e tyre. Përgatitjet përfshijnë planifikimin gjatë punëtorisë dhe aktiviteteve, përgatitjen e materialeve të nevojshme, sigurimin e hapësirës adekuate dhe krijimin e orarit.

Në punëtori marrin pjesë 24 nxënës, të përfshirë në mënyrë të ekuilibruar në aspektin etnik dhe gjinor, ndërsa punëtoritë realizohen njëherë gjatë javës, në një kohë paraprakisht të caktuar (e premtë), në të dy gjuhët mësimore: maqedonase dhe shqipe.

Aktivitetet e planifikuara në secilën prej punëtorive multikulturore ishin pranuar nga ana e nxënësve me entuziazëm dhe dëshirë për bashkëpunim. Kështu qe krijuar një atmosferë gazmore dhe e këndshme.

Dinamikën e punës, gjatë kohës së aktiviteteve kryesore, e përcaktojnë vetë nxënësit dhe është kënaqësi të dëshmohet se sa nxënësit bashkëpunojnë atëherë kur kanë vendosur bashkërisht të punojnë për një qëllim.

Edhe pse të gjithë u kënaqen në aktivitetet hyrëse dhe përmblylëse, me energji të njëjtë dhe me përkushtim u përfshin edhe në aktivitetet kryesore, duke reflektuar në secilën punëtori. Nxënësit diskutojnë hapur mbi temat e përzgjedhura dhe i shpërfaqin me sinqeritet ndjenjat e tyre. Flasin hapur për stereotipet dhe paragjykimet me të cilat janë përballur.

#### PRODUKTI:

- ➔ Sjellje e përbashkët e rregullave të grupit;
- ➔ Pllakate që prezantojnë punëtoritë multikulturore;
- ➔ Ftesa për ekspozitën përmblylëse,
- ➔ Ekspozitë përmblylëse për prindërit dhe bashkësinë.

#### PËRFITIMET

- ➔ Njohja e ndërsjellë e nxënësve;
- ➔ Zhvillim i ndjenjës së përkatësisë ndaj grupit, pavarësisht nga përkatësia konkrete e bashkësisë etnike;
- ➔ Bashkëpunim ndërmjet anëtarëve të grupit dhe sjellja e vendimeve të përbashkëta në të mirë të të gjithë anëtarëve të grupit në kohën e punëtorive të performuara dhe në bazë të projektit;
- ➔ Zhvillimi i vetëdijes për ekzistimin e ngjashmërive dhe dallimeve mes kulturës së tyre dhe kulturës së tjetrit;
- ➔ Mësimi i fjalëve në gjuhën e tjetrit;
- ➔ Shoqërimi mes nxënësve vazhdon edhe pas punëtorisë multikulturore edhe jashtë shkollës.

## PUNËTORI MULTIKULTURORE ME NXËNËS TË GRUPMOSHËS SË KATËRT (KLASA VIII DHE IX)

*Gjuha:* maqedonase dhe shqipe.

*Pjesëmarrës:* 12 nxënës të gjuhës mësimore maqedonase dhe 12 të gjuhës shqipe.

**Qëllimet:** Njohje e ndërsjellë, stimulim i pranimit dhe respektimit të dallimeve, njohje me zakonet e kulturës së tjetrit, nxitja e kreativitetit të nxënësve, përpunimi i përbashkët i produktit kolektiv, i dobishëm për të gjithë.

### Aktivitete në bazë të temës

- ▶ Punëtori hyrëse (punëtori për njohjen e anëtarëve të grupit);
- ▶ Punëtori multikulturore (punëtori për të njohur ngjashmëritë dhe dallimet në zakonet e të dy bashkësive etnike);
- ▶ Punëtori të performuara (punëtori në të cilat përpilohet libërth bisedimesh dhe diploma)

### Përgatitja dhe realizimi i punëtorisë

Në fillim, formohet grupi prej 24 nxënësve, i ekuilibruar në aspektin etnik dhe gjinor. Nxënësit sjellin deklaratë me shkrim nga prindërit se pajtohen që fëmijët e tyre të marrin pjesë në punëtori shumëkulturore. Punëtoritë multikulturore mbahen njëherë në javë.

### PRODUKTI

- ➔ Kodi i sjelljes (rregullat e grupit);
- ➔ Vizatime dhe vjersha kushtuar shkollës;
- ➔ Libër dore në të dy gjuhët e bashkësive etnike.

## PËRFITIMET

- ➔ Nxënësit njihen mes veti;
- ➔ Nxënësit krijojnë ndjenjë të përkatësisë ndaj grupit, pavarësisht nga përkatësia e bashkësisë konkrete etnike;
- ➔ Zhvillim i vetëdijes për ekzistimin e ngjashmërive dhe dallimeve mes kulturës së tyre dhe kulturës së tjetrit;
- ➔ Ndërveprim dinamik mes anëtarëve të grupit dhe mësim i fjalëve nga gjuha e tjetrit; Stimulim i kreativitetit të nxënësit nëpërmjet përpunimit të përbashkët të produktit kolektiv, të dobishëm për të gjithë, të cilin e prezantojnë para bashkësisë më të gjerë;
- ➔ Shoqërimi mes nxënësve vazhdon edhe pas punëtorisë multikulturorë.

### 5.2.3. SEKSIONET

Modeli ideal për organizimin dhe realizimin e seksionit të përbashkët, me anëtarë të “përzier” etnik/gjuhësor të grupit pjesëmarrës, del nga postulati i kontakt hipotezës të Olportit, sipas së cilës, duhet të kihet parasysh me sa vijon:

- ▶ marrin pjesë numër i ekuilibruar pjesëmarrësish prej bashkësisë të ndryshme gjuhësore/etnike.
- ▶ seksionin e udhëheqin mësimdhënës nga secila gjuhë e përfaqësuar mësimore, mund të marrin pjesë edhe prindërit.
- ▶ shfrytëzohen barabarësisht të gjitha gjuhët e përfaqësuar mësimore, sa më tepër që të jetë e mundur.

- ▶ mbahen takime të rregullta në kohëzgjatje 1-1, 5 orë, një herë në javë, më së paku gjatë një gjysmëvjetori.
- ▶ temën/aktivitetin e zgjedhin bashkërisht nxënësit e të gjitha bashkësive gjuhësore/etnike që përfaqësohen.
- ▶ punohet në grupe të vogla dhe të “përziera”.
- ▶ punohet në atmosferë bashkëpunuese (gara është e mundshme vetëm ndërmjet grupeve të “përziera”).<sup>41</sup>

<sup>41</sup> Projekt për integrimin ndëretnik në arsim, Material pune: Integrimi ndëretnik në arsim: Punëtori ekipore për integrim shkollor, Qershor 2013

Nga ana e nxënësve, të përfshirë në aktivitetet e projektit, ofrohen propozime për formimin e seksioneve, pastaj votohet dhe bëhet rangimi për t'u bërë zgjedhja përfundimtare e seksionit.

Në vazhdim janë dhënë disa shembuj nga seksionet e realizuara në shkolla.

### Nga puna e seksionit për hulumtim dhe gazetari

Përbërja e nxënësve dhe mësimeve është nga 24 nxënës për seksion (me përfaqësim të ekuilibruar etnik dhe gjinor).

Seksionet janë koordinuar nga mësimeve nga të tri gjuhët mësimore (maqedonase, shqipe dhe turke).

Seksionet i realizojnë aktivitetet nëpërmjet mbajtjes së:

- ▶ takimeve - një herë në javë;
- ▶ hulumtimit - i cili është individual dhe grupor, nëpërmjet grumbullimit të materialeve nga burime të ndryshme;
- ▶ bashkëpunimit të ndërsjellë - që zhvillohet nëpërmjet punës ekipore, me këmbim të ngjeshur informacioni.

### SEKSIONI I HULUMTIMIT

Seksioni i hulumtimit kishte punuar në temën: “Transformimi i telefonave përgjatë kohës”. Nxënësit kishin lloje të ndryshme telefonash. Hulumtuan dhe këmben mes veti informacione për secilin lloj aparati telefonik dhe për mundësinë e komunikimit nëpërmjet tyre. Në fund të hulumtimit, të gjithë bashkërisht, përgatiten ekspozitën me shumë telefona.

**Produkti:** Koleksion i telefonave të ndryshëm. Njohuri të fituara mbi rëndësinë e telefonave si teknologji bashkëkohore për komunikim dhe për rrugën e transformimit të tyre, në përputhje me zhvillimin tekniko - teknologjik.

### SEKSIONI I GAZETARISË

**Tema:** Informimi i nxënësve, mësimeve dhe prindërve për të gjitha aktivitetet shkollore. Nxënësit këmben informacione mbi aktivitetet e në shkollë, me fokus të veçantë për aktivitetet e përbashkëta për INA.

**Produkti:** Kënd gazetaresk për informim transparent në të gjitha gjuhët mësimore mbi aktivitetet në shkollë. Një vëmendje e veçantë u kushtohet aktiviteteve të përbashkëta në seksione, si dhe për këmbimin e infor-

macioneve më të zgjeruara në lidhje me festat fetare dhe kombëtare të të gjitha bashkësive etnike që mësojnë në shkollë. Këndi prezanton informacione në të gjitha gjuhët mësimore në shkollë dhe është i hapur për të gjithë nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit. Mësimdhënësit, realizues të aktiviteteve të seksioneve identifikojnë përfitimet dhe sfidat nga puna e seksioneve, gjegjësisht nga aktivitetet e përbashkëta të nxënësve të dedikuara për INA.

### Përfitimet

- ▶ Njohja e ndërsjellë individuale dhe njohja e kulturave të nxënësve, të cilët mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore dhe u përkasin përkatësive të ndryshme etnike;
- ▶ Zhvillim i miqësisë mes nxënësve përkatësish të ndryshme etnike/gjuhësore;
- ▶ Avancim i kreativitetit;
- ▶ Zhvillim i mendimit kritik;
- ▶ Përvetësim i njohurive nga gjuhët e bashkësive të ndryshme etnike.

### Sfidat

- ▶ Zhvillim i aftësive hulumtuese;
- ▶ Zhvillim i aftësive komunikuese mes etniteteve të ndryshme;

- ▶ Njohje me kultura të tjera;
- ▶ Mbathje me njohuri dhe përvoja të reja;
- ▶ Grumbullim, këmbim, selektim, përpunim dhe prezantim i informacioneve.

### SEKSIONI I SPORTIT

Në shkollën tonë, që ka vetëm një sallë sportive, në përputhshmëri me orarin e klasave në shkollë, mësimi në lëndën Edukatës sportive dhe shëndetësore (ESSH) u zhvillua në përbërje të përzier etnike/gjuhësore nxënësish nga klasat në gjuhën shqipe dhe maqedonase. Në fillim ishte sfidë e madhe, në suaza të aktiviteteve të PINA të formohet një ekip sportiv për çiklizëm, me ç'rast nxënësit të realizojnë aktivitete jashtë shkollës.

Çiklizmi si disiplinë u propozua nga vetë nxënësit edhe atë nëpërmjet anketimit për disiplinat e mundshme që do t'i realizonin. Në ekip janë anëtarësuar nga 8 nxënës prej tri gjuhëve mësimore (maqedonase, shqipe, turke), me grupe të ekuilibruara dhe me mësimdhënësit përgjegjës, me përbërje të përzier etnike.

Nxënësit kanë përgatitur plan aksional me kohëzgjatje dhe pjesëmarrës të përcaktuar.

Në takimet e para është prezantuar historia e çiklizmit si sport. Pastaj, në terren, janë ushtruar shkathtësi të caktuara të këtij sporti në një terren të shënuar, që më pas të kalohet në rrugë të caktuara jashtë nga qyteti, në një vendbanim më të afërt dhe në qendrën rekreative - sportive Krushinë. Në fund është realizuar vozitje promovuese në oborrin e shkollës, para gjithë përfaqësuesve të shkollës dhe prindërve.

Njohja dhe shoqërimi i ndërsjellë, shoqërimet pas obligimeve shkollore, zhvillimi i miqësisë mes nxënësve, janë benifitet më të vlefshme, të cilat ata i përjetuan bashkërisht me mësimdhënësit që i koordinuan aktivitetet e këtij ekipi.

Mungesa e rekuizitave të nevojshme për realizimin e aktiviteteve paraqet vështirësi përgjatë funksionimit.

#### **Përbërja e grupit në seksion**

- ▶ Mësimdhënësit - realizatorë (ekip i përzier nga dy mësimdhënës)
- ▶ Grup nxënësish i ekuilibruar në bazë etnike dhe gjinore

**Produkti:** Vozitja përmbyllëse, revyale, e biçikletave në një shteg të shënuar në oborrin e shkollës, me pjesëmarrje të

nxënësve, mësimdhënësve, prindërve, përfaqësuesve të komunës, bashkësisë lokale dhe mediave.

**Funksionimi:** Është formuar grup shumetnik prej 20 nxënësve, i cili organizohet çdo fundjavë, të shtunave dhe organizon marshe të ndryshme me biçikleta, i shoqëruar dhe i përkrahur përherë nga mësimdhënësit.

#### **5.2.4. VIZITA DHE EKSKURSIONE**

##### **Përbërja e grupit**

- ▶ Mësimdhënës - realizatorë (çift i përzier me së paku dy mësimdhënës)
- ▶ Grup nxënësish me përbërje të përzier etnike (maqedonas, turq, romë, shqiptarë)

**Tema:** Vizitë e përbashkët e nxënësve dhe prindërve.

Ndërtimi i qytetit të borës në Bunecë, Mavrovë.

##### **Qëllimi/Produkti:**

- ▶ marsh shumetnik - shoqërim i përbashkët i nxënësve dhe prindërve nga bashkësitë ndryshme etnike, njohja e ndërsjellë dhe përvetësimi i besimit të ndërsjellë.

- ▶ pjesëmarrja e përbashkët në ndërtimin e qytetit të borës në Bunecë, Mavrovë dhe prezantimi i përbashkët i qytetit të borës. Nxënësit ndërtuan kështjellë në qytetin e borës.

**Funksionimi:** Është formuar grupi shumëkulturore prej 20 nxënësve, i ekuilibruar në aspektin etnik dhe gjinor, i cili, në fillim të dhjetorit, menjëherë pas borës së parë, ka organizuar vizitë njëditore me moton “Marshi shumëkulturore deri në lokalitetin Krushinë”.

#### **Përfitimet:**

- ▶ njohja dhe shoqërimi i ndërsjellë sipas aktiviteteve të përcaktuara paraprakisht;
- ▶ avancimi i raporteve ndëretnike dhe përballja e përbashkët me sfidat gjatë kohës së mbajtjes së marshit;
- ▶ avancimi i aftësive për këmbimin e përvojave pozitive dhe negative nga aktivitetet e realizuara.

#### **Sfidat**

Përballja me dukuritë e paparashikuara natyrore, motit të keq dhe situatave të padëshiruara gjatë realizimit të shëtitjeve dhe vizitave.

### **5.2.5. NGJARJE DHE FESTA**

#### **Aktivite të planifikuara sipas planit global vjetor për INA:**

- ▶ e planifikuar në planin aksional - një përvjetor, 8 aktivitete të realizuara:
- ▶ java e fëmijës
- ▶ Kurban Bajrami
- ▶ Pashkët
- ▶ dita e alfabetit shqip
- ▶ dita e arsimit të turqve
- ▶ dita e arsimuesve maqedonas
- ▶ programi i Vitit të Ri
- ▶ dhurimi i librave

**Produkti:** Pjesë të përbashkëta të integruara me numër të njëjtë nxënësish prej të gjitha bashkësive etnike.

#### **Funksionimi**

- ▶ Përgatitja e përbashkët e nxënësve për ngjarje
- ▶ Ekzekutimi i pjesëve në të gjitha gjuhët mësimore
- ▶ Pjesë të integruara
- ▶ Pjesë multikulturore

- ▶ Koordinim i mirë dhe organizim i shfaqjes
- ▶ Kumtesë në të gjitha gjuhët mësimore
- ▶ Ftesa për prindërit, vetëqeverisjen lokale dhe mysafirë të tjerë, si dhe mediat

### Përfitimet

- ▶ Të mësuarit *njëri për tjetrin* nëpërmjet mësimin *njëri nga tjetri*
- ▶ Shoqërim multikulturor dhe realizimi i aktiviteteve të planifikuara
- ▶ Integrimi i pjesëve në shfaqje
- ▶ Njohje më e mirë dhe shoqërimi i nxënësve pas ngjarjeve
- ▶ Tejkalimi i paragjytimeve dhe stereotipeve
- ▶ Përmirësimi i bashkëpunimit me prindërit dhe mediat
- ▶ Lidhja e miqësive mes nxënësve bashkësisht të ndryshme etnike

### Sfidat

- ▶ Koordinimi dhe organizimi i nxënësve nga një shkollë në tjetrën dhe intervali kohor.
- ▶ Përmirësim i komunikimit mes mësimdhënësve - realizatorë dhe SIT-in.

## 5.2.6. BASHKËPUNIMI I MËSIMDHËNËSVE

### BASHKËPUNIMI I AKTIVEVE PROFESIONALË TË MËSIMIT KLASOR

Aktivitetet kanë kuptimin e shoqërimit të mësimdhënësve të lëndëve të përbashkëta në të tri gjuhët mësimore në shkollën tonë. Në secilin aktiv përzgjidhen nga dy mësimdhënës përgjegjës në dy gjuhët mësimore. Mësimdhënësit, në takimet e aktiveve, ndërmarrin aktivitete të ndryshme, shembuj praktikash të ndryshme dhe këmbëjnë përvojat.

Përgatitet plani aksional për punën e aktiveve si një trup e vetme. Qëllimi është integrimi i të gjithë mësimdhënësve, të të tri gjuhëve mësimore, në mësimin klasor dhe të funksionuarit si një trup aktiv në shkollë, me program për punë, që mbindërtohet gjithmonë në Programin vjetor për punën e shkollës dhe gjatë caktimit të mësimdhënësve të përgjegjshëm.

Është gjetur qasje e re në grupimin e mësimdhënësve duke u zgjedhur nga një mësimdhënës i përgjegjshëm në nivel të çdo klase, në të tri gjuhët mësimore, të cilët mbajnë mbledhje në nivel të aktiveve të mësimin klasor, ndërsa pas çdo mbledhjeje, secili nga ta,

me kolegët e tij, e ndanë atë që është punuar në nivel të grupeve të të rriturve. Përgjegjës të aktivitetit gjithmonë kanë qenë nga tre mësime, të të tri gjuhëve mësimore. Ata përgatisin program për punë të aktivitetit, në të cilin, në çdo tre muaj, planifikohen aktivitetet e pjesëmarrjes së mësimeve nga secila përkatësi etnike, për një temë të përbashkët. Varësisht nga aktivitetet, kur bëhet fjalë për realizimin e orës mësimore, secila nga punët e mësimeve, me një numër të caktuar nxënësish nga klasa e tij, ia përshtatën një klase, që më pastaj me to ta realizojë njësinë e parashikuar mësimore. Gjatë orës mësimore komunikimi zhvillohet në të tri gjuhët mësimore, me ndihmën, përkrahjen dhe parafrazimin e mësimeve.

### **Produkte nga bashkëpunimi në aktivitetet profesionale**

Teste të përbashkëta dhe fletë mësimore; planifikime të përbashkëta tematike vjetore për mësim; materiale të përpunuara pune dhe këmbim i materialeve mësimore; plane të përbashkëta dhe realizim i orëve mësimore; vizita të përbashkëta në orë; punëtori të përbashkëta me prindërit me përbërje të përzier etnike; produkte të punuara dhe ekspozimi i tyre në këndin për ekspozim.

**Përpilimi i testit të përbashkët** - një përmbajtje/test në të tri gjuhët mësimore.

**Përpilim i materialit për punë** në të tri gjuhët mësimore që shfrytëzohet si mjet vizual në të gjitha klasat. Pas asaj që është punuar në terren me nxënësit, mësimeve i prezantohen aktivitetet e tyre në mbledhjet e aktiveve si material i shtypur, foto ose si prezantime Power Point dhe i vendosin si material në portofolin e tyre.

Në tekstin e mëposhtëm pason përshkrimi praktik i aktiviteteve nga bashkëpunimi i mësimeve, në suaza të INA, në shkollën “Sande Shterjoski” në Kërçovë:

## SHEMBULL I BASHKËPUNIMIT TË MËSIMDHËNËSVE NGA LËNDA MËSIMORE (GJUHË E HUAJ DHE GJUHË AMTARE)

### Planifikimi i përbashkët i orës së dy mësimdhënësve (nga gjuha mësimore maqedonase dhe shqipe)

**Njësia mësimore:** Kremtimi i festës  
Thanksgiving<sup>42</sup>

**Klasa:** VIII (Klasa e tetë, arsimi tetëv-  
jeçar)

#### Qëllimi për nxënësit:

- ▶ ta përvetësojnë fjalorin, të ndërlidhur me festën e Ditës së falënderimeve (ta njohin dhe ta shqiptojnë drejtë gjithë fjalorin);
- ▶ ta përsosin përdorimin e kohës së mësuar Present Simple (Koha e tashme), Past Simple (Koha e kryer); Present Perfect (Koha e pakryer) në formën aktive dhe pasive;
- ▶ ta zhvillojnë bashkëpunimin dhe të punojnë në mënyrë ekipore në grupe të përziera etnike/gjuhësore;
- ▶ t'i zhvillojnë aftësitë komunikuese (të kuptojnë shprehjet me gojë nga ana e mësimdhënësit dhe nxënësve

të tjera, si dhe të përgjigjen në pyetjet e parashtruara në gjuhën angleze, njëkohësisht ta dëgjojnë dhe përdorin gjuhën shqipe dhe maqedonase);

- ▶ ta zhvillojnë kreativitetin e tyre.

#### Rezultatet e pritura:

Rezultatet patjetër duhet të dalin nga qëllimet dhe patjetër duhet të jenë identike. P.sh. te qëllimet futet tekst “t’i njohin...”, ndërsa te rezultatet “i njohin...”. Është e rëndësishme që ta shqyrtojmë dhe që ta njohim distinkcionin mes qëllimeve dhe rezultateve: Te qëllimet planifikojmë, ndërsa gjatë identifikimit të rezultateve e verifikojmë realizimin e qëllimeve.

#### Nxënësit:

- ▶ e njohin, e shqiptojnë drejtë dhe e definojnë fjalorin për kremtimin e festës,
- ▶ i shqiptojnë dhe i përdorin drejtë format e foljeve në kohët e mësuara (Present Simple, Past Simple, Present Perfect) në formën aktive dhe pasive,
- ▶ bashkëpunojnë mes veti dhe punojnë si ekip në grupe të përziera etnike/gjuhësore,

42 Dita e falemnderimeve, festë në SHBA

- ▶ i shqyrtojnë ngjashmëritë me moshatarët e tyre prej bashkësisht tjera etnike dhe gjuhësh të ndryshme mësimore,
  - ▶ i kuptojnë shprehjet me gojë të mësimdhënësve dhe nxënësve të tjerë dhe përgjigjen në pyetjet e parashtruara në gjuhën angleze si dhe në gjuhën shqipe e maqedonase,
  - ▶ e zhvillojnë kreativitetin e tyre.
- Resurset e nevojshme:** letra flesh me fjalor shprehjesh, kompjuter, fletë të ngjyrosura, listë për vlerësim (për mësimdhënësin/mësimdhënësit)
- Metodat e punës:** prezantim me gojë, diskutim, dialog, lexim.
- Teknikat e punës:** stuhi idesh.
- Format e punës:** frontale, punë ekipore.
- Metoda e vlerësimit:** informacion kthyes gojor, listë për vlerësim.

## RRJEDHA E ORËS

	AKTIVITETET E ÇIFTIT TË MËSIMDHËNËSVE	AKTIVITETET E NXËNËSVE
EVOKIM	<ul style="list-style-type: none"> <li>➔ Futet me ide të stuhishme në temën e orës: “Festat që kremtohen në SHBA”,</li> <li>➔ E prezantojnë fjalorin e shprehjeve bashkë me nxënësit, me ndihmën e letrave flesh.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➔ Përgjigjen në pyetjet e mësimdhënësit</li> <li>➔ E përsërisin fjalorin e shprehjeve, bashkë me mësimdhënësin</li> </ul>
TË KUPTUARIT E DIJES	<ul style="list-style-type: none"> <li>➔ I rendit nxënësit në grupe të përziera në të dy gjuhët mësimore (maqedonase dhe shqipe) dhe jep udhëzime për realizimin e aktivitetit (nxënësit hulumtojnë në internet mbi festën Dita e falënderimeve).</li> <li>➔ E përcjellin punën e të gjithë nxënësve, japin drejtime dhe informacione kthyesë me gojë të të gjithë nxënësve nga të dy gjuhët mësimore.</li> <li>➔ Iu ndihmojnë të gjithë nxënësve, nga të dy gjuhët mësimore, nëse kanë ndonjë fjalë të panjohur; përcjellin, orientojnë dhe e vlerësojnë punën e nxënësve (me ndihmën e listës për regjistrim).</li> <li>➔ Japin udhëzime për gjithë nxënësit e të dy gjuhëve mësimore për përpunimin e gjërave që janë simbol i festës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➔ Si ekip, në grupe të përziera, në të dy gjuhët mësimore, ata hulumtojnë në internet për temën e dhënë, ndërsa, më pas, bashkërisht përgatisin prezantimin e grupit të tyre më të vogël.</li> <li>➔ Përderisa vazhdon prezantimi grupet tjera të vogla kanë për detyrë t’i plotësojnë pyetjet që eventualisht nuk janë përfshirë.</li> <li>➔ Në grupe më të vogla të përziera si ekip dakordohen për produktin/qëllimin e përbashkët që do ta përpunojnë dhe që bashkërisht e përpunojnë.</li> <li>➔ Të gjithë nxënësit lëvizin në hapësirat dhe i shohin përpunimet e grupeve tjera, komunikojnë në një atmosferë të gëzuar.</li> </ul>
REFLEKSION	<ul style="list-style-type: none"> <li>➔ Diskutojnë me të gjithë nxënësit e të dy gjuhëve mësimore mbi aspektet më interesante të kremtimit të festës dhe për atë se çfarë më së tepërmi iu ka pëlqyer ose nuk iu ka pëlqyer.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➔ Diskutojnë mes veti, të udhëhequr nga mësimdhënësi, për festën dhe për përshtypjet e tyre për kremtimin e festës, për idetë se si do ta organizonin dhe realizonin dhe për ide të tjera, të ngjashme, që dalin nga diskutimi i nxënësve.</li> </ul>
DETYRË SHTEPIE	<ul style="list-style-type: none"> <li>➔ Të shkruhet një tekst, të bëhet përshkrimi i kremtimit të një feste - sipas zgjedhjes personale</li> </ul>	

### **5.2.7. BASHKËPUNIMI ME PRINDËRIT**

#### **Qëllimi:**

Përfshirje më e madhe e prindërve në aktivitetet shkollore për INA dhe vendosje e bashkëpunimit të qëndrueshëm prindëror për arritjen e efektit të fundit të nxënësit - zvogëlim i paragjytimeve dhe stereotipave ndaj religjioneve dhe bashkësive të tjera etnike. Përfshirje e prindërve që nuk janë kyçur në këshillin e shkollës dhe prindër që nuk janë të punësuar në shkollën e përkatëse.

#### **Përbërja**

- ▶ Prindër nga të gjithë bashkësitë etnike, të përfshirë në mënyrë të ekuilibruar në aspektin etnik dhe gjinor.
- ▶ Tetë mësimdhënës prej të gjitha bashkësive etnike

#### **Aktivitete në bazë të temës**

- ▶ Punëtori për stolisje për Vitin e Ri,
- ▶ Vizitë objekteve fetare;
- ▶ Përgatitje dhe panair me ushqime tradicionale;
- ▶ Aktivitete sportive;
- ▶ Vizitë në natyrë;
- ▶ Mbjellje e luleve në oborrin e shkollës.

#### **Përgatitja dhe realizimi**

Përgatitjet bëhen në bashkëpunim me SIT dhe mësimdhënësit - kujdestarët e klasave. Realizimi i aktiviteteve zhvillohet në: shkollë, sallën sportive, objektet fetare të qytetit. Pas përzgjedhjes së temave për realizim organizohen takime me prindërit dhe ftohen të marrin pjesë e të bashkëpunojnë në aktivitetet e planifikuara. Pas paraqitjes së prindërve formohet grupi i etnik i prindërve, i ekuilibruar në aspektin etnik. Ata marrin pjesë në përgatitjet konkrete të aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve (përpilimi i deklaratës për shtyp në të tri gjuhët mësimore, ftesë për vetëqeverisjen lokale dhe mysafirë të tjerë, mediat) dhe në organizimin e ngjarjeve.

#### **Përfitimet**

Përbushja e bashkëpunimit, shoqërim ndërmjet prindërve në shkollë, këmbim mendimesh, përvojash dhe ndihmesë në procesin e zgjidhjes së problemeve në vetë shkollën, që mundëson krijimin e miqësive të përhershme.

#### **Sfidat**

Kritika nga prindërit për vazhdimin e aktiviteteve, sipas modelit të gjertanishëm të bashkëpunimit, me përfshirje të ndryshimeve nga përvoja e fituar e gjertanishme.

### **5.2.8. SIT-I NË SH.F. “SANDE SHTERJOSKI”, KËRÇOVË, PËR PËRFITIMET DHE SFIDAT E AKTIVITETEVE PËR INA**

Realizimi i qëllimeve të INA paraqet sfidë të vërtetë edhe për shkollën tonë, e përfshirë si shkollë model. Aktivisht i realizuam aktivitetet në të gjitha këto sfera: aktivitete me nxënësit, aktivitete me mësimdhënësit, aktivitete rreth asaj se çfarë është atmosfera dhe rrethi, si dhe në sferën e bashkëpunimit mes shkollave dhe prindërve, bashkësisë dhe komunës. Njohja e drejtpërdrejtë e nxënësve dhe prindërve gjatë vendosjes së kontakteve të domosdoshme dhe zhvillimit të bashkëpunimit nëpërmjet komunikimit ndërpersonal, është procesi drejt të cilit jemi të fokusuar për arritjen dhe avancimin e përhershëm të integritetit ndëretnik në shkollë dhe në bashkësi.

Ekipi për shkollë të integruar, së bashku me ekipin e menaxhimit të shkollës, i identifikuan përfitimet e mëposhtme nga realizimi i deritanishëm i aktiviteteve për INA:

- ▶ ekipit të menaxhimit të shkollës i mundësohet ta ndërtojë imazhin e shkollës së integruar;

- ▶ puna ekipore e subjekteve që janë të rritur bëhet shembull për praktikë të mirë;
- ▶ nga puna ekipore dalin rezultate të mira në çfarëdo fushe të punës në shkollë (planifikim, realizim dhe produkt);
- ▶ nxënësit më tepër njihen mes veti dhe gradualisht tejkalojnë stereotipat dhe paragjykimet;
- ▶ prindërit përfshihen më mënyrë më aktive dhe bëhen pjesëmarrës në sjelljen e vendimeve për zgjidhjen e problemeve në shkollë;
- ▶ mjedisi lokal tashmë e njeh shkollën sipas imazhit të saj dhe bëhet partner i jonë në bashkëpunimin dhe këmbimin e përvojave.

Nga sfidat me të cilat u përballëm po i potencojmë atë më kryesoret për zgjidhje:

- ▶ qëndrueshmëria e aktiviteteve për INA për funksionim të mëtutjeshëm, në drejtim të avancimit të vazhdueshëm të INA;
- ▶ krijimi i vazhdueshëm i kushteve për atmosferë pozitive në punë dhe në funksionim;
- ▶ punë nëpërmjet krijimit të aftësive sociale dhe kompetencave tek të gjithë palët në shkollë për ballafaqim me dilemat, problemet dhe konfliktet;

- ▶ motivim për mundin e dhënë të secilit gjatë punës që ka bërë dhe mundësia për shpërblim;
- ▶ promovim i shkollës si model për INA në nivel të vetëqeverisjes lokale, në nivel shtetëror dhe më gjerë.

Me INA, në shkollë, krijohet atmosferë më e mirë për punë dhe shoqërim i të gjitha palëve dhe të gjithë atyre që janë përfshirë në bashkëpunimin me shkollën. Para së gjithash, gjuha është mjet për komunikim dhe në asnjë rast nuk duhet të jetë pengesë për zbatimin e aktiviteteve në shkollë, në çfarëdo aktiviteteve që zbatohen aty. Pasuria e shoqërisë sonë bazohet në faktin se në hapësirat e saj fliten më shumë gjuhë. Problemi i mosnjohjes së gjuhës tejkalohet me dëshirën për mësim nga të tjerët, të cilët janë afër nesh dhe me ne, si dhe përmes kontakteve të mëdha të drejtpërdrejta mes fëmijëve dhe të rinjve. Me qëllim që të komunikohet sa më drejtpërdrejtë në nivel të shkollës, organizojmë punëtori dygjuhësore për mësim të gjuhës shqipe dhe maqedonase, duke përfshirë grupe të reja mësimdhënësish dhe nxënës në secilin vit të ardhshëm. Këto dy gjuhë i mësojnë mësimdhënësit dhe nxënësit - shqiptarët e mësojnë gjuhën maqedonase, maqedonasit e mësojnë gjuhën shqipe. Që nga fillimi i realizimit

të PINA, nga viti 2012 deri më sot, në gjithë kolektivin e mësimdhënësve dhe në suaza të të gjithë grup moshave të nxënësve, në secilin vit shkollor të ardhshëm përfshihen grupe të reja. Të gjithë mësojmë njëri për tjetrin, njëri nga tjetri, duke njohur gjuhën e tjetrit me dëshirë më të madhe për më tepër shoqërim, miqësi dhe ndarjen e problemeve të përbashkëta si dhe gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta. Edhe mësimdhënësit edhe nxënësit e panë se njohja me ngjashmëritë dhe dallimet mes kulturave tona është bazë për tejkalim të stereotipeve dhe paragjykimeve, të cilat janë të pranishme. Dhe, kjo e hap rrugën drejt integritit. Në bazë të ndërveprimit të shpeshtë dhe të drejtpërdrejtë ndërtohet mirëbesimi i ndërsjellë mes bashkësive etnike, të cilat bashkekzistojnë në një hapësirë të përbashkët. Porosia e jonë është se kështu duhet të shihet dhe të kultivohet vendi ynë, të cilit i përkasim të gjithë dhe bashkërisht i ndajmë gjërat e bukura dhe të këqija. Kjo është pasuria dhe njëherësh sfida për të gjithë ne që i përkasim Maqedonisë sonë multikulturore.

## LITERATURA E SHFRYTËZUAR:

1. Amstelveen, R, (2000), Interactive Communication Trainig, Human interaction
2. Ardit, M., Muhic, M, Arifi, B., Bitoljanu, A., Bozicevic, G. Course on Multiculturalism: Handbook for Students. 2013. Tetovo: Center for Balkan Cooperation, LOJA.
3. Bratanic, M, (1991), Mikropedagogija (interakcisko-komunikaciski aspect odgoja), Skolska knjiga, Zagreb
4. Bratanic M, ( 2002), Paradoks odgoja, Hrvatska sveucilisna naklada, Zagreb
5. Dodeva R., Ballazhi S., Alushevski S., Negrievska F., Doracak për punëtori multikulturore për shkollat fillore (botim i shkurtuar) USAID, Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar, Shkup
6. Ethical dimension of education, (special edition, Science collection of ethical dimension in the educational system), Faculty of Pedagogy Jagodina, 2008 European center of minority's questions, (2006), Roma for the integrations: Analysis and references, SIDA (6-7)
7. Gutmann, A., 2003, Identity in Democracy, Princeton: Princeton University Press
8. Kymlicka, W. 1989, Liberalism, Community, and Culture, Oxford: Oxford University Press
9. Kymlicka, W. 1995, *Multicultural Citizenship: A Liberal Theory of Minority Rights*, Oxford: Oxford University Press
10. Kymlicka, W. 2001, *Politics in the Vernacular: Nationalism, Multiculturalism, and Citizenship*, Oxford: Oxford University Press
11. Kimlika Vil, 2009, Filozofia politike bashkëkohore, Shkup: Shtypi akademik
12. Levy, J.T., 1997, "Classifying Cultural Rights," Nomos XXXIX: Ethnicity and Group Rights, W. Kymlicka and I. Shapiro (eds.), New York: New York University Press
13. Organization for Economic Co-operation and Development. Educating Teachers for Diversity: Meeting the Challenge. (OECD Publishing, 2010).
14. Arsimi dhe kultura demokratike (1991), (përkthim), Instituti i Shoqërisë së Hapur, Maqedoni
15. Parekh, B., 2000, Rethinking Multiculturalism: Cultural Diversity and Political Theory, Cambridge, MA: Harvard University Press

16. Popova - Koskarova, R.(2007), Supporting diversities as a value through upbringing-educational process, The Fourth Balkan Congress, Education, The Balkans, Europe, Trakia University, Faculty of education, Stara Zagora, Bulgaria
17. Popova-Kostarova P., Komunikimi në turizëm (e përgjithshme dhe afariste), Fakulteti i turizmit, Shkup, 2007
18. Popova – Koskapova(2010) Overcoming of the stereotypes and prejudice of Roma students and their integrations in the school border ,US-China Education Review, Illinois, USA,2009, Vol1-8
19. Pharanad J.and M. Doucet, eds. Enéducation, quand les émotionss'enmêlent! (Québec: Les Presses de l' Université du Québec, 2013).
20. Phillips, A., 2007, Multiculturalism Without Culture. Princeton, NJ: Princeton University Press
21. Doracak. Punëtori multikulturore për shkollat fillore, Proekt shkolla në masë të nxënësit, UNICEF dhe BZHA. Doracak për Trajnimin për integrim ndëretnik në arsim – për ekipet për integrim shkollor, Proekt për Inndëretnik në Arsi, përgatitur përgatitur nga Qendra për të drejtat e njeriut dhe zgjidhjen e konflikteve
22. Material pune: Integrimi ndëretnik në arsim , trajnim ër integrim shkollor, Proekt për tegrimin Ndëretnik në Arsim. QMEQ në bashkëpunim me QDNJYKQershor 2013.
23. Taylor, C., 1995, "Irreducibly Social Goods," in Philosophical Arguments, Cambridge, MA: Harvard University Press
24. Taylor, C., 1992, "The Politics of Recognition," in *Multiculturalism: Examiningthe Politics of Recognition*, A. Gutmann (ed.), Princeton: Princeton University Press
25. Èilma De Melendez and Verna Beck, Teaching Young Children in Multicultural Classrooms: Issues, Concepts, and Strategies.(Wadsworth: Cengage Learning, 2013).
26. Young, I.M., 1990, *Justice and the Politics of Difference*, Princeton, NJ: Princeton University Press.Zgaga, Pavel. Review of Tuning Teacher Education Curricula in the WesterBalkans, edited by Nataša Pantić. (Belgrade: Centre for Education Policy, 2008)

**RESURSET ELEKTRONIKE:**

1. <http://goo.gl/HzZ8tE>
2. <http://www.mills.edu/academics/faculty/educ/szirkel/Creating%20more%20effective%20mu~1.pdf>
3. [http://www.griffith.edu.au/\\_\\_data/assets/pdf\\_file/0011/184853/Creating-a-Culturally-Inclusive-Classroom-Environment-mcb2.pdf](http://www.griffith.edu.au/__data/assets/pdf_file/0011/184853/Creating-a-Culturally-Inclusive-Classroom-Environment-mcb2.pdf)
4. <http://www.learner.org/workshops/socialstudies/pdf/session3/3.Multiculturalism.pdf>
5. <http://pmio.mk/news/western-balkans-love-story-shakespeare-at-the-door/>
6. <http://pmio.mk/archive-capacity-building/a-smile-is-a-smile-in-any-language/>
7. [http://www.youtube.com/watch?v=b\\_fI2CihXP8&list=UUdHXb62Cuj24S9VtGtQCCZg](http://www.youtube.com/watch?v=b_fI2CihXP8&list=UUdHXb62Cuj24S9VtGtQCCZg)

SHTOJCAT

# SHTOJCA 1

## INSTRUMENT PËR PËCJELLJEN E AKTIVITETIT TË PËRBASHKËT PËR INTEGRIM MULTIETNIK

Ky instrument përmban hapat për përcjelljen e aktivitetit të përbashkët, kriteret për aktivitete të përbashkëta të nxënësve sipas të cilave përcillet aktiviteti, si dhe pyetjet për refleksion. Kriteret janë marrë nga lista për regjistrim për zbatim të suksesshëm të aktiviteteve të përbashkëta për INA. Për disa nga kriteret janë dhënë sqarime plotësuese. Instrumenti mund të shfrytëzohet për përgatitje dhe realizim të aktiviteteve të përbashkëta dhe për vetërefleksion pas mbarimit të aktivitetit.

### 1. Planifikimi i aktivitetit të përbashkët

*Realizatorët dhe anëtarët e tjerë të SI-it, që do ta ndjekin aktivitetin, gjatë planifikimit të aktiviteteve të përbashkëta, i shfrytëzojnë kriteret e dhënë në pjesën PËRGATITJA DHE REALIZIMI I AKTIVITETIT TË PËRBASHKËT.*

### 2. Përcjellja e aktiviteteve

Aktiviteti përcillet sipas kriterëve që kanë të bëjnë me REALIZIMIN E AKTIVITETIT TË PËRBASHKËT dhe shënohen komente/vërejtje me shembuj konkret për arritjen e secilit kriter.

<p><b>KOLONA 2</b> - Vlerësoni shkallën e suksesshmërisë të kriterëve të dhëna nga shalla 1-4, ku 1 shënon shkallën më të ulët, ndërsa 4 shkallën më të lartë.</p>	<p><b>KOLONA 3</b> –Shkruani koment/vërejtje me shembuj konkret për arritjet.</p>
<p><b>KRITERE PËR ZBATIM TË SUKSESSHËM TË AKTIVITETEVE TË PËRBASHKËTA</b></p>	<p><b>VLERËSIMI I SHKALLËS NGA 1-4</b></p>
<p><b>KOMENTE/SHËNIME ME SHEMBUJ KONKRET PËR ARRITJEN E KRITEREVE)</b></p>	
<p><b>PËRGATITJA E AKTIVITETIT TË PËRBASHKËT</b></p>	

1. Është mbajtur takim i përbashkët me mësimdhënësin/mësimdhënësit nga gjuha tjetër mësimore dhe është përpiluar plani i detajuar për aktivitetin e përbashkët (mes shkollave partnere merren parasysh komunikimi elektronik dhe takimet virtuale). Plani ka të bëjë me aktivitetin e përbashkët në sferën e interesit të përbashkët dhe përfshin:

  - ▶ qëllimet e aktivitetit
  - ▶ përmbytjen e detyrës
  - ▶ hapat konkret për realizimin e aktivitetit të përbashkët (vëmendje e veçantë i kushtohet kriterëve me numrat 5,6,9,10,11,12 dhe 13 nga REALIZIMI I AKTIVITETIT TË PËRBASHKËT)
  - ▶ produktit final të pritur
  - ▶ numrin e nxënësve-pjesëmarrës dhe mënyrën e tyre të përzgjedhjes
  - ▶ vendin dhe kohën e realizimit të aktivitetit të përbashkët.

1 2 3 4

<p><b>2.</b> Prindërit janë të përfshirë në planifikimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe është siguruar pajtueshmëri për pjesëmarrjen e nxënësve (pajtueshmëri e kumtuar nga vetë prindërit ose Këshilli i shkollës).</p>	<p>1 2 3 4</p>
<p><b>3.</b> Është formuar grupi i nxënësve-pjesëmarrës dhe krahas kësaj janë respektuar kriteret për përzgjedhjen e tyre (ekuilibri gjinor dhe etnik/gjuhësor si dhe kategoria e moshës adekuatë).</p>	<p>1 2 3 4</p>
<p><b>4.</b> Janë përgatitur resurset/materialet e nevojshme për realizimin e aktivitetit të përbashkët.</p>	<p>1 2 3 4</p>
<p><b>5.</b> Janë siguruar të gjitha parakushtet për zbatim të sigurt të aktivitetit të përbashkët (mbrojtje nga lëndimet fizike dhe psikike).</p>	<p>1 2 3 4</p>
<p><b>REALIZIMI I AKTIVITETIT TË PËRBASHKËT</b></p>	
<p><b>1.</b> Nxënësit-pjesëmarrës janë përfshirë në përzgjedhjen e temës/përmbajtjes së aktivitetit të përbashkët dhe në planifikimin e hapave që duhet të ndërmerren për t'u arritur produkti.</p>	<p>1 2 3 4</p>
<p><b>2.</b> Aktiviteti i përbashkët është realizuar nëpërmjet disa takimeve të vazhdueshme (Gjatë aktivitetit në kohëzgjatje më të madhe: së paku një herë në javë gjatë gjysmëvjetorit; gjatë aktiviteteve në kohëzgjatje më të shkurtër; disa takime para dhe pas ngjarjes; te shkollat partnere merret parasysh komunikimi elektronik dhe takimet virtuale.</p>	<p>1 2 3 4</p>
<p><b>3.</b> Janë zbatuar aktivitete për njohje të ndërsjellë të nxënësve dhe për krijimin e kohezionit në grup.</p>	<p>1 2 3 4</p>

<p><b>4.</b> Janë miratuar rregulla të sjelljes gjatë takimeve të përbashkëta, me pjesëmarrje aktive të nxënësve – pjesëmarrës.</p>	<p>1 2 3 4</p>	
<p><b>5.</b> Puna e nxënësve - pjesëmarrës, angazhimi dhe motivimi i tyre përcillet nga ana e mësimit dhe nxënësit marrin informacion kthyes për rrjedhën e gjithë procesit të aktivitetit të përbashkët dhe produktit të përpunuar.</p> <p><b>Sqarim:</b> Pas prezantimit të produktit final mësimit bëjnë refleksionin bashkë me nxënësit dhe bisedohet për përshlyerjet e tyre nga puna dhe bashkëpunimi gjatë tërë aktivitetit.</p>	<p>1 2 3 4</p>	
<p><b>6.</b> Gjatë realizimit të aktivitetit të përbashkët qartësisht shihet ekzistimi i bashkëpunimit dhe plotësimit të ndërsjellë mes mësimit nga gjuhë mësimore të ndryshme.</p>	<p>1 2 3 4</p>	
<p><b>7.</b> Prindërit janë të përfshirë gjatë realizimit të aktivitetit të përbashkët dhe është siguruar bashkëpunimi dhe përfshirja e tyre<sup>43</sup></p>	<p>1 2 3 4</p>	
<p><b>8.</b> Materiali i shkruar që shfrytëzohet në aktivitet (materiali i punës dhe produktet e nxënësve) është përgatitur në të gjitha gjuhët mësimore të përfaqësuara në grup.</p>	<p>1 2 3 4</p>	
<p><b>9.</b> Është arritur përfaqësimi i njëjtë dhe përdorimi i dy/tri gjuhëve gjatë realizimit të aktivitetit të përbashkët.</p>	<p>1 2 3 4</p>	

<sup>43</sup> Ky kriter merret parasysh në raste kur prindërit janë përfshirë në aktivitetin e përbashkët

<p><b>10.</b> Është shmangur vlerësimi dhe kritika ndaj përgjigjeve të nxënësve nga ana e mësimit dhe mes nxënësve.</p>	<p>1 2 3 4</p>	
<p><b>11.</b> Nxënësit me përkatësi të ndryshme etnike/gjuhësore janë trajtuar njëjtë dhe është vendosur status i barabartë dhe me këtë secili nxënës ndjehet njësoj i vlefshëm.</p>	<p>1 2 3 4</p>	
<p><b>12.</b> Gjatë punës në grupe të vogla, gjithnjë kur është e mundshme, grupet janë me përbërje të përzier etnike dhe gjinore dhe pjesëmarrësit në grupe stimulohen njëri me tjetrin që të bashkëpunojnë, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike/gjuhësore.</p> <p><b>Sqarim:</b> Nxënësit nxiten për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▶ bashkëpunim që ngërthen ndërveprim të drejtpërdrejtë, ndërvarësi pozitive, mundësi të njëjta për sukses në grup dhe përgjegjësi individuale,</li> <li>▶ diskutim mes veti, ku mund t'i shprehin/ndajnë idetë e tyre, përvojat, optiket dhe ndjenjat,</li> <li>▶ kreativitet, mendim kritik në sjelljen e zgjidhjeve dhe vendime të përbashkëta kur punojnë aktivitete praktike/manipulative dhe aktivitete mendore.</li> </ul>	<p>1 2 3 4</p>	
<p><b>13.</b> Vendosjen e <b>kunikimit spontan</b> dhe shoqërim mes nxënësve me përkatësi të ndryshme etnike/gjuhësore gjatë aktivitetit të përbashkët dhe jashtë aktivitetit.</p> <p><b>Sqarim:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Nxënësit nxiten në dëgjim aktiv, shprehjen e mendimit të tyre dhe pranimin e mendimit të tjerëve brenda grupit.</li> <li>▶ Është e pranishme atmosfera e respektimit dhe mirëbesimit të ndërsjellë mes nxënësve dhe mundësi për afrim më të madh dhe për miqësi.</li> </ul>	<p>1 2 3 4</p>	

14. Janë realizuar të gjitha përmbajtjet e parapara që ndërlihen drejtpërdrejtë me temën e aktivitetit të përbashkët.	1 2 3 4	
<b>PROMOVIMI I AKTIVITETIT TË PËRBASHKËT</b>		
1. Është organizuar ngjarje për promovim përmbyllës të aktivitetit të përbashkët që është realizuar.	1 2 3 4	
2. Është realizuar pjesëmarrje e njëjtë dhe e përbashkët e të gjithë mësimdhënësve dhe nxënësve të përfshirë nga të gjitha grupet e përfaqësuara etnike/gjuhësore në përgatitjen e ngjarjes (përcaktimi i vendit dhe kohës për mbajtjen e ngjarjes promovuese, përgatitja e skenarit, përgatitja e ftesave, sigurimi i logjistikës ndihmëse etj.).	1 2 3 4	
3. Është realizuar pjesëmarrje e njëjtë dhe e përbashkët e mësimdhënësve dhe nxënësve prej të gjitha grupeve të përfaqësuara në aspektin etnik/gjuhësor gjatë kohës së realizimit të ngjarjes.	1 2 3 4	
4. Është siguruar dukja e karakterit multikulturor të aktivitetit të përbashkët (sipas përbërjes së grupit dhe përfaqësimit të gjuhëve të ndryshme mësimore dhe sipas mundësive në bazë të përmbajtjes).	1 2 3 4	
5. Personeli i shkollës, prindërit, përfaqësuesit e komunës dhe të institucioneve arsimore si dhe nga PAIM janë ftuar si mysafirë të ngjarjes.	1 2 3 4	

### 3. Takim pas realizimit të aktivitetit dhe refleksioni

Pas realizimit të aktivitetit anëtarët e SIT-it bisedojnë për aktivitetin dhe bëhet **refleksion** sipas pyetjeve të dhëna më poshtë për refleksion.

1. Në çfarë mase nxënësit kanë arritur qëllimet?	2. A ishte detyra e duhur për nxënësit dhe në çfarë mase ishin të angazhuar në punë?
3. Si e dini që është arritur komunikimi i duhur, bashkëpunimi, ndërveprimi dhe kontakti brenda grupit?	4. Në çfarë mase ishin të duhura orientimi dhe informacionet kthyesë të nxënësve nga ana e mësimit për ta realizuar suksesshëm detyrën?
5. Në çfarë mase ishte i suksesshëm prezantimi i produktit final dhe refleksioni i nxënësve për përshtypjet e tyre në aspekt të integritimit ndëretnik?	6. Cilat janë propozimet dhe sugjestionet tuaja për përmirësimin e realizimit të aktiviteteve të përbashkëta?

# SHTOJCA 2

## INSTRUMENT PËR PËRCJELLJEN E AKTIVITETIT TË PAVARUR MULTIKULTUROR

Ky instrument përmban hapat për përcjelljen e aktivitetit të pavarur multikulturor, kriteret sipas të cilave përcillet aktiviteti dhe pyetjet për refleksion. Instrumenti mund të shfrytëzohet gjatë përgatitjes dhe realizimit të aktiviteteve të pavarura multikulturere dhe për vetërefleksion pas mbarimit të aktiviteteve.

### 1. Planifikimi i aktiviteteve të pavarura shumëkulturere

Gjatë planifikimit të aktivitetit të pavarur shumëkulturore realizatorët dhe anëtarët e tjerë të SIT-it, që do ta përcjellin aktivitetin, shfrytëzojnë kriteret e dhëna në pjesën PËRGATITJA dhe REALIZIMI I AKTIVITETIT TË PAVARUR MULTIKULTUROR

### 2. Përcjellja e aktivitetit

Aktiviteti përcillet sipas kriterëve të cilat kanë të bëjnë me REALIZIMIN E AKTIVITETIT TË PAVARUR MULTIKULTUROR.

<b>KOLONA 2</b> – Bëni vlerësim të shkallës së suksesit me kriteret e dhëna në shkallën nga 1-4, ku 1 shënon shkallën më të ulët, ndërsa 4 shkallë më të lartë.	<b>KOLONA 3</b> – Shkruani koment / shënime me shembuj konkret për arritje të kriterit.	
<b>KRITERET PËR ZBATIM TË SUKSESSHËM TË AKTIVITETIT TË PAVARUR MULTIKULTUROR</b>	<b>VLERËSIMI NË SHKALLË 1-4</b>	<b>KOMENTE/SHËNIME ME SHEMBUJ KONKRET PËR ARRITJEN E KRITEREVE</b>
<b>PËRGATITJA PËR AKTIVITETIN E PAVARUR MULTIKULTUROR</b>		
<b>1.</b> Qëllimet e aktivitetit janë qartësisht të përkufizuara dhe janë grupuar në tri suaza që kanë të bëjnë me fitimin: (1) dije, (2) shkathtësi dhe (3) qëndrime / vlera.	1 2 3 4	
<b>2.</b> Aktiviteti mund të ngërthejë arritjen e këtyre qëllimeve: <i>zvogëlimin e stereotipeve, paragjykimeve dhe diskriminimit; zhvillim i qëndrimeve për respekt dhe pranim të kulturave dhe bashkësive tjera etnike; promovim i tolerancës, paqes, njëjtësisë, barabartësisë; promovim i jetesës / shoqërimit të përbashkët, diskutime kritike për çështje aktuale ose për situata nga jeta e përditshme shkollore ose bashkësia lokale për tema multikulturore.</i>	1 2 3 4	
<b>3.</b> Aktivitetet ngërthejnë zbatim të metodave aktive, kooperative të mësimit (dialog në grupe të vogla, ndërtim roli, demonstrim dhe simulim, luajtje roli, analizë tekstesh ose situatash, shfaqje teatrore).	1 2 3 4	
<b>4.</b> Janë përgatitur resurset e nevojshme dhe materialet e punës që sigurojnë angazhim aktiv të nxënësve.	1 2 3 4	

5. Janë siguruar të gjitha parakushtet e nevojshme për zbatim të suksesshëm të aktivitetit.	1 2 3 4
---	---------

### REALIZIM I AKTIVITETIT TË PAVARUR MULTIKULTOR

1. Nxënësit futen në temë, e cila do të mësohet, do të sqarohen qëllimet dhe do të bëhet ndërlidhja e dijes paraprake dhe përvojës me temën e paralajmëruar.	1 2 3 4
2. Ndjehet atmosferë motivimi dhe angazhimi i nxënësve për punë dhe respektim të ndërsjellë mes nxënësve dhe mësimitdhënësit.	1 2 3 4

3. Kriteret në këtë pikë janë ndarë në 4 tema të ndryshme. Përcillen vetëm ato kritere të që ndërlidhen me temën që mësohet.

3.1. Promovim i mësimit multikulturor	▲ Nxënësit e përforcojnë ndjenjën për vlerën e kulturës së tyre dhe zhvillojnë identitet kulturor pozitiv.	1 2 3 4
	▲ Nxënësit e zhvillojnë ndjenjën për hapje, për njohje të veçantive të kulturës së “tjetrit”.	1 2 3 4
	▲ Nxënësit e zhvillojnë ndjenjën e respektit, empatisë, mirëbesimit dhe pranimit të kulturave tjera.	1 2 3 4
	▲ Nxënësit zhvillojnë aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi, që janë të nevojshme për ndërveprim me nxënësit e kulturave të tjera.	1 2 3 4
	▲ Te nxënësit brendësohen vlerat për integrim shumetnik në shoqëri multikulturore.	1 2 3 4

<p><b>3.2.</b> Promovimi i të drejtave të njeriut, demokracisë, drejtësisë dhe barabarisë sociale</p>	<p>▶ Nxënësit njihen me parimet kyçe të të drejtave të njeriut.</p>	1 2 3 4
	<p>▶ Nxënësit zhvillojnë aftësi për të zbatuar konceptet për të drejtat e njeriut.</p>	1 2 3 4
	<p>▶ Nxënësit nxiten që të ballafaqohen me sfidat e padrejtësisë dhe të ndërmarrin aksion për barabari sociale.</p>	1 2 3 4
	<p>▶ Nxënësit mësojnë për proceset demokratike dhe zhvillojnë kompetenca për ngritjen e aksioneve demokratike dhe futje ndryshimesh në kontekstin shkollor dhe më gjerë.</p>	1 2 3 4
<p><b>3.3.</b> Zvogëlimi i stereotipave, paragjytimeve dhe diskriminimit</p>	<p>▶ Nxënësit zhvillojnë aftësi për njohjen e stereotipave dhe paragjytimeve tek vetja dhe tjerët.</p>	1 2 3 4
	<p>▶ Nxënësit zhvillojnë aftësi për zvogëlimin e stereotipave dhe paragjytimeve për grupet e tjera etnike.</p>	1 2 3 4
	<p>▶ Nxënësit zhvillojnë aftësi ballafaqimi me sfidat e diskriminimit.</p>	1 2 3 4
	<p>▶ Nxënësit njihen me faktorët që sjellin dhe krijojnë konflikte</p>	1 2 3 4
<p><b>3.4.</b> Zgjidhja e konflikteve</p>	<p>▶ Nxënësit njihen me parimet për zgjidhjen e konflikteve</p>	1 2 3 4
	<p>▶ Nxënësit aftësohen për analizë të situatave të konfliktit</p>	1 2 3 4
	<p>▶ Nxënësit aftësohen për negociata</p>	1 2 3 4

<p>4. Nxënësit marrin pjesë aktivisht në aktivitet; puna e tyre përcillet nga mësimdhënësit; nxënësit marrin informacione konstruktive kthyesë dhe nxiten / orientohen në këmbim praktik në këto aftësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▶ <u>Komunikim dhe bashkëpunim</u> – dëgjim aktiv, diskutim i përbashkët, respektim i ideve të të tjerëve dhe bashkëpunim aktiv mes nxënësve.</li> </ul>	<p>1 2 3 4</p>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ <u>Mendim kritik</u> - analizë dhe vlerësim i argumenteve dhe alternativave; sintezë dhe ndërlidhje e informacioneve dhe argumenteve; sjellja e përfundimeve që mund t'i argumentojnë; parashtrimi i pyetjeve kritike ose dhënia e komenteve kritike në lidhje me temën.</li> </ul>	<p>1 2 3 4</p>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>▶ <u>Zgjidhja e problemeve</u> – përkufizimi i problemit; gjetja e alternativave të ndryshme për zgjidhjen e problemeve; vlerësimi i efekteve për alternativat e propozuara.</li> </ul>	<p>1 2 3 4</p>	
<p>5. Nxënësit nxiten për reflektim kritik rreth përvojës dhe procesit mësimor.</p>	<p>1 2 3 4</p>	

### 3. Takim pas realizimit të aktivitetit dhe refleksioni

Pas realizimit të aktivitetit, anëtarët e SIT-it bisedojnë për aktivitetin dhe bëhet refleksion sipas pyetjeve të mëposhtme për refleksion.

1. Në çfarë mase nxënësit i realizuan qëllimet?	2. A ishte detyra adekuate për nxënësit dhe në çfarë mase ishin të angazhuar dhe të motivuar për punë?
3. Si e dini që është arritur kuptimi i duhur i temës?	4. Në çfarë mase orientimi dhe informacionet kthyesë të nxënësve, nga ana e mësimitdhënësve, ishin të duhura që suksesshëm të përfundojë aktiviteti?
5. Në çfarë mase aktiviteti kishte përfunduar në mënyrë të suksesshme dhe cili ishte refleksioni i nxënësve dhe përshtypjet e tyre?	6. Cilat janë propozimet dhe sugjestionet tuaja për përmirësimin e aktivitetit të realizuar?

